



Instituti i Kosovës për Drejtësi

## **KORRUPSIONI NË KOSOVË 5:**

**Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit**

Prishtinë, Qershor 2015

Autorët: **Betim Musliu dhe Genc Nimoni**

Kontribut në projektin e monitorimit të Planit të Veprimit  
kanë dhënë:

Juristët dhe monitoruesit: **Adem Krasniqi dhe Valdet Hajdini**

Monitorueset: **Bukurezë Surdulli dhe Hyrije Mehmeti**

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

#### **RRETH IKD**

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë

IKD

Hyrja 13, Nr. 10

Rr. Rexhep Luci

Prishtinë

E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)

[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
II. METODOLOGJIA .....	7
III. RASTET E KORRUPSIONIT NË FAZËN E HETIMEVE - PP .....	9
a) TRENDI I RASTEVE TË PAZGJIDHURA.....	9
b) TRENDI I RASTEVE TË PRANUARA GJATË PLANIT TË VEPRIMIT.....	17
c) TRENDI I RASTEVE TË ZGJIDHURA .....	19
d) MËNYRA E ZGJIDHJES SË RASTEVE.....	22
IV. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR RASTET E REGJISTRUARA DERI MË 4 NËNTOR 2013 .....	26
a) MËNYRA E ZGJIDHJES SË RASTEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERIUDHËN RAPORTUESE .....	30
b) RASTET E REJA TË PRANUARA DHE MËNYRA E ZGJIDHJES.....	33
c) RASTET E PAZGJIDHURA NË FUND TË PLANIT TË VEPRIMIT.....	36
V. RASTET E KORRUPSIONIT NË FAZËN E GRUMBULLIMIT TË INFORMATAVE - PPN.....	42
a) RASTET E PAZGJIDHURA NË FILLIM MË 4 NËNTOR 2013 PPN .....	42
b) RASTET E PRANUARA GJATË PLANIT TË VEPRIMIT PPN .....	46
c) RASTET E ZGJIDHURA DHE MËNYRA E ZGJIDHJES PPN.....	50
d) RASTET E PAZGJIDHURA NË FUND TË PLANIT TË VEPRIMIT PPN.....	52
VI. PROFILI I PERSONAVE NDAJ TË CILËVE JANË ZGJIDHUR RASTET.....	54
VII. DËNIMET E GJYKATAVE PËR RASTET E KORRUPSIONIT .....	62
VIII. DËSHTIMI NË RESPEKTIMIN E MEKANIZMIT PËRCJELLËS PËR RASTET E KORRUPSIONIT.....	64
IX. PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT.....	68
X. PARASHKRIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT .....	77
XI. REKOMANDIMET .....	86

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) më 4 nëntor 2013, ka nxjerr *Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit (në vazhdim Plani i Veprimit)*.<sup>1</sup> Prej hyrjes në fuqi të këtij plani, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në përputhje me Memorandumin e Bashkëpunimit me KPK<sup>2</sup>, ka bërë monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit. Deri në këtë fazë, IKD ka publikuar katër raporte, si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të këtij plani.<sup>3</sup> Ndërsa ky është raporti i pestë periodik sa i përket zbatimit të Planit të Veprimit.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se sistemi prokurorial assesi nuk ka arritur të ulë ndjeshëm numrin e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit. Trendi i këtyre rasteve në këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015) është ulur në fund, nëse krahasohet me periudhat e mëparshme. Me hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit, prokuroritë kanë pasur në punë 516 raste të pazgjidhura me 1,682 persona, ndërsa më 31 mars 2015 kanë mbetur 556 raste të pazgjidhura me 1,652 persona. Pra, kemi një rritje të numrit të rasteve të pazgjidhura, ndërsa një zvogëlim të numrit të personave ndaj të cilëve nuk janë zgjidhur rastet. Nëse analizohet numri i rasteve në fillim më 4 nëntor 2013 (516 raste me 1,682 persona) dhe numri i rasteve të pranuar gjatë Planit të Veprimit deri më 31 mars 2015 (638 raste me 1,279 persona), rezulton se prokuroritë kanë pasur në punë 1,154 raste me 2,961 persona. Prej këtij numri të përgjithshëm prokuroritë kanë arritur të zgjidhin 628 raste apo 54.42 % të tyre me 1,420 persona apo 47.96 % të tyre. Prej gjithsej 1,420 personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet në përgjithësi, prokurorët ndaj 615 personave kanë ngritur aktakuza pas zhvillimit të hetimeve ose aktakuza të drejtpërdrejta, ndaj 51 personave kanë propozuar shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, ndërsa ndaj 345 personave kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe ndaj 409 personave kanë pushuar hetimet. Sipas kësaj, rezulton se prokurorët më shumë se ndaj gjysmës së personave, përkatësisht

<sup>1</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës në kuadër të zbatimit të *Planit Strategjik për Bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit* më 4 nëntor 2013 ka nxjerrë "*Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit*".

<sup>2</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit me Institutin e Kosovës për Drejtësi "*Lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit*". 27 dhjetor 2013.

<sup>3</sup> *Shënim*: Të dy raportet e publikuara nga IKD janë prezantuar edhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Raporti i parë është prezantuar në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës të mbajtur me datën 25 prill 2014, në të cilën anëtarët e KPK-së kanë diskutuar dhe kanë miratuar raportin e publikuar të IKD-së "*Korrupsioni në Kosovë: Raport vlerësues mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit*", i cili përveç gjetjeve dhe vlerësimeve ka bërë rekomandime konkrete për zbatimin me efikasitet të Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit. (shih - <http://psh-ks.net/?page=1,8,557>). Raporti i dytë është prezantuar në mbledhjen e mbajtur më 16 tetor 2014, në të cilën është prezantuar raporti "*Korrupsioni në Kosovë 2: Raport vlerësues gjithëpërfshirës mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit*", me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet rreth zbatimit të Planit të Veprimit. (shih - <http://ëëë.psh-ks.net/?page=1,8,635>). Raporti i tretë periodik "*Korrupsioni në Kosovë 3: Raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit*", me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet rreth zbatimit të Planit të Veprimit është publikuar më 26 dhjetor 2014 (shih - <http://kli-ks.org/ikd-luftimi-i-korrupsionit-nuk-po-trajtohet-si-prioritet-nga-sistemi-i-drejtësisë/>).

ndaj 754 personave kanë pushuar hetimet apo kanë hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa ndaj 666 personave kanë ngritur aktakuza.

IKD vlerëson se në përgjithësi kjo është një performancë e dobët e prokurorëve në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, duke pasur parasysh se pothuajse gjysma e tyre kanë mbetur të pazgjidhura. Edhe më shqetësuese është mënyra e zgjidhjes së rasteve, ku më shumë se gjysma e tyre janë raste të hudhura apo pushuara, dhe kjo dëshmon se ekzistojnë probleme serioze të parashtruesve të rasteve të korrupsionit dhe prokurorëve, gjë që duhet analizuar nga mekanizmat e brendshëm të KPK-së.

**Zbatimi i Planit të Veprimit për rastet e regjistruara deri më 4 nëntor 2013** - Sikurse në raportet paraprake, për të bërë matjen e realizimit të Planit të Veprimit, IKD ka vendosur indikatorë, të bazuar në detyrimet e dala nga ky plan. **Matja e zbatimit të Planit të Veprimit**, bazohet në rastet e zgjidhura të korrupsionit, të cilat kanë qenë të regjistruara deri më datën 4 nëntor 2013 si raste të pazgjidhura që përfshijnë 1,682 persona. **Sipas këtij indikator, rezulton se gjatë kësaj periudhe raportuese (janar, shkurt, mars 2015), prokuroritë kanë zgjidhur raste ndaj 900 personave apo kanë arritur të zbatojnë Planin e Veprimit 55%.**

Prej tyre, IKD ka identifikuar se prokurorët ndaj 206 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura (apo 22 % të tyre) kanë hudhur poshtë kallëzimet penale, ndaj 290 personave (apo 32 % të tyre) kanë pushuar hetimet, ndërsa ndaj 404 personave (apo rreth 45 % të tyre) kanë ngritur aktakuza.

PTh në Prishtinë vazhdon të jetë prokuroria me efikasitetin më të dobët në përmbushjen e obligimeve të Planit të Veprimit. **PTh në Prishtinë** ka zgjidhur raste vetëm ndaj **27%** të personave, sa kishte edhe në periudhën e tremujorit paraprak, apo vetëm ndaj 210 prej 777 personave, të cilët kanë qenë të regjistruar në Planin e Veprimit deri më 4 nëntor 2013. *Pra, PTh në Prishtinë për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015), nuk ka zgjidhur asnjë rast të vjetër, të regjistruar para datës 4 nëntor 2013, gjë mbetet shqetësuese marr parasysh numrin e madh të lëndëve të vjetra të pazgjidhura.* PSRK, krahasuar me periudhën paraprake raportuese në të cilën ende nuk kishte arritur të zgjidhte as gjysmën e rasteve të vjetra, tani në periudhën janar, shkurt, mars 2015, ka arritur të zgjidhë më shumë se gjysmën e rasteve të vjetra. Prej rasteve të pazgjidhura ndaj 232 personave sa i ka pasur të regjistruar në fillim të Planit, **PSRK** i ka zgjidhur rastet ndaj 123 personave apo **53%** të tyre. *Pra, gjatë tre muajve të periudhës raportuese, PSRK ka zgjidhur raste ndaj 13 personave, të cilët i takojnë rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013.* Pas PTh në Prishtinë dhe PSRK-së, vijon **PTh në Mitrovicë** si prokuroria me jo-efikase, e cila ka zgjidhur raste ndaj **61%** të personave apo rastet ndaj 88 prej 141 personave sa i kishte të regjistruar më 4 nëntor 2014. *Gjatë periudhës raportuese kjo prokurori ka zgjidhur raste ndaj 19 personave.* IKD gjithsesi ka parasysh rezultatet jo të mira të kësaj prokurorie, në të cilat kanë ndikuar edhe arsytet objektive të kushteve të punës, për të cilat IKD ka kërkuar të adresohet me urgjencë nga Këshilli Prokurorial për përmirësimin e kushteve të punës, por që nuk është bërë asgjë. Mbi gjysmën e personave ka arritur t'i zgjidhë edhe **PTh në Ferizaj,**

e cila prej 126 personave, i ka zgjidhur 94 apo 74% të personave. Për këtë periudhë raportuese ka arritur të zgjidhë raste vetëm ndaj 3 personave. **PTh në Gjakovë** gjatë kësaj periudhe tre mujore ka arritur të zgjidhë vetëm një rast të regjistruar deri më 4 nëntor 2013, e cila ka zgjidhur raste ndaj 82% apo 53 prej 64 personave sa i ka pasur në fillim të Planit të Veprimit. **PTh në Prizren** gjithashtu ka arritur të zgjidhë 90% të personave, duke zgjidhur raste ndaj 159 personave prej 175 sa i kishte pasur në punë fillim të Planit të Veprimit. Gjatë periudhës raportuese ka zgjidhur vetëm një rast të regjistruar deri më 4 nëntor 2013. **PTh në Pejë** ka arritur të zgjidhë 100% të personave apo rastet ndaj 92 personave. Gjatë periudhës raportuese kjo prokurori ka zgjidhur raste ndaj 5 personave. **PTh në Gjilan** ka arritur të zgjidhë 100% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013 në Planin e Veprimit, duke zgjidhur të gjitha rastet, përkatësisht 23 raste me 81 persona.

Përveç zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit dhe Kryeprokurorët kanë pasur një varg obligimesh tjera, të cilat nuk kanë arritur t'i përmbushin apo i kanë përmbushur minimalisht dhe që ndërlidhen me: përgatitjen e raporteve të veçanta për rastet e parashkrimit të ndjekjes penale në lëndët e korrupsionit, me identifikimin e rasteve që mund të mos jenë të raportuara në regjistrin e kallëzimeve penale, me moszbatimin e dispozitave të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të fituara përmes veprave penale, me mos mbajtjen e takimeve të rregullta me PK dhe AKK dhe agjencitë tjera që e zbatojnë ligjin, me informimin e publikut dhe medieve rreth zbatimit të Planit të Veprimit etj.

IKD në këtë raport ka identifikuar edhe profilet e personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën 4 nëntor 2013 deri më 31 dhjetor 2014. Sa i përket profilit të korrupsionit të nivelit të lartë ka një numër të tyre që janë përfshirë në procedura hetimore, por vërehet se nuk ka ndjekje të tyre. Shumica e rasteve të profilit të lartë hudhen poshtë ose pushohen hetimet, ndërsa vetëm ndaj një numri të vogël ngritën aktakuzat.

Sa i përket dënimeve të gjykatave bazuar në të dhënat e Mekanizmit Përcjellës, rezulton se për këtë periudhë raportuese tre mujore (janar, shkurt, mars 2015), gjykatësit kanë zgjidhur raste ndaj 31 personave, prej të cilëve 22 persona janë shpallur fajtor, 4 persona janë liruar nga akuza ndërsa për 4 persona është refuzuar aktakuza.

IKD vlerëson se trendi i zgjidhjes së rasteve të korrupsionit po dëshmon se sistemi i drejtësisë, përkatësisht sistemi prokurorial dhe gjyqësor nuk janë duke i trajtuar me prioritet dhe nuk janë duke dëshmuar vullnet për luftimin e korrupsionit, sidomos korrupsionit të nivelit të lartë.

## II. METODOLOGJIA

IKD sikurse në raportet paraprake me qëllim që të përpiloj raporte periodike sa më gjithëpërfshirëse dhe analitike, në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Hulumtimi i zbatimit të Planit të Veprimit, fillimisht ka ardhur si rezultat i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Institutit të Kosovës për Drejtësi, në të cilin janë përcaktuar obligimet e ndërsjella sa i përket monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të këtij plani. IKD dhe KPK ende nuk kanë nënshkruar vazhdimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe prej 1 janarit 2015 monitorimi është bërë në praktikat e zbatuara më parë në katër raportet periodike, duke përfshirë monitorimin e tërësishëm të Planit të Veprimit, përjashto sigurimin e akteve juridike, të cilat nuk janë kërkuar në mungesë të nënshkrimit të memorandumit. Megjithatë, IKD ka vazhduar monitorimin, bazuar në obligimet e Planit të Veprimit dhe duke u mbështetur në indikatorët e krijuar më parë ka bërë për matjen e progresit të zbatimit të këtyre obligimeve. Hulumtimi është bazuar në të dhënat statistikore të siguruar nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit si dhe shtatë Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore të Kosovës për veprat penale të korrupsionit<sup>4</sup>. Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhur në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet dhe personat në të gjitha fazat e procedurës në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës. Ekzistojnë dy kategori të rasteve të korrupsionit, për të cilat IKD ka siguruar të dhëna nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive. Kategoria e rasteve të hetimeve për të cilat janë ngritur kallëzimet penale nga parashtruesit, apo siç njihen në Prokurori të Shtetit si PP si dhe kategoria e rasteve për të cilat janë ofruar informata për korrupsion nga parashtruesit, përkatësisht raste të cilat gjenden në fazën e grumbullimit të informacioneve, apo siç njihen në Prokurori të Shtetit si PPN. Për këto dy kategori të rasteve të korrupsionit, IKD ka mbledhur të dhënat për gjendjen e tyre në fillim të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013, për pranimin e rasteve të reja nga këto kategori, për zgjidhjen e tyre dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre gjatë periudhës raportuese si dhe për gjendjen e rasteve të cilat kanë mbetur të pazgjidhura në fund të Planit të Veprimit më 30 shtator 2014. Baza e të

<sup>4</sup> Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit ka përcaktuar veprat penale kundër korrupsionit, të cilat janë listuar, bazuar në Kodin e vjetër (2003) dhe Kodin e ri Penal (2012). Plani përmban 13 vepra penale të Kodit të vjetër Penal që përfshijnë veprat penale nga kapitulli XVIII (19): Neni 339 - "Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit", neni 340 - "Përoetësimi gjatë ushtrimit të detyrës", neni 341- "Mashtrimi në detyrë", neni 342- "Përdorimi i paautorizuar i pasurisë", neni 343- "Marrja e ryshfetit", neni 344- "Dhënia e ryshfetit", neni 345- "Ushtrimi i ndikimit", neni 346- "Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore", neni 347 - "Zbulimi i fshehtësisë zyrtare", neni 348 - "Falsifikimi i dokumenteve zyrtare", neni 349 - "Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme", neni 350 - "Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria" si dhe neni 351 - "Përoetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit gjyqësor". Plani i Veprimit nga Kodi i ri Penal ka përfshirë 19 vepra penale kundër korrupsionit nga kapitujt XXXIV (34) dhe XXV (15). Veprat nga kapitulli XXXIV (34) përfshijnë: neni 422 - "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", neni 423 - "Keqpërdorimi i informatës zyrtare", neni 424 - "Konflikti i interesit", neni 425 - "Përoetësimi në detyrë", neni 426- "Mashtrimi në detyrë", neni 427 - "Përdorimi i paautorizuar i pasurisë", neni 428 - "Marrja e ryshfetit", neni 429 - "Dhënia e ryshfetit", neni 430 - "Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj", neni 431 - "Ushtrimi i ndikimit", neni 432- "Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore", neni 433 -"Zbulimi i fshehtësisë zyrtare", neni 434 - "Falsifikimi i dokumentit zyrtar", neni 435 -"Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme", neni 436 -"Përoetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor", neni 437 - "Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare", ndërsa veprat nga kapitulli XXV (15) përfshijnë: neni 290 - "Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike", neni 291 - "Lidhja e kontratës së dëmshme" dhe neni 316 - "Dhënia e paarsyeshme e dhuratave".

dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e Planit të Veprimit, përkatësisht me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët. Përmes statistikave IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilin prokurori, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit, për vjetërsinë e rasteve të denoncuara për korrupsion dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

IKD ka vendosur një indikator të bazuar në Planin e Veprimit për të bërë matjen e progresit në zbatimin e këtij plani. Indikatorin kryesor është përcaktuar me gjendjen e rasteve të pazgjidhura të korrupsionit në fillim me hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit me 4 nëntor 2013 dhe progresin e zgjidhjes së këtyre rasteve nga prokurorët. Pra, shkalla e zbatimit të këtij plani është bazuar në zgjidhjen apo moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit, të cilat kanë qenë të regjistruara si të pazgjidhura deri më datën 4 nëntor 2013. IKD ka analizuar dhe paraqitur edhe zgjidhjen e rasteve të reja të pranuar gjatë periudhës prej 4 nëntorit 2013 deri në përfundim të këtij plani më 31 mars 2015.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, ushtrueses së detyrës së Kryeprokurores së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe shtatë Kryeprokurore të Prokurorisë Themelore të Kosovës. Me të gjithë këta bartës të funksioneve prokuroriale dhe menaxherë të prokurorisë, IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e Planit të Veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport. IKD gjithashtu ka monitoruar mbledhjet e Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me aktivitetet dhe vendimet rreth këtij Planit të Veprimit.

Gjithashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin për zgjidhje të problemeve në luftimin e korrupsionit, përkatësisht në zbatimin sa më efikas dhe efektiv të Planit të Veprimit, IKD ka mbledhur dhe analizuar në detaje edhe dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

**a) TRENDI I RASTEVE TË PAZGJIDHURA**

Këshilli Prokurorial i Kosovës (në vazhdim, KPK) ka vazhduar me zbatimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit (në vazhdim, Plani i Veprimit) edhe për periudhën janar, shkurt, mars 2015. Prej hyrjes në fuqi të këtij Plani të Veprimit, Instituti i Kosovës për Drejtësi (në vazhdim, IKD), në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit<sup>5</sup> me KPK-në ka bërë monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të zbatimit të këtij Plani të Veprimit. Deri më tash IKD ka publikuar katër (4) raporte periodike rreth monitorimit dhe zbatimit të këtij Plani të Veprimit, ndërsa ky është raporti i pestë periodik.


Trendi i numrit të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit dhe personave të përfshirë në këto raste në këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015) është rritur në fund, nëse krahasohet me periudhat e mëparshme. Me hyrjen në fuqi të Planit të Veprimit, prokuroritë kanë pasur në punë 516 raste të pazgjidhura me 1,682 persona, ndërsa më 31 mars 2015 kanë mbetur 556 raste të pazgjidhura me 1,652 persona. Pra, kemi një rritje të numrit të rasteve të pazgjidhura, ndërsa një zvogëlim të numrit të personave ndaj të cilëve nuk janë zgjidhur rastet<sup>6</sup>. IKD ka bërë pesë prerje kohore për të bërë krahasim të trendit të rasteve të pazgjidhura dhe personave për periudhën 4 nëntor 2013, 30 qershor 2014, 30 shtator 2014, 31 dhjetor 2014 dhe 31 mars 2015. Shih tabelën 1.

---

<sup>5</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi me datën 27 dhjetor 2013 kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi "Lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit lidhur me Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit". Këshilli Prokurorial i Kosovës, 27 dhjetor 2013.

*Shënim:* IKD dhe KPK ende nuk e kanë nënshkruar vazhdimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për monitorimin e Planit të Veprimit për rastet e korrupsionit. KPK ka krijuar një Komision të përbërë prej tre anëtarëve të KPK-së (Sylë Hoxha, Sevdije Morina dhe Teki Bokshi) për të vlerësuar përmbajtjen e memorandumit dhe për ta vendosur për votim në KPK. Megjithatë, për shkak të zhvillimeve për procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit kjo çështje ende nuk është vendosur në rend dite në mbledhjet e KPK-së.

<sup>6</sup> *Shënim:* Numri i rasteve dhe personave në lëndët e korrupsionit mund të ndryshojë, varësisht prej mënyrës së zgjidhjes. Ndodh që në një rast (kallëzim penal) të jenë të përfshirë 20 persona të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, ndërsa në vijim zgjidhja për persona të bëhet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë këtu hudhjen, pushimin apo ngritjen e aktakuzës ndaj personave të caktuar të të njëjtit rast. Prandaj, IKD sqaron se numri i personave në secilën rubrikë përputhet 99%, ndërsa numri i rasteve mund të ndryshoj për arsyen e lartcekur. Për të qenë të saktë në analizimin e statistikave, IKD-ja ka i referohet veç e veç rasteve dhe personave të cilët janë të evidentuara në regjistrat e Këshillit Prokurorial të Kosovës.



**Tabela 1 - Trendi i rasteve të korrupsionit të pazgjidhura në pesë periudha kohore: 4 nëntor 2013, 30 qershor 2014, 30 shtator 2014, 31 dhjetor 2014 dhe 31 mars 2015.**

Sipas trendit të paraqitur në tabelën 1, rezulton se prokuroritë nuk po arrijnë të ndryshojnë shumë gjendjen fillestare të rasteve të pazgjidhura, të cilat i kanë pasur në fillim të Planit të Veprimit. Derisa në fillim ishin 1,682 persona ndaj të cilëve nuk janë zgjidhur rastet, më 31 mars 2015 kanë mbetur 1,652 persona ndaj të cilëve nuk janë zgjidhur rastet e korrupsionit, apo vetëm 2 % më pak persona se sa kanë qenë në fillim të Planit të Veprimit.

PTh në Prishtinë vazhdon të përballet me një trend të rritjes së rasteve të pazgjidhura. Kjo prokurori nuk ka arritur të ndikoj në uljen e numrit të rasteve të pazgjidhura, përkundrazi ka shënuar rritje të lartë. Derisa më 4 nëntor 2013 në fillim të Planit të Veprimit kishte 224 raste të pazgjidhura me 777 persona, në fund më 31 mars 2015, numri i rasteve të pazgjidhura është rritur në 344 raste me 1,015 persona, që rezulton me 238 persona më shumë apo 23% më shumë në fund të muajit mars 2015.

Trendi i rritjes së rasteve të pazgjidhura ka vazhduar edhe në PSRK. Për dallim prej PTh në Prishtinë, në të cilën trendi i rritjes së rasteve të pazgjidhura ishte 23% më shumë se sa kanë qenë në fillim, në PSRK, trendi e rritjes ka qenë në përqindje më të vogël. PSRK në fillim të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 ka pasur 35 raste të pazgjidhura ndaj 232 personave, ndërsa më 31 mars 2015 i kanë mbetur 46 raste të pazgjidhura të korrupsionit ndaj 242 personave apo 4 % më shumë sesa ka pasur në fillim të Planit të Veprimit.

Ndërsa, prokuroritë tjera të gjitha kanë arritur të zvogëlojnë numrin e rasteve të pazgjidhura, në krahasim me gjendjen fillestare të hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit. Vëreni në tabelën 2, trendin e rritjes së rasteve të pazgjidhura për secilën prokurori, në pesë periudha kohore që përfshijnë 4 nëntorin 2013 (*hyrja në fuqi e Planit të Veprimit*), 30 qershor 2014 (*fundi i zbatimit të Planit të Veprimit për rastet e regjistruara deri më 4 nëntor 2013*), 30 shtator 2014 (*vlerësimi i tretë periodik i IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit për tre muajt korrik, gusht, shtator 2014*, 31 dhjetor 2014 (*vlerësimi i katërt periodik i IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit për tre muajt tetor, nëntor, dhjetor 2014*) ) si dhe 31 mars 2015 (*vlerësimi i pestë periodik i IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit për tre muajt janar, shkurt, mars 2015*).

Prokurori i Shtetit		4 nëntor 2013		30 qershor 2014		30 shtator 2014		31 dhjetor 2014		31 mars 2015	
		Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
1	PSRK	35	232	41	221	47	237	49	261	46	242
2	Prishtinë	224	777	346	935	355	978	321	913	344	1015
3	Prizren	70	175	27	49	33	85	25	64	23	60
4	Pejë	37	86	24	38	22	45	27	66	26	59
5	Gjilan	23	81	7	9	7	12	6	13	11	26
6	Mitrovicë	64	141	61	153	62	157	56	141	60	146
7	Ferizaj	37	126	27	56	30	62	32	72	28	71
8	Gjakovë	26	64	15	27	19	37	14	26	18	33
9	Total:	516	1682	548	1488	575	1613	530	1,556	556	1,652

**Tabela 2 - Diferenca e rasteve të pazgjidhura në fillim të hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013, më 30 qershor 2014, 30 shtator 2014, 31 dhjetor 2014 dhe në fund më 31 mars 2015.**

Sikurse në raportet e kaluara, IKD i ka kushtuar rëndësi të veçantë pasqyrimin të të gjitha rasteve të pazgjidhura në fillim më 1 janar 2015, për secilën prokurori, të cilat janë të vjetra ndër vite. Në tabelën 3, vëreni rastet e pazgjidhura me numrin e personave, të cilat i takojnë viteve 2001, 2004, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe rastet e reja të vitit 2014.

Rastet e pazgjidhura me persona në fillim (1 janar 2015)	2001		2004		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK													7	30	5	27	6	35	7	38	24	131	49	261
Prishtinë	1	1	1	1	4	14	8	30	15	41	2	2	13	42	19	98	33	112	63	274	162	298	321	913
Prizren											1	4	1	1	1	1	1	1	3	4	18	53	25	64
Pejë													1	1					6	15	20	50	27	66
Gjilan																					6	13	6	13
Mitrovicë											1	2	1	2	4	4	9	23	17	59	24	51	56	141
Ferizaj			1	4			1	2					2	4			1	4	9	25	18	33	32	72
Gjakovë																	1	1	6	11	7	14	14	26
<b>Total:</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>14</b>	<b>9</b>	<b>32</b>	<b>15</b>	<b>41</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>25</b>	<b>80</b>	<b>29</b>	<b>130</b>	<b>51</b>	<b>176</b>	<b>111</b>	<b>426</b>	<b>279</b>	<b>643</b>	<b>530</b>	<b>1,556</b>

Tabela 3 - Rastet e pazgjidhura me persona në fillim të periudhës raportuese (1 janar 2015)

Siç shihet në tabelën më lartë, në sistemin prokurorial ende kemi lëndë të korrupsionit të pazgjidhura që datojnë prej vitit 2001. IKD vlerëson se këto të dhëna janë dëshmi se qytetarët dhe agjencitë e ndryshme që e zbatojnë ligjin kanë bërë kritika me të drejtë ndaj punës së prokurorive. Fakti se parashtruesit kanë dorëzuar kallëzime penale për rastet e korrupsionit para më shumë se një dekade dhe ende nuk janë zgjidhur dëshmon zhgënjimin e vazhdueshëm të tyre dhe humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial. Sado që prokurorët kanë zgjidhur disa prej këtyre rasteve shumë të vjetra të korrupsionit, siç mund të vërehet, numri i rasteve të vjetra të pazgjidhura vazhdon të mbetet shqetësues.

Në fillim të kësaj periudhe raportuese (1 janar 2015) PTh në Prishtinë vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura, gjithsej 321 raste me 913 persona. Pason PSRK, me gjithsej 49 raste me 261 persona. PTh në Mitrovicë me gjithsej 56 raste me 141 persona, PTh në Ferizaj me gjithsej 32 raste me 72 persona, për të vazhduar më pas me PTh në Prizren me gjithsej 25 raste të pazgjidhura me 64 persona, PTh në Pejë me gjithsej 27 raste me 66 persona, PTh në Gjakovë me gjithsej 14 raste me 26 persona dhe PTh në Gjilan me 6 raste të pazgjidhura me 13 persona.

IKD shpreh shqetësim për rastet e pazgjidhura të korrupsionit, që datojnë nga viti 2001 dhe vlerëson se kjo është dëshmi për mungesën e efikasitetit të prokurorive, përkundër faktit se këto lëndë, janë shpallur si lëndë për tu zgjidhur me prioritet absolut.

IKD në tabelën në vazhdim ka paraqitur rastet e korrupsionit me numrin e personave të përfshirë, të cilat kanë qenë të pazgjidhura në fillim të kësaj periudhe raportuese (më 1 janar 2015), sipas parashtruesve të këtyre rasteve nëpër vite.

PP Rastet me persona me parashtrues ndër vite në fillim të periudhës raportuese (1 janar 2015)	2001	2004	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
AKK				10	16		19	19	91	98	122	375
ATK							2					2
Doganat		4								9	1	14
EULEX							12	11	1	6	24	30
IPK									10	8	24	42
PK			7	13	14	3	25	27	45	236	276	646
Qytetari							11	25	11	37	67	151
I dëmtuari				7	1	5	7	5	5	28	79	137
Adm. Komunale								1			2	3
E Pranuar në kompet.											44	44
Titullari i pronës-OP	1	1	7	2	10		4		13	1	13	52
Autoriteti Pyjor										2		2
Prokurori vetiniciat.								41		1	15	57
Paidentifikuar								1				1
<b>Total:</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>32</b>	<b>41</b>	<b>8</b>	<b>80</b>	<b>130</b>	<b>176</b>	<b>426</b>	<b>643</b>	<b>1,556</b>

Tabela 4 – Trendi i rasteve të pazgjidhura me persona, sipas parashtruesve ndër vite në fillim të kësaj periudhe raportuese (1 janar 2015).

Policia e Kosovës (në vazhdim si PK) vazhdon të jetë parashtruesi me numrin më të madh të rasteve të korrupsionit, me gjithsej 646 persona. Siç mund të vërehet në tabelën 4, nëpër prokurori ka ende raste të pazgjidhura të korrupsionit që PK i ka parashtruar qysh në vitin 2007. Pas PK-së, si parashtrues me numrin me të madh të rasteve është Agjencia Kundër Korrupsionit (në vazhdim si AKK), e cila në fillim të kësaj periudhe raportuese (më 1 janar 2015) rezulton se ka raste të pazgjidhura që ka parashtruar ndaj 375 personave. Pas AKK-së, pasojnë kallëzimet penale të pazgjidhura të parashtruara nga qytetarët dhe palët e dëmtuara, me gjithsej 151 përkatësisht 137 persona. Pasonjë titullarët e pronave, të cilët kanë raste të pazgjidhura të parashtruara ndaj 52 personave, ndër to edhe rasti më i vjetër i parashtruar qysh në vitin 2001.

IKD sikurse në raportet e kaluara, vlerëson se jo-efikasiteti në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, ndikon në dështimin e zbulimit të personave të korruptuar, në ndjekjen dhe gjykimin e tyre, faktikisht në amnistinë e të korruptuarve. Ajo që është më e rëndësishmja, ndikon në humbjen e besimit të qytetarëve në drejtësi. Ankesat më të shpeshta të qytetarëve të Republikës së Kosovës çdo ditë bëhen për jo-efikasitetin e sistemit të drejtësisë, për shkak të zvarritjes së zgjidhjes së rasteve të tyre<sup>7</sup>. Fakti që ende kanë mbetur pa u zgjidhur rastet e korrupsionit të parashtruara në vitin 2001 është tejet shqetësues, sepse dëshmon se prokurorët, në këto raste ndër vite nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore. IKD vlerëson se kjo ndikon drejtpërdrejt tek qytetarët, tek të cilët dërgon mesazhin se luftimi i korrupsionit në mënyrë pasive është duke u amnistuar nga vetë prokurorët. Përmes këtyre rezultateve bien edhe zotimet publike të zyrtarëve më të lartë që udhëheqin sistemin gjyqësor dhe prokurorial, të cilët përkundër politikave dhe strategjive të zhvilluara dhe miratuara, nuk po arrijnë t'i zbatojnë në praktikë.<sup>8</sup> Mungesa e rezultateve konkrete nga moszbatimi në praktikë i legjislacionit pozitiv në luftimin e korrupsionit, ka ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e vlerësimeve negative të Komisionit Evropian, i cili përmes Komisionit Vlerësues lidhur me plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave, i cili ka vlerësuar se përkundër disa përmirësimeve, nuk ka rezultate konkrete dhe përfundimtare të rasteve gjyqësore sa i përket luftës kundër korrupsionit.<sup>9</sup> Republika e Kosovës, duhet të shënojë rezultate për të avancuar drejt proceseve të integritetit evropian, ndërsa përqindja e zbatimit të Planit të Veprimit, deri në këtë periudhë raportuese, është dëshmi se Kosova ka mungesë të rezultateve të prekshme në ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit.

Gjithashtu, mungesa e rezultateve në luftimin e korrupsionit edhe në këtë periudhë raportuese, ka ndikuar drejtpërdrejt në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin prokurorial. Raporti i UNDP-së për periudhën nëntor 2014 – mars 2015, tregon se **besimi i qytetarëve**

<sup>7</sup> *Shënim*: Zyra e Prokurorit Disiplinor si mekanizëm i brendshëm i disiplinimit të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, vazhdimisht pranon ankesa prej qytetarëve që parashtrojnë rastet e tyre ndaj gjykatësve dhe prokurorëve për zvarritje të zgjidhjes së rasteve.

<sup>8</sup> Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2013. F.13.

<sup>9</sup> "Raporti i dytë i progresit i Kosovës në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfjesit për liberalizimin e vizave". Raport nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian F.8. Komisioni Evropian. Bruksel. 24 korrik 2014.

**në punën e Prokurorit të Shtetit, ka shënuar rënien më të madhe të të gjitha kohërave, duke pësuar rënie të kënaqshmërisë në vetëm 17 % në muajin mars 2015, derisa në nëntor 2014 ishte 22.8%.<sup>10</sup>**

Besimi i qytetarëve ka rënë në përqindje shqetësuese edhe në sistemin gjyqësor, me të cilin janë të kënaqur vetëm 17.2% të qytetarëve për periudhën nëntor 2014 – mars 2015. Derisa, në muajin nëntor 2014 kënaqshmëria e qytetarëve me punën e sistemit gjyqësor ishte 22.8%, gjatë kësaj periudhe raportuese nëntor 2014-mars 2015, ka shënuar rënie për 7%.<sup>11</sup>

Rënia e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë është tejet shqetësuese dhe IKD vlerëson se ky trend i zbatimit të Planit të Veprimit, do të vazhdojë të rrezikoj edhe më tutje rënien e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, përkatësisht në ndarjen e drejtësisë për ta.

IKD në tabelën 5 ka paraqitur rastet e pazgjidhura të korrupsionit, sipas parashtruesve të kallëzimeve penale dhe cilësimit të veprave penale për çka dyshohen personat e ngarkuar në këto akte juridike. Siç mund të vërehet vepra më e shprehur mbetet vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, që dëshmon se korrupsioni shtrihet kryesisht në institucionet publike, në të cilat ushtrimi i pozitës dhe autoritetit zyrtar bëhet duke keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar. IKD vlerëson si tejet shqetësues faktin se numri më i madh i rasteve të parashtruara të korrupsionit i takon veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ndërsa në këto raste ku janë përfshirë zyrtarë të ndryshëm për vite të tëra kanë ushtruar funksionet e tyre, përderisa rastet ndaj tyre nuk janë trajtuar nga prokurorët dhe kanë mbetur të pazgjidhura. Për më tepër shih tabelën 5 në vazhdim.

---

<sup>10</sup> *Shënim:* Sistemi prokurorial në periudhën nëntor 2014 deri në mars 2015 ka shënuar pothuajse pikën më të ulët të të gjitha kohërave të besimit të qytetarëve në punën e prokurorisë me vetëm 17 % (vetëm në vitin 2010 ka qenë më e ulët në 15.1 %). “Pulsi Publik 9” (Prishtinë: UNDP Kosovë, prill 2015), f.2.

<sup>11</sup> *Shënim:* Gjyqësori po ashtu nuk bën përjashtim në rënien e nivelit të kënaqshmërisë me punën e tij. Përqindja e kosovarëve që janë të kënaqur me punën e gjykatave të Kosovës ka rënë nga 17.2 % në mars 2015. Derisa, në nëntor 2014 kënaqshmëria me gjyqësorin ishte 22.8%. “Pulsi Publik 9” (Prishtinë: UNDP Kosovë, prill 2015), f.2.

Rastet të pazgjdhura sipas parashtruesve dhe veprave penale në fillim të periudhës raportuese (1 janar 2015)	Persona total	Mos raportimi i pasurisë	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Arkëtimi i kundërligjshëm i pasurisë	Dhënia e ryshfetit	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	Marrja e ryshfetit	Mashtrimi në detyrë	Nxjerrja e kundërligjshme e varadimitave dhe shërbimeve	Përvetësimi në detyrë	Ushtrimi i ndikimit	Keqpërdorimi i autorizimeve	Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Lidhja e kontratës së dëmshme	Keqpërdorim i Informates zyrtare	Shpërlaje e parave	Cenimi i të drejtave të patentës	Tregtia e Ndaluar	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmëtimi ose shitja e mallave të tregëtueshëm	Nuk I përket v. penale	Pa vepër
AKK	375	65	277			16			1	2	12				1		1				
PK	646	1	467	101	4	13	12	4	5	23	1	1		4				7	1		2
IPK	42		33			1	3			5											
I dëmtuari	137	1	117			6	1		1	9		2									
ATK	2		2																		
Autoriteti Pyjor	2		2																		
Doganat	14		5									4	5								
Prokurori vetiniciat.	57		52							5											
Qytetari	151		127		2	5		7				2	8								
Titullari i pronës-OP	52		46					2		4											
Pranuar kompet.	44		39			1		1			1					1					1
EULEX	30		18		3		3					6									
Adm. Komunale	3		2							1											
Paidentifikuar	1		1																		
<b>Totali</b>	<b>1,556</b>	<b>67</b>	<b>1,188</b>	<b>101</b>	<b>9</b>	<b>42</b>	<b>19</b>	<b>14</b>	<b>7</b>	<b>49</b>	<b>14</b>	<b>15</b>	<b>13</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>

Tabela 5 - Trendi i rasteve të pazgjdhura të personave në fillim të kësaj periudhe raportuese sipas parashtruesve dhe veprave penale (1 janar 2015).

Sipas të dhënave zyrtare të KPK-së, rezulton se nga gjithsej 1,556 persona të përfshirë në rastet e korrupsionit në fillim të muajit janar, 1,188 persona dyshoheshin për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. PK është parashtruesi me numrin më të madh të personave, e cila nga gjithsej 646 persona të përfshirë në kallëzimet penale, 467 të tillë janë për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” e pasuar nga AKK me 277 persona për veprën e njëjtë nga gjithsej 375 personave për të cilët kishte bërë kallëzime penale.

### b) TRENDI I RASTEVE TË PRANUARA GJATË PLANIT TË VEPRIMIT

PSRK dhe PTh-të, përveç rasteve të vjetra që kanë pasur në punë, gjatë periudhës raportuese (janar, shkurt, mars 2015), kanë pranuar raste të reja me persona të dyshuar për veprat penale të natyrës korruptive. Gjatë monitorimit të Planit të Veprimit, IKD ka identifikuar se për këtë periudhë raportuese, prokuroritë kanë pranuar në punë gjithsej 90 raste të reja me 202 persona. Në tabelën 6 janë paraqitur të gjitha rastet e reja të pranuar në secilën prokurori gjatë kësaj periudhe raportuese.

PP Raste dhe persona të pranuar sipas prokurorive gjatë periudhës raportuese (1 janar - 31 mars 2015)	Raste në janar 2015	Persona në janar 2015	Raste në shkurt 2015	Persona në shkurt 2015	Raste në mars 2015	Persona në mars 2015	Raste total	Persona total
PSRK			2	5			2	5
Prishtinë	6	22	13	56	6	10	25	88
Prizren	4	5	1	1	5	7	10	13
Pejë	3	5	5	5	4	4	12	14
Gjilan	3	4	4	6	4	9	11	19
Mitrovicë	2	2	6	16	4	8	12	26
Ferizaj	1	1	2	4	4	10	7	15
Gjakovë	2	5	3	10	6	7	11	22
<b>Total</b>	<b>21</b>	<b>44</b>	<b>36</b>	<b>103</b>	<b>33</b>	<b>45</b>	<b>90</b>	<b>202</b>

Tabela 6 - Rastet dhe personat të pranuar për secilin muaj (periudha 1 janar - 31 mars 2015).

Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelë gjatë kësaj periudhe raportuese (janar, shkurt, mars 2015), PTh në Prishtinë është prokuroria që ka pranuar numrin më të madh të rasteve, me gjithsej 25 raste me 88 persona. Pason, PTh në Mitrovicë me 12 raste me 26 persona, PTh në Gjakovë me 11 raste dhe 22 persona, PTh në Gjilan 11 raste me 19 persona, PTh në Ferizaj 7 raste me 15 persona, PTh në Pejë 12 raste me 14 persona, , PTh në Prizren me 10 raste me 13 persona dhe PSRK e cila ka pranuar vetëm 2 raste me 5 persona.

Bazuar në këto të dhëna të kategorizuara nga IKD, del se numri më i madh i rasteve të pranuar gjatë periudhës raportuese, figuron të jetë në muajin shkurt, gjithsej 36 raste me 103 persona, për të vijuar me pas në mars me 45 raste me 90 persona.

IKD gjithashtu ka identifikuar rastet e reja sipas parashtruesve të kallëzimeve penale, me ç’rast sërish rezulton se parashtruesi me numrin më të madh të kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit, figuron të jetë PK. Në tabelën 7 janë paraqitur rastet e reja të pranuar gjatë kësaj periudhe raportuese sipas parashtruesve:

<b>TOTAL PP - Raste dhe persona të pranuar sipas parashtruesve (janar - mars 2015)</b>	<b>Raste në janar 2015</b>	<b>Persona në janar 2015</b>	<b>Raste në shkurt 2015</b>	<b>Persona në shkurt 2015</b>	<b>Raste në mars 2015</b>	<b>Persona në mars 2015</b>	<b>Raste total</b>	<b>Persona total</b>
<b>AKK</b>	2	6	4	4	2	2	8	12
<b>PK</b>	11	21	15	26	19	29	45	76
<b>IPK</b>	1	1	2	2	1	7	4	10
<b>Dogana</b>			1	4	1	2	2	6
<b>I dëmtuari</b>	5	13	10	55	8	10	23	78
<b>Qytetari</b>	2	3					2	3
<b>Pranuar kompet.</b>			4	12	2	5	6	17
<b>Total:</b>	21	44	36	103	33	55	90	202

**Tabela 7 - Trendi i rasteve dhe personave të pranuar sipas parashtruesve për secilin muaj.**

Prej 202<sup>12</sup> personave, qytetarët kanë qenë parashtruesit më numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale për korrupsion, gjithsej 23 raste me 78 persona, të pasuar nga PK me 45 raste me 76 persona. Të gjitha në mënyrë të detajuar janë paraqitur në tabelën mësipërme.

### c) TRENDI I RASTEVE TË ZGJIDHURA

Për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015), vërehet një ulje e performancës së pothuajse të gjitha prokurorive në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit krahasuar me tremujorin paraprak (tetor, nëntor dhe dhjetor 2014). Në tre mujorin paraprak ishin zgjidhur 165 raste me 325 persona, ndërsa gjatë kësaj periudhe raportuese janë zgjidhur 62 raste me 119 persona. Krahasuar me tremujorin paraprak, rezulton se prokuroritë nuk kanë arritur të zgjidhin as përgjysmë raste sa kishin zgjidhur në tremujorin paraprak, përkatësisht 103 raste me 206 persona më pak. Në tabelën 8, janë pasqyruar rastet e zgjidhura me persona për secilën prokurori për periudhën raportuese 1 janar - 31 mars 2015.

---

<sup>12</sup> Prej raste të parashtruara ku përfshihen 202 persona, parashtruesit kanë ngarkuar 140 persona për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 20 persona për veprën penale “Marrja e ryshfetit”, 2 persona për veprën penale “Përvetësimi në detyrë”, 1 person për veprën penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, 17 persona për veprën penale “Dhënia e ryshfetit”, 6 persona për veprën penale “Mos raportimi i pasurisë”, 5 persona për veprën penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”, 2 persona për veprën penale “Ushtrimi i ndikimit”, 4 persona për veprën penale “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare”, 1 person për veprën penale “Përdorimi i paautorizuar i narkotikëve”, 1 person për veprën penale “Lirimi i kundërligjshëm nga liria”, 2 persona për veprën penale “Kontrabandimi i mallrave” dhe 1 person për veprën penale e cila nuk është identifikuar në regjistër.

PP - Raste dhe persona të zgjidhura në secilën prokurori për periudhën raportuese (janar - mars 2015)	Periudha raportuese (janar - mars 2015)	
	Raste	Persona
PSRK	3	13
Prishtinë	8	8
Prizren	5	10
Pejë	11	22
Gjilan	7	11
Mitrovicë	9	22
Ferizaj	10	15
Gjakovë	9	18
<b>Total</b>	<b>62</b>	<b>119</b>

Tabela 8 - Trendi i rasteve të zgjidhura me persona për secilin muaj për secilën prokurori

PTh në Pejë është prokuroria me numrin më të madh të rasteve të zgjidhura për këtë tremujor me gjithsej 11 raste me 22 persona, e pasuar nga PTh në Ferizaj me 10 raste dhe 15 persona të zgjidhura, PTh në Gjakovë 9 raste me 18 persona, PTh në Mitrovicë 9 raste me 22 persona, PTh në Prishtinë 8 raste me 8 persona, PTh në Gjilan 7 raste me 11 persona, PTh në Prizren 5 raste me 10 persona dhe PSRK 3 raste me 13 persona.

PTh në Prishtinë e cila është ndër prokuroritë me numrin më të vogël të rasteve të zgjidhura për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015),<sup>13</sup> në tre mujorin paraprak (tetor, nëntor, dhjetor 2014) ishte prokuroria me numrin më të madh të rasteve të zgjidhura. Sipas Kryeprokurorit të PTh në Prishtinë, arsyet kryesore për mungesën e efikasitetit të PTh në Prishtinë për këtë periudhë raportuese ndër të tjera ishin: bartja e prokurorëve dhe stafit në objektin e ri të prokurorisë (Pallatin e Drejtësisë), bartja e lëndëve,

<sup>13</sup> Shih tabelën nr 8 Trendi i rasteve të zgjidhura me persona për secilin muaj për secilën prokurori.

Instituti i Kosovës për Drejtësi  
 bartja e Gjykatës Themelore të Prishtinës në të njëjtin objekt (Pallati i Drejtësisë), kushtet objektive dhe problemet teknike me ambientimin në këtë objekt. Këto arsye kanë ndikuar ë rënien e performancës së PTh në Prishtinë për këtë tre mujor të parë të vitit 2015.<sup>14</sup> Vlen të theksohet se efikasiteti i kësaj prokurorie për tre mujorin paraprak, i cili ishte rritur pas një ri-organizimi të punës, si rezultat i zbatimit të rekomandimit të IKD-së.<sup>15</sup>

Megjithëse, ka një numër të vogël të rasteve të zgjidhura për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), Kryeprokurorët shprehen se janë të kënaqur me zbatimin e Planit të Veprimit dhe punën e prokurorive që ata udhëheqin.<sup>16</sup> Kryeprokurori i PTh në Mitrovicë, vlerëson punën e prokurorëve dhe rezultatet e arritura, krahasuar me kushtet e punës, të cilat kërkon që të përmirësohen.<sup>17</sup> U.d së Kryeprokurori i PTh në Ferizaj, pohon se kjo prokurori ka qenë mjaft efikase marr parasysh kapacitetet që ajo posedon.<sup>18</sup>

IKD vlerëson se situata me numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura dëshmon se prokuroritë nuk janë duke trajtuar me prioritet zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.

<sup>14</sup> IKD, intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë z. Imer Beka, mars 2015, Prishtinë.

<sup>15</sup> *Shënim*: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), më 5 shtator 2014, ka mbajtur një konferencë gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e të gjithë hisedarëve të institucioneve më të larta shtetërore dhe drejtuesve të të gjitha institucioneve të drejtësisë dhe agjencive që e zbatojnë ligjin në luftimin e korrupsionit. Në këtë konferencë me titull: “Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit”, është publikuar raporti voluminoz prej 180 faqesh “Korrupsioni në Kosovë 2: Raport vlerësues gjithëpërfshirës mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit”, i cili ka përfshirë gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet për zbatimin e Planit të Veprimit. Në këtë raport, IKD ka konstatuar se kjo PTh në Prishtinë ka dështuar më së shumti në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, ku vetëm 13% të rasteve ka arritur t’i zgjidhë, apo prej rasteve të korrupsionit ku janë përfshirë 777 persona, ka arritur të zgjidhë raste vetëm ndaj 98 personave, të cilët kanë qenë të regjistruar deri më 4 nëntor 2013. Ndërsa në total (përfshi edhe rastet e pranuar deri më 30 qershor 2014), prokurorët e PTh në Prishtinë, prej 4 nëntorit 2013 deri më 30 qershor 2014, kanë zgjidhur 54 raste ndaj 123 personave.

Për shkak të këtij dështimi, IKD si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës së kësaj prokurorie, ka rekomanduar që të ndërmerren hapa urgjent për të siguruar efikasitet në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Shih rekomandimin e IKD-së h). “KPK duhet të ndërmerr hapa urgjent dhe shumë konkret në zgjidhjen e problemeve në PTh Prishtinë për shkak të ngarkesës dhe cilësisë së kryerësve të veprave penale të korrupsionit. Kjo prokurori ka nevojë për menaxhim efikas dhe resurse shtesë me prokurorë dhe staf mbështetës”. Në konferencën e IKD-së të mbajtur më 5 shtator 2014, Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit, znj. Laura Pula, dhe Kryeprokurori i PTh në Prishtinë, z. Imer Beka, kanë dhënë zotime publike për zbatimin e këtij rekomandimi. Pas konferencës, më datën 11 shtator 2014, Koordinatorja Nacionale dhe Kryeprokurori i PTh në Prishtinë, kanë mbajtur një mbledhje të kolegjiut, e cila ka zgjatuar me orë të tëra, me të gjithë prokurorët e PTh në Prishtinë për të diskutuar rezultatet e dobëta të kësaj prokurorie në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Në këtë mbledhje, Kryeprokurori dhe Koordinatorja Nacionale kanë ndërmarrë veprime konkrete në riorganizimin e punës dhe mënyrën e raportimit për të shtuar efikasitetin e prokurorëve për t’i zgjidhur rastet e korrupsionit, gjë që ka dhënë rezultatet e para.

<sup>16</sup> IKD, intervistë me kryeprokuroret: z. Metush Biraj – U.d i Kryeprokurorit të PTh në Prizren; z. Agron Galani – Kryeprokuror në PTh në Pejë; z. Shyqeri Sylja – Kryeprokuror në PTh në Mitrovicë dhe znj. Shpresa Bakija – Kryeprokurore në PTh në Gjakovë, mars 2015.

<sup>17</sup> IKD, intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Mitrovicë z. Shyqyri Sylja, mars 2015, Mitrovicë.

<sup>18</sup> IKD, intervistë me U.d të Kryeprokurorit të PTh në Ferizaj z. Rasim Maloku, mars 2015, Ferizaj.

**d) MËNYRA E ZGJIDHJES SË RASTEVE**

Performanca e prokurorive në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit ka qenë dukshëm më e dobët se në tre mujorin paraparak. Sikurse në periudhat paraprake të raportimit, edhe për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), IKD ka identifikuar mënyrën e zgjidhjes për secilën lëndë të zgjidhur për secilën prokurori sipas parashtruesve të rasteve të korrupsionit. Në tabelën 9, janë paraqitur rastet e korrupsionit me persona ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për këtë periudhë raportuese për secilën prokurori. Nga gjithsej 119 persona ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, ndaj 48 personave janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet (për 15 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa për 33 persona kanë pushuar hetimet), ndërsa ndaj 71 personave janë ngritur aktakuza (për 59 persona është ngritur aktakuzë pas zhvillimit të hetimeve, për 6 persona është ngritur aktakuzë e drejtpërdrejt dhe për 6 persona është propozuar shqiptimi i Urdhërit Ndëshkimor). Për më shumë vëreni tabelën e mëposhtme:

PP - Mënyra e zgjidhjes sipas prokurorive për periudhën raportuese (janar - mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
PSRK		2			11	13
Prishtinë		6			2	8
Prizren	1	6			3	10
Pejë	1	14	4	2	1	22
Gjilan		3		1	7	11
Mitrovicë	2	1	1	2	16	22
Ferizaj	2		1	1	11	15
Gjakovë	9	1			8	18
<b>Total</b>	15	33	6	6	59	119

Tabela 9 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit sipas prokurorive

Siç vërehet në tabelën e mësipërme, PTh në Pejë dhe PTh në Mitrovicë janë prokuroritë më efikase sa i përket numrit të personave ndaj të cilëve kanë zgjidhur raste (gjithsej nga 22 persona), e pasuar nga PTh në Gjakovë (18 persona), PTh në Ferizaj (15 persona), PSRK (13 persona), PTh në Gjilan (11 persona), PTh në Prizren (10 persona) dhe PTh në Prishtinë si prokuroria me numrin më të vogël të personave të përfshirë në rastet e zgjidhura për këtë periudhë raportuese.

PTh në Pejë nga gjithsej 22 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura për këtë periudhë raportuese, për më shumë se gjysmën e tyre apo për 15 persona, ka hudhur poshtë rastet dhe ka pushuar hetimet, ndërsa për 7 persona ka ngritur aktakuzë dhe ka propozuar shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor. Gjithashtu, PTh në Gjakovë dominon për rastet e hudhura dhe pushuara. Nga gjithsej 18 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën raportuese në PTh në Gjakovë, ndaj 10 personave janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe pushuar rastet, ndërsa ndaj 8 të tjerëve janë ngritur aktakuza. PTh në Prishtinë nga gjithsej 8 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, për 6 persona ka hudhur poshtë kallëzimet penale dhe ka pushuar hetimet, ndërsa për 2 persona ka ngritur aktakuzë. Nga gjithsej 10 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura në PTh në Prizren, për 7 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar rastet, ndërsa ndaj 3 personave janë ngritur aktakuza.

Ndërsa PSRK, PTh në Gjilan, PTh në Mitrovicë dhe PTh në Ferizaj, ishin prokuroritë që më shumë se 50% të rasteve të zgjidhura, kishin ngritur aktakuza. PTh në Mitrovicë nga gjithsej 22 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, vetëm ndaj 3 personave ka hudhur poshtë kallëzimet penale dhe ka pushuar rastet, ndërsa për 19 persona të tjerë, ka ngritur aktakuza dhe ka propozuar shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor. PSRK nga gjithsej 13 persona, për 11 persona ka ngritur aktakuza, ndërsa për 2 persona ka pushuar hetimet. PTh në Gjilan nga gjithsej 11 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, ndaj 8 personave ka ngritur aktakuza ndërsa ndaj 3 personave ka pushuar rastet. PTh në Ferizaj nga gjithsej 15 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, për 12 persona ka ngritur aktakuza, për 1 person ka propozuar shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, ndërsa për 2 persona ka hudhur poshtë kallëzimet penale.

IKD ka bërë kategorizimin e rasteve të zgjidhura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre sipas parashtruesve të kallëzimeve penale për korrupsion. Për më tepër shih tabelën 10.

PP - Mënyra e zgjidhjes sipas parashtruesve për periudhën raportuese (janar - mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
AKK		6			6	12
PK	6	13	6	6	43	74
I dëmtuari	9	3			1	13
IPK		1			3	4
Qytetari		9				9
EULEX					4	4
Prokurori Vet.		1				1
Pranuar komp.					2	2
<b>Total</b>	<b>15</b>	<b>33</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>59</b>	<b>119</b>

**Tabela 10 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit sipas parashtruesve të kallëzimeve penale**

Nga gjithsej 119 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, prokurorët kanë zgjidhur rastet e parashtruara nga PK ndaj 74 personave. Prej tyre, ndaj 49 personave kanë ngritur aktakuza, ndaj 6 personave kanë propozuar shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, ndërsa ndaj 19 personave kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet (ndaj 6 personave kanë hudhur kallëzimet penale, ndërsa ndaj 13 të tjerëve kanë pushuar hetimet).

Në rastet e zgjidhura nga prokurorët, të cilat janë parashtruar nga palët e dëmtuara, nga gjithsej 13 personave, vetëm ndaj 1 personi prokurorët kanë ngritur aktakuzë, ndërsa për 13 persona kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet.

IKD sikurse në raportet paraprake vazhdon të shprehë shqetësim sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve, ku mbi gjysma e tyre po hudhen poshtë dhe po pushohen hetimet në mungesë të provave dhe dëshmive. Këto statistika dëshmojnë nevojën për të identifikuar problemet rreth këtyre rasteve për të parë se ku qëndrojnë problemet, tek cilësia e kallëzimeve penale, argumentimi i tyre nga parashtruesit apo tek vendimmarrja e prokurorëve. Ky shqetësim dhe rekomandim është bërë vazhdimisht nga IKD në mënyrë që të ndihmohet sistemi prokurorial për të eliminuar këto probleme në të ardhmen.

IKD vazhdon të insistoj tek Këshilli Prokurorial i Kosovës që përmes mekanizmave të saj të shqyrtojë problematikën e dështimit të kallëzimeve penale për të identifikuar problemet rreth cilësisë, argumentimit apo vendimmarrjes së prokurorëve në rastet e korrupsionit. Në këtë drejtim, KPK duhet të shpreh vullnetin e saj, për të identifikuar dhe sanuar problemet me parashtrimin e kallëzimeve penale, për të siguruar ndjekje efikase të kryerësve të veprave penale të korrupsionit në bashkëpunim me të gjitha agjencitë që e zbatojnë ligjin në Kosovë.

IKD vlerëson se përmes këtyre mekanizmave do mundësohej identifikimi i problemeve, për të mundësuar krijimin e politikave adekuate kriminale për ndjekjen e korrupsionit dhe rritjen e kualitetit të arsyetimeve të prokurorëve për vendimet e tyre, të cilat padyshim se do të ndikojnë në besimin e qytetarëve se vendimet e tyre janë të drejta dhe të bazuara në ligj.

#### **IV. ZBATIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR RASTET E REGJISTRUARA DERI MË 4 NËNTOR 2013**

Zbatimi i Planit të Veprimit, sipas dinamikës së përcaktuar në këtë plan, ishte paraparë të përfundonte më 30 qershor 2014, duke pretenduar zgjidhjen e të gjitha lëndëve të vjetra të korrupsionit të cilat ishin regjistruar deri më 4 nëntor 2013.<sup>19</sup>

Sikurse është theksuar më lartë për këtë periudhë raportuese të gjitha prokuroritë kanë zgjidhur gjithsej 62 raste me 119 persona. Sipas analizës statistikore të IKD-së, rezulton se prej 119 personave në total ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet e korrupsionit për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), 42 persona apo 35.29%, i përkasin rasteve të vjetra, përkatësisht rasteve të regjistruara në Plan të Veprimit deri më 4 nëntor 2013.

IKD ka vendosur indikatorë përmes së cilëve, ka bërë matjen e zbatimit të Planit të Veprimit për lëndët e vjetra të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, të cilat janë zgjidhur qysh prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit. Në tabelën 11, IKD ka vendosur lëndët e pazgjidhura në fillim më 4 nëntor 2013, për të vijuar më pas me numrin e tërësishëm të zgjidhjes së këtyre rasteve deri më 31 mars 2015.

**Bazuar në indikatorin e IKD-së për matjen e zbatimit të Planit të Veprimit, rezulton se prokuroritë kanë zgjidhur raste ndaj 900 personave apo kanë arritur të zbatojnë Planin e Veprimit 55%.**

Bazuar në të dhënat e siguruar nga KPK, IKD ka identifikuar se nga gjithsej 1,632 persona të përfshirë në rastet e pazgjidhura në fillim, përkatësisht më 4 nëntor 2013, deri më 31 mars 2015, PSRK dhe PTh-të kanë arritur të zgjidhin lëndët në të cilat janë përfshirë 900 persona apo sikurse është theksuar më lartë 55% të tyre. Për më tepër IKD ka paraqitur në tabelë në mënyrë të detajuar zgjidhjen e këtyre rasteve të Planit të Veprimit, për secilën prokurori.

---

<sup>19</sup> Neni 8.5, "Afatet", "Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit", Këshilli Prokurorial i Kosovës. 4 nëntor 2013

PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas prokurorive për periudhën 4 nëntor 2013 - 31 mars 2015	Totali i personave të pazgjidhura më 4 nëntor 2013	Përqindja e përmbushjes së Planit të Veprimit	Total	Hudhje		Pushim		Aktakuzë UN		Aktakuza të drejtpërdrejta		Aktakuza pas hetimeve	
				Persona	Përqindja	Persona	Përqindja	Persona	Përqindja	Persona	Përqindja	Persona	Përqindja
PSRK	232	53%	123	10	8%	84	68%					29	23%
Prishtinë	777	27%	210	68	32%	48	22%			9	4%	85	40%
Prizren	175	90%	159	38	23%	50	31%			3	1%	68	42%
Pejë	86	100%	92	6	6%	64	69%					22	23%
Gjilan	81	100%	81	18	22%	27	33%			20	24%	16	19%
Mitrovicë	141	62%	88	46	52%	7	8%			10	11%	25	28%
Ferizaj	126	74%	94	13	13%	6	6%	35	37%	2	2%	38	40%
Gjakovë	64	82%	53	7	13%	4	7%					42	79%
<b>Total</b>	<b>1,632</b>	<b>55%</b>	<b>900</b>	<b>206</b>	<b>22%</b>	<b>290</b>	<b>32%</b>	<b>35</b>	<b>3%</b>	<b>44</b>	<b>4%</b>	<b>325</b>	<b>36%</b>

Tabela 11 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve sipas prokurorive për periudhën 4 nëntor 2013 - 31 mars 2015

Siç mund të vërehet nga tabela më sipër, PSRK dhe PTh-të për të realizuar Planin e Veprimit, duhet të zgjidhin rastet e vjetra ndaj 732 personave apo edhe 45 % të Planit të Veprimit. Bazuar në analizën statistikore, mbetet shqetësues numri i madh i rasteve të vjetra të pazgjidhura. Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve të tilla, IKD ka identifikuar se prokurorët më shumë se në gjysmën e rasteve që i kanë zgjidhur, kanë nxjerrë vendime për hudhjen poshtë të kallëzimeve penale dhe për pushimin e hetimeve. IKD ka identifikuar se prokurorët 22 % të rasteve që i kanë zgjidhur i kanë hudhur poshtë kallëzimet penale, 32 % të rasteve i kanë pushuar hetimet, ndërsa rreth 40 % të rasteve kanë ngritur aktakuza derisa në 3% të rasteve të vjetra të zgjidhura, kanë propozuar shqiptimin e urdhrin ndëshkimor.

PTh në Prishtinë vazhdon të jetë prokuroria me efikasitetin më të dobët në përmbushjen e obligimeve të Planit të Veprimit. **PTh në Prishtinë** ka zgjidhur raste vetëm ndaj 27% të personave, sa kishte edhe në periudhën e tremujorit paraprak, apo vetëm ndaj 210 prej

777 personave, të cilët kanë qenë të regjistruar në Planin e Veprimit deri më 4 nëntor 2013.<sup>20</sup> *Pra, PTh në Prishtinë për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015), nuk ka zgjidhur asnjë rast të vjetër, të regjistruar para datës 4 nëntor 2013, e cila gjë mbetet shqetësuese marr parasysht numrin e madh të lëndëve të vjetra të pazgjidhura.*

PSRK, krahasuar me periudhën paraprake raportuese në të cilën ende nuk kishte arritur të zgjidhte as gjysmën e rasteve të vjetra, tani në periudhën janar, shkurt, mars 2015, ka arritur të zgjidhë më shumë se gjysmën e rasteve të vjetra. Prej rasteve të pazgjidhura ndaj 232 personave sa i ka pasur të regjistruar në fillim të Planit, **PSRK** i ka zgjidhur rastet ndaj 123 personave apo **53%** të tyre.<sup>21</sup> *Pra, gjatë tre muajve të periudhës raportuese, PSRK ka zgjidhur raste ndaj 13 personave, të cilët i takojnë rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013.*

Pas PTh në Prishtinë dhe PSRK-së, vijon **PTh në Mitrovicë** si prokuroria me jo-efikase, e cila ka zgjidhur raste ndaj **61%** të personave apo rastet ndaj 88 prej 141 personave sa i kishte të regjistruar më 4 nëntor 2014.<sup>22</sup> *Gjatë periudhës raportuese kjo prokurori ka zgjidhur raste ndaj 19 personave.* IKD gjithsesi ka parasysht rezultatet jo të mira të kësaj prokurorie, në të cilat kanë ndikuar edhe arsyt objektive të kushteve të punës, për të cilat IKD ka kërkuar të adresohet me urgjencë nga Këshilli Prokurorial për përmirësimin e kushteve të punës, por që nuk është bërë asgjë.

Mbi gjysmën e personave ka arritur t'i zgjidhë edhe **PTh në Ferizaj**, e cila prej 126 personave, i ka zgjidhur 94 apo **74%** të personave.<sup>23</sup> *Për këtë periudhë raportuese ka arritur të zgjidhë raste vetëm ndaj 3 personave.*

**PTh në Gjakovë** gjatë kësaj periudhe tre mujore ka arritur të zgjidhë vetëm një rast të regjistruar deri më 4 nëntor 2013, e cila ka zgjidhur raste ndaj **82%** apo 53 prej 64 personave sa i ka pasur në fillim të Planit të Veprimit.<sup>24</sup>

**PTh në Prizren** gjithashtu ka arritur të zgjidhë **90%** të personave, duke zgjidhur raste ndaj 159 personave prej 175 sa i kishte pasur në punë fillim të Planit të Veprimit.<sup>25</sup> *Gjatë periudhës raportuese ka zgjidhur vetëm një rast të regjistruar deri më 4 nëntor 2013.*

<sup>20</sup> *Shënim:* PTh në Prishtinë për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) kishte arritur të zgjidhë 13% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 777 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 98 personave.

<sup>21</sup> *Shënim:* PSRK për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) kishte arritur të zgjidhë 46% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 232 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 107 personave.

<sup>22</sup> *Shënim:* PTh në Mitrovicë për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) kishte arritur të zgjidhë 26% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 141 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 36 personave.

<sup>23</sup> *Shënim:* PTh në Ferizaj për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) kishte arritur të zgjidhë 64% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 126 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 81 personave.

<sup>24</sup> *Shënim:* PTh në Gjakovë për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) ka arritur të zgjidhë 81% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 64 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 52 personave.

**PTH në Pejë** ka arritur të zgjidhë 100% të personave apo rastet ndaj 92 personave.<sup>26</sup> *Gjatë periudhës raportuese kjo prokurori ka zgjidhur raste ndaj 5 personave.*<sup>27</sup>

**PTH në Gjilan** ka arritur të zgjidhë 100% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013 në Planin e Veprimit, duke zgjidhur të gjitha rastet, përkatësisht 23 raste me 81 persona.

Edhe pse në disa prokurori është punuar me përkushtim të madh në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit sipas Planit të Veprimit, shqetësues mbetet numri i madh i rasteve të pazgjidhura, qoftë të rasteve të vjetra të trashëguara, qoftë të rasteve të reja të pranuar pas datës 4 nëntor 2013. IKD në veçanti konsideron shqetësuese numrin e madh e lëndëve të vjetra të pazgjidhura në PTh në Prishtinë, PSRK dhe PTh në Mitrovicë, të cilat janë prokuroritë me efikasitetin më të dobët sa i përket zgjidhjes së rasteve të vjetra të korrupsionit. PTh në Prishtinë, njëjtë si në periudhën paraprake, numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura dhe pamundësinë e përmbushjes së Planit të Veprimit e arsyeton me numrin e madh të lëndëve të natyrës korruptive, numrin e madh të lëndëve të natyrës urgjente dhe rasteve të paraburgimit të cilat kërkojnë prioritet dhe gjithashtu numrin e pamjaftueshëm me prokurorë.<sup>28</sup> PSRK konsideron se ishin arsyet dhe sfidat tjera si: kompleksiteti i rasteve, vështirësitë në sigurimin e provave, vonesat në kryerjen e ekspertizave, numri jo i mjaftueshëm i prokurorëve dhe në raste të caktuara, edhe i hetuesve, përfaqësimi nëpër të gjitha gjykatat themelore nëpër Kosovë dhe koha që kjo merr etj.<sup>29</sup> Ndërsa arsye të veçanta vazhdon të ketë PTh në Mitrovicë, e cila tani ka përmbushur më shumë se gjysmën e Planit të Veprimit sa i përket zgjidhjes së rasteve të vjetra, përkatësisht 61 % të tyre. Sikurse në periudhat paraprake, kjo prokurori vazhdon të ballafaqohet me probleme të cilat pamundësojnë funksionimin normal dhe efikasitetin e saj. Ndër problemet dhe sfidat kryesore të zbatimit të Planit të Veprimit ka qenë dhe vazhdon të jetë mungesa e hapësirave të nevojshme për punën e prokurorisë dhe gjithashtu, lëndët e shumta të paraburgimit.<sup>30</sup>

<sup>25</sup> *Shënim:* PTh në Prizren për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) ka arritur të zgjidhë 85% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 175 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 149 personave.

<sup>26</sup> *Shënim:* PTh në Pejë për tetë muaj (prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit më 4 nëntor 2013 deri më 30 qershor 2014) ka arritur të zgjidhë 94% të rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, ku prej 86 personave të pazgjidhura kanë zgjidhur raste ndaj 81 personave.

<sup>27</sup> Shih fusnotën paraprake.

<sup>28</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë z. Imer Beka. Shkurt dhe mars 2015.

<sup>29</sup> IKD intervistë me U.d së Kryeprokurores në PSRK, znj. Sevdije Morina. Janar dhe mars 2015.

<sup>30</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Mitrovicë z. Shyqyri Sylja. Janar dhe mars 2015.

**a) MËNYRA E ZGJIDHJES SË RASTEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERIUdhËN RAPORTUESE**

IKD ka bërë kategorizimin e mënyrës së zgjidhjes së rasteve të vjetra nga PSRK dhe PTh-të edhe për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015). Në tabelën 12, janë paraqitur vendimet e prokurorëve për rastet e zgjidhura ndaj 42 personave, të cilët i takojnë rasteve të vjetra të Planit të Veprimit, të regjistruara deri më 4 nëntor 2013. Prej këtyre 42 personave, vetëm ndaj 10 personave prokurorët kanë hudhur poshtë kallëzimet penale apo kanë pushuar hetimet, ndërsa ndaj 32 personave kanë ngritur aktakuza. Ndryshe nga raportimi për periudhën paraprake në të cilën prokurorët ndaj më shumë se gjysmës së tyre (55 personave) kishin nxjerrë vendime për hudhje të kallëzimeve penale dhe pushim të hetimeve, ndërsa më pak se ndaj gjysmës së tyre kishin ngritur aktakuza (52 personave), në periudhën e tanishme janar, shkurt, mars 2015, prokurorët kanë qenë më të efektshëm sa i përket ngritjes së aktakuzave në proporcion me numrin e rasteve të zgjidhura. Pra, nga gjithsejtë 42 personat e përfshirë në rastet e vjetra të zgjidhura, ndaj 32 personave është ngritur aktakuzë kundrejt 10 personave rastet e të cilëve janë hudhur poshtë dhe janë pushuar. Në vazhdim në tabelën 12 vëreni mënyrën e zgjidhjes së rasteve të “vjetra” të regjistruara deri më 4 nëntor 2013, për secilën prokurori.

PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas prokurorive për periudhën raportuese (1 janar - 31 mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
PSRK		2			11	13
Prishtinë						
Prizren	1					1
Pejë		4			1	5
Gjilan						
Mitrovicë	2	1			16	19
Ferizaj					3	3
Gjakovë					1	1
<b>TOTAL</b>	<b>3</b>	<b>7</b>			<b>32</b>	<b>42</b>

Tabela 12 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013 të zgjidhura gjatë periudhës raportuese janar, shkurt, mars 2015.

PTh në Mitrovicë është prokuroria që ka zgjidhur më së shumti raste të korrupsionit të Planit të Veprimit, gjithsej 19 persona nga 42 sa janë zgjidhur tërësisht për këtë periudhë raportuese. Prej tyre ndaj 16 personave prokurorët kanë ngritur aktakuza, ndaj 2 personave kanë hudhur poshtë kallëzimet penale ndërsa ndaj një personi të vetëm, kanë pushuar hetimet.

PSRK është prokuroria e cila pas PTh në Mitrovicë, ka numrin më të madh të personave të përfshirë në rastet e vjetra të zgjidhura për këtë periudhë raportuese. Gjatë periudhës raportuese për tre muaj (janar, shkurt, mars 2015), PSRK ka arritur të zgjidhë raste ndaj 13 personave, prej të cilëve ndaj 11 personave ka ngritur aktakuzë, ndërsa ndaj 2 personave ka pushuar hetimet. Edhe pse është ndër prokuroritë që ka zgjidhur më së shumti raste të vjetra për këtë periudhë raportuese, IKD vazhdon të shprehë shqetësim për numrin e madh të rasteve të vjetra të pazgjidhura të korrupsionit, e cila pas PTh në Prishtinë, është prokuroria me numrin më të madh të rasteve të tilla në punë. Drejtuesit e kësaj prokurorie, vazhdojnë të theksojnë se sfidat kryesore të cilat kishin pamundësuar efikasitet më të madh në zbatimin e Planit të Veprimit për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, ndërlidhen me kompleksitetin e rasteve të korrupsionit, vështirësitë në sigurimin e provave, vonesat në kryerjen e ekspertizave, numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve, dhe në raste raste edhe me hetues, përfaqësimi i rasteve nëpër të gjitha gjykatat në Kosovë dhe koha që kjo merr.<sup>31</sup> Përkundër efikasitetit më të theksuar të PSRK-së në këtë periudhë raportuese, IKD vlerëson se numri i madh i lëndëve të vjetra të pazgjidhura në PSRK, vazhdon të jetë shqetësim për punën dhe rezultatet në këtë prokurori.<sup>32</sup> Pas PTh në Prishtinë, PSRK është prokuroria me numrin me përqindjen më të ulët të përmbushjes së Planit të Veprimit sa i përket zgjidhjes së rasteve të vjetra të korrupsionit.<sup>33</sup>

PTh në Pejë ka zgjidhur raste ndaj 5 personave për këtë periudhë raportuese, ndërsa PTh në Ferizaj ka 3 raste të tilla, e pasuar nga PTh në Prizren dhe PTh në Gjakovë me nga një rast të vjetër të zgjidhur për periudhën raportuese.

Shqetësim i veçantë mbetet PTh në Prishtinë, e cila përkundër faktit se posedon numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura dhe efikasitetin më të dobët në përmbushjen e Planit të Veprimit, për këtë periudhë raportuese është e vetmja prokurori e cila nuk ka

---

<sup>31</sup> IKD intervistë me znj. Sevdije Morina, zv/Kryeprokurore në PSRK. Janar dhe mars 2015.

<sup>32</sup> IKD vlerëson sërish se kushtet e punës dhe stimulimi që marrin prokurorët në PSRK është shumë më i madh se sa marrin prokurorët e prokurorive tjera, prandaj në këtë drejtim, ky investim i shtetit është bërë për të sjellë rezultate në luftimin e krimeve, të cilat PSRK i ka në kompetencë. Sa për krahasim, IKD ju sjellë rezultatet e luftimit të korrupsionit të prokurorisë simotër, e cila vepron në Kroaci. Prokuroria Speciale kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Kroaci (USKOK) për dallim prej PSRK ka një performancë të shkëlqyeshme në luftimin e kriminalitetit. Në vitin 2012, USKOK prej 283 aktakuzave të ngritura dhe të përfaqësuara në gjykatat kroate ka arritur të mbrojë 95 të tyre, duke u shpallur 252 aktgjykime dënuese për këto aktakuza. Kjo dëshmon për efikasitetin dhe cilësinë e punës së USKOK-ut në hetimin dhe ndjekjen e profileve të larta. (shih raportin në faqen 7 [http://ëëë.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4%282013%297\\_Croatia\\_EN.pdf](http://ëëë.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/GrecoEval4%282013%297_Croatia_EN.pdf)). Ndërsa, PSRK është themeluar dhe funksionalizuar me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës në vitin 2008.

(qasur për herë të fundit më 30 dhjetor 2014 [http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L052\\_al.pdf](http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L052_al.pdf))

<sup>33</sup> PTh në Prishtinë është prokuroria më e dështuar në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit të regjistruara në Planin e Veprimit me vetëm 27%, pas saj është PSRK me 53% të zgjidhjes së rasteve të vjetra.

zgjidhur asnjë rast të vetëm të vjetër, duke mbetur e njëjtë në përqindje sikurse në periudhën paraprake. PTh në Prishtinë nga gjithsej 777 persona të përfshirë në rastet e vjetra të pazgjidhura sa kishte në fillim më 4 nëntor 2013, ka arritur të zgjidhë rastet ndaj 210 personave, apo vetëm 27% të përmbushjes së Planit të Veprimit.<sup>34</sup>

Përveç mënyrës së zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas prokurorive, IKD ka identifikuar gjithashtu edhe mënyrën e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas parashtruesve, për këtë periudhë raportuese. Nga gjithsej 42 personat e përfshirë në rastet e vjetra të zgjidhura, prokurorët kanë zgjidhur raste ndaj 32 personave të parashtruar nga PK, për të cilët vetëm ndaj 9 personave janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet,<sup>35</sup> ndërsa ndaj 23 personave kanë ngritur aktakuza. Tabela në vijim, ka paraqitur mënyrën e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas parashtruesve për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015):

PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të vjetra sipas parashtruesve për periudhën raportuese (1 janar-31mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
AKK					2	2
PK	3	6			23	32
I dëmtuari						
IPK		1			3	4
Qytetari						
EULEX					4	4
Autoriteti Pyjor						
E pranuar në k.						
<b>TOTAL</b>	<b>3</b>	<b>7</b>			<b>32</b>	<b>42</b>

Tabela 13 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të regjistruara deri më 4 nëntor 2013 të zgjidhura gjatë periudhës raportuese janar, shkurt, mars 2015.

<sup>34</sup> Shënim: Në intervistën e realizuar me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë z. Imer Beka në muajin mars 2015 në Prishtinë, z. Beka është deklaruar se arsyet kryesore për mungesën e efikasitetit të PTh në Prishtinë për këtë periudhë raportuese ndër tjera ishin: bartja e prokurorëve dhe stafit në objektin e ri të prokurorisë (Pallatin e Drejtësisë), bartja e lëndëve, mos-vajtja e gjykatës në po ashtu në objektin e ri, kushtet objektive dhe problemet teknike me ambientimin. Mirëpo, ndër tjera, Kryeprokurori deklarohet të jetë i kënaqur marr parasysh punën e prokurorëve dhe angazhimin e tyre, mirëpo deklarohet i pakënaqur me kushtet dhe problemet objektive.

<sup>35</sup> Shënim: Sipas statistikave rezulton se prokurorët në rastet e parashtruara nga PK, ndaj 3 personave kanë hudhur kallëzimet penale, ndërsa ndaj 6 personave, kanë pushuar hetimet.

Pas PK-së, IPK dhe EULEX janë parashtruesit ndaj të cilëve janë zgjidhur më shumë raste të vjetra sa i përket periudhës raportuese me gjithsej nga 4 persona. Të gjitha rastet e tilla, janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

## **b) RASTET E REJA TË PRANUARA DHE MËNYRA E ZGJIDHJES**

Bazuar në analizën statistikore të IKD-së, rezulton se për këtë periudhë raportuese, prokurorët kanë zgjidhur gjithsej raste ndaj 77 personave. PTh në Pejë dhe PTh në Gjakovë janë prokuroritë me numrin më të madh të të rasteve të reja të zgjidhura për periudhën janar-mars 2015. Nga gjithsej 77 persona, PTh në Pejë dhe PTh në Gjakovë kanë zgjidhur raste ndaj 17 personave.<sup>36</sup>

PTh në Ferizaj kishte zgjidhur raste të reja të pranuar në pranuar në punë pas datës 4 nëntor 2013 në të cilat përfshiheshin 12 persona,<sup>37</sup> e pasuar nga PTh në Gjilan me 11 persona,<sup>38</sup> PTh në Prizren me 9 persona,<sup>39</sup> PTh në Prishtinë me 8 persona,<sup>40</sup> PTh në Mitrovicë me 3 persona<sup>41</sup> dhe PSRK pa asnjë rast të ri të zgjidhur për periudhën raportuese.

Të gjitha rastet e tilla, janë paraqitur në tabelën nr. 14:

<sup>36</sup> *Shënim:* Për periudhën janar – mars 2015, PTh në Pejë nga gjithsej 17 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura të korrupsionit, ndaj 1 personi kishte hudhur poshtë kallëzimin penal, ndaj 10 personave kishte pushuar hetimet, ndaj 4 personave ka propozuar shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndërsa ndaj 2 personave kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë. PTh në Gjakovë, nga gjithsej 17 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, ndaj 9 personave kishte hudhur poshtë kallëzimet penale, ndaj 1 personi kishte pushuar hetimet, ndërsa ndaj 7 personave kishte ngritur aktakuzë pas hetimeve.

<sup>37</sup> *Shënim:* Në periudhën janar – mars 2015, PTh në Ferizaj nga gjithsej 12 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura, (të pranuar pas datës 4 nëntor 2013) për 2 persona, kishte hudhur poshtë kallëzimet penale, për 1 person kishte propozuar shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, për 1 person kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndërsa për 8 persona kishte ngritur aktakuzë pas hetimeve.

<sup>38</sup> *Shënim:* Në periudhën janar – mars 2015, PTh në Gjilan nga gjithsej 11 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura, (të pranuar pas datës 4 nëntor 2013) për 3 persona kishte pushuar hetimet, për 1 person kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë ndërsa për 7 persona kishte ngritur aktakuzë pas hetimeve.

<sup>39</sup> *Shënim:* Në periudhën janar – mars 2015, PTh në Prizren nga gjithsej 9 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura, (të pranuar pas datës 4 nëntor 2013) për 6 persona kishte pushuar hetimet, ndërsa për 3 persona kishte ngritur aktakuzë pas hetimeve.

<sup>40</sup> *Shënim:* Në periudhën janar – mars 2015, PTh në Prishtinë nga gjithsej 8 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura, (të pranuar pas datës 4 nëntor 2013) për 6 persona kishte pushuar hetimet, ndërsa për 2 persona kishte ngritur aktakuzë pas hetimeve.

<sup>41</sup> *Shënim:* Në periudhën janar – mars 2015, PTh në Mitrovicë nga gjithsej 3 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura, (të pranuar pas datës 4 nëntor 2013) për 1 person kishte propozuar shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, ndërsa për 2 persona kishte ngritur aktakuzë të drejtpërdrejtë.

PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të reja sipas prokurorive të pranuara në periudhën raportuese (1 janar - 31 mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
PSRK						0
Prishtinë		6			2	8
Prizren		6			3	9
Pejë	1	10	4	2		17
Gjilan		3		1	7	11
Mitrovicë			1	2		3
Ferizaj	2		1	1	8	12
Gjakovë	9	1			7	17
<b>Total</b>	<b>12</b>	<b>26</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>27</b>	<b>77</b>

Tabela 14 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të pranuara gjatë kësaj periudhe raportuese.

Edhe në raportet paraprake, IKD kishte trajtuar problematikën e numrit të madh të rasteve të hudhjes së kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve. Edhe në këtë periudhë, IKD konsideron shqetësues numrin e madh të rasteve të hudhura të kallëzimeve penale dhe atyre të pushimit të hetimeve. Nga të gjitha rastet e reja të zgjidhura ku përfshihen 77 persona për këtë periudhë raportuese, pothuajse për gjysmën e tyre, prokurorët kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet. Prokurorët kanë hudhur kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet ndaj 38 personave, kundrejt 39 personave ndaj të cilëve kanë ngritur aktakuza dhe kanë propozuar shqiptimin e urdhrit ndëshkimor.

Në proporcion me numrin e lëndëve të reja të zgjidhura për këtë periudhë raportuese, PTh në Pejë dhe PTh në Gjakovë janë prokuroritë me numrin më të madh të rasteve në të cilët janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet. Prokurorët e Pejës, prej rasteve që kanë zgjidhur ku janë përfshirë gjithsej 17 persona, ndaj 11 personave kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe kanë pushuar hetimet, kundrejt 4 personave për të cilët kanë propozuar shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe 2 personave për të cilët kanë ngritur aktakuza të drejtpërdrejta.

IKD gjithashtu ka kategorizuar mënyrën e zgjidhjes së rasteve të reja sipas parashtruesve për periudhën raportuese janar – mars 2015. Edhe për rastet e tilla të zgjidhura, parashtruesi më i madh figuron të jetë PK, e pasuar nga palët e dëmtuara, për të vijuar më pas me parashtruesit tjerë si AKK, qytetari, të pranuar në kompetencë dhe prokurori me vetiniciativë. Tabela në vijim, ka paraqitur në detaje mënyrën e zgjidhjes së rasteve të reja sipas parashtruesve për periudhën raportuese janar – mars 2015:

PP - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të reja sipas parashtruesve për periudhën raportuese (1 janar – 31 mars 2015)	Hudhje	Pushim	Urdhër Ndëshkimor	Aktakuza të drejtpërdrejta	Aktakuza pas hetimeve	Total
AKK		6			4	10
PK	3	7	6	6	20	42
I dëmtuari	9	3			1	13
IPK						
Qytetari		9				9
EULEX						
Prok. Vetinic.		1				1
E pranuar në k.					2	2
<b>TOTAL</b>	<b>12</b>	<b>26</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>27</b>	<b>77</b>

Tabela 15 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve të pranuar gjatë kësaj periudhe raportuese sipas parashtruesve.

Nga gjithsej 77 personat e përfshirë në rastet e reja të zgjidhura për periudhën raportuese, për 42 persona parashtrues ka qenë PK, me ç'rast ndaj 26 personave ishin ngritur aktakuza, ndaj 6 personave ishte propozuar shqiptimi i Urdhrit Ndëshkimor, ndërsa ndaj 10 personave kanë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe ishin pushuar hetimet. Rastet e reja të zgjidhura të parashtruara nga i dëmtuari, nga gjithsej 13 të tilla, vetëm ndaj 1 personi është ngritur aktakuzë, ndaj 9 personave janë hudhur poshtë kallëzimet penale ndërsa ndaj 3 personave janë pushuar hetimet. Për 9 personat e përfshirë në rastet e paraqitura nga qytetari, prokurorët kishin pushuar hetimet, sikurse kishin pushuar hetimet për rastin e iniciuar nga vet prokurori, ndërsa për dy personat e pranuar në kompetencë, ishte ngritur aktakuzë. Si parashtrues i rasteve në të cilat përfshiheshin 10 persona të parashtruara nga AKK, prokurorët kishin pushuar rastet për 6 persona, ndërsa kishin ngritur aktakuzë për 4 të tillë. Të gjitha janë pasqyruar në tabelën nr 15.

**c) RASTET E PAZGJIDHURA NË FUND TË PLANIT TË VEPRIMIT**

Zgjidhja e vetëm 55% të rasteve të vjetra të regjistruara në Planin e Veprimit nga ana e prokurorive, padyshim se ka lënë një numër të madh të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit në fund të kësaj periudhe raportuese më 31 mars 2015. IKD vazhdon të shpreh shqetësim se ende kanë mbetur pa u zgjidhur rastet e vitit 2001, 2003 e tutje. Për të pasur një pasqyrë të qartë për rastet e vjetra të korrupsionit, IKD ka paraqitur në tabelën më poshtë, rastet dhe personat për secilën prokurori, për secilin vit. Sikurse në raportet paraprake, IKD ka ofruar këtë pasqyrë për akterët e sistemit prokurorial që ta kenë të qartë problematikën dhe rrezikun e parashkrimit të këtyre rasteve të pazgjidhura ndër vite.

IKD vlerëson se gjendja e këtyre rasteve të vjetra të pazgjidhura do të shpie sikurse rastet e tjera deri të arritja e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Rastet e trashëguara nga vitet paraprake duke filluar nga viti 2001, ndikojnë drejtpërdrejtë në kualitetin dhe efikasitetin e punës së prokurorive. Sikurse në raportet paraprake, IKD vlerëson se prokurorët do ta kenë vështirë mbrojtjen e rasteve të tyre në gjykatë për veprat penale të cilat pretendohet se janë kryer në vitet e largëta sikurse viti 2001. Në këto raste ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale dhe është shumë e vështirë sigurimi i dëshmitarëve, besueshmëria e deklaratave të tyre lidhur me këto raste dhe vërtetimi i gjendjes faktike.

Krahasuar me numrin e rasteve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese paraprake (tetor, nëntor, dhjetor 2014), në këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), numri i rasteve është rritur nga 530 raste me 1,556 persona, në 556 raste me 1,652 persona. Jo vetëm që nuk është zvogëluar numri i rasteve për tre muaj, mirëpo fatkeqësisht numri i tillë është rritur për 26 raste më shumë dhe 96 persona më shumë se periudha e tremujorit paraprak, e cila gjë vlerësohet si tejet shqetësuese nga IKD.

Në tabelën 16, IKD ka paraqitur të gjitha rastet e korrupsionit, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura më 31 mars 2015, për secilën prokurori sipas viteve:

Rastet e pazgjidhura me persona në fund të periudhës raportuese (31 mars 2015)	2001		2004		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK													7	25	5	27	3	25	8	40	21	120	2	5	46	242
Prishtinë	1	1	1	1	4	14	8	30	15	41	2	2	13	42	19	98	32	111	63	274	161	313	25	88	344	1,015
Prizren											1	4			1	1			2	2	12	43	7	10	23	60
Pejë													1	1					3	11	16	39	6	8	26	59
Gjilan																					5	14	6	12	11	26
Mitrovicë											1	2	1	2	4	4	8	20	12	44	24	51	10	23	60	146
Ferizaj			1	4			1	2					2	4			1	4	7	22	11	22	5	13	28	71
Gjakovë																	1	1	5	10	4	9	8	13	18	33
<b>Total:</b>	1	1	2	5	4	14	9	32	15	41	4	8	24	74	29	130	45	161	100	403	254	611	69	172	556	1,652

Tabela 16 - Rastet e pazgjidhura në fund të muajit më 31 mars 2015.

PTh në Prishtinë vazhdon të mbetet prokuroria me numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura, e cila më 31 mars 2015, ka në sirtarët e saj 344 raste me 1,015.<sup>42</sup>

PTh në Prishtinë dhe PTh në Ferizaj vazhdojnë të jenë prokuroritë e vetme të cilat kanë raste të vjetra të periudhave prej vitit 2001, deri më 2008. Derisa për periudhën e tillë PTh në Ferizaj ka 2 raste me 6 persona, PTh në Prishtinë ka 29 raste me 87 persona. IKD konsideron shqetësues faktin se prokuroritë ende vazhdojnë të kenë në procedim lëndë për më shumë se 14 vjet, i cili fakt përveç maltremit të qytetarëve në evidencën e personave të dyshuar, ka efektin negativ edhe në rrezikimin e parashkrimit të lëndëve të tilla.

Përkundër faktit se kanë kaluar tre muaj nga raportimi i fundit për rastet e njëjta, IKD gjen se më shumë se 50% të personave të cilët janë të përfshirë në këto kallëzime penale për korrupsion, vazhdojnë t'i përkasin periudhës nga viti 2001 deri në 2013. Nga gjithsej

<sup>42</sup> Shënim: Pas PTh në Prishtinë është PTh në Mitrovicë me 60 raste me 146 persona, PSRK me 46 raste dhe 242 persona të pazgjidhura në fund, e pasuar nga PTh në Ferizaj me 28 raste dhe 71 persona, PTh në Pejë me 26 raste dhe 59 persona, PTh në Prizren 23 raste me 60 persona, PTh në Gjakovë 18 raste me 33 persona dhe PTh në Gjilan me vetëm 11 raste dhe 26 persona të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese, përkatësisht me 31 mars 2015.

rastet e pazgjidhura ku përfshihen 1,652 persona në fund të kësaj periudhe raportuese, të cilat i përkasin periudhës 2001 - 2015, 869 persona apo 52.6% e tyre, i përkasin periudhës së rasteve prej vitit 2001 deri në 2013, kundrejt 783 personave apo 47.4 % që i përkasin periudhës së rasteve të reja në punë, të pranuar në vitin 2014 dhe 2015.

Kategorizimi i rasteve të pazgjidhura në fund, përveç sipas prokurorive, është bërë edhe sipas parashtruesve nëpër vite. Tabela 17, ka paraqitur rastet e pazgjidhura me persona në fund të kësaj periudhe raportuese, përkatësisht rastet e pazgjidhura deri më 31 mars 2015:

Raste të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese (31 mars 2015) sipas parashtruesve	2001	2004	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Total
AKK				10	16		19	19	91	95	124	9	383
ATK							2						2
Doganat		4								9	1	6	20
EULEX							7	11	1	6			25
IPK									7	7	22	10	46
PK			7	13	14	3	24	27	34	226	262	58	668
Qytetari							11	25	10	28	57	3	134
I dëmtuari				7	1	5	7	5	5	28	78	70	206
Adm. Komunale								1			2		3
Pranuar në kompet.											38	16	54
Titullari i pronës	1	1	7	2	10		4		13	1	13		52
Autoriteti Pyjor										2			2
Prokurori vetiniciat.								41		1	14		56
Paidentifikuar								1					1
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>32</b>	<b>41</b>	<b>8</b>	<b>74</b>	<b>130</b>	<b>161</b>	<b>403</b>	<b>611</b>	<b>172</b>	<b>1,652</b>

Tabela 17 - Raste të pazgjidhura me persona sipas parashtruesve në fund më 31 mars 2015.

Policia e Kosovës vazhdon të jetë parashtruesi më i madh i rasteve të korrupsionit, e cila nga gjithsej 1,652 personat e përfshirë në rastet e tilla, ka parashtruar kallëzime penale për 668 persona. AKK vazhdon të jetë parashtruesi i dytë me i madh me gjithsej 383 persona, rastet e parashtruara të të cilit, datojnë nga viti 2007.

Pas PK-së dhe AKK-së, vijon i dëmtuari me 206 persona, qytetari si parashtrues me 134 persona, prokurori me vetiniciativë me 56 persona, janë pranuar në kompetencë kallëzime penale ndaj 54 personave, Titullari i Pronës me 52 persona, IPK ka parashtruar kallëzime penale ndaj 46 personave, EULEX ndaj 25 personave, Doganat e Kosovës ndaj 20 personave etj.

Titullari i Pronës, Doganat e Kosovës, PK, AKK dhe i dëmtuari janë parashtruesit me rastet me të vjetra. Derisa rastet e parashtruara nga titullari i pronës datojnë nga viti 2001, ato të parashtruara nga doganat datojnë nga viti 2004, PK 2006, AKK dhe i dëmtuari nga viti 2007 etj.. Për më shumë, të gjitha rastet e parashtruara nëpër vite nga parashtruesit, janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

IKD gjithashtu ka kategorizuar rastet e njëjta të pazgjidhura në fund sipas parashtruesve dhe veprave penale, për të cilat dyshohen personat e përfshirë në kallëzimet penale. Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur rastet e tilla sipas parashtruesve dhe veprave penale:

TOTAL PP - Rastet e PAZGJIDHURA në FUND sipas parashtruesve dhe veprave penale (mars 2015)	Persona total	Mos raportimi i pasurisë	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Arkëtimi i kundërligjshëm i pagesave	Dhënia e ryshfetit	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	Marrja e ryshfetit	Mashtrimi në detyrë	Nxjerrja e kundërligj. V. gjyqësore	Përvetësimi në detyrë	Ushtrimi i ndikimit	Keqpërdorimi i autoriz. ekonomike	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Lidhja e kontratës së dëmshme	Keqpërdorim i Informates zyrtare	Shmangja nga tatimi	Shpërlarje e parave	Cënimi i të drejtave të patentës	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	Kontrabandim mallrave	Tregtia e Ndaluar	Importi, eksporti, furnizimi, transpozimi, prodhimi, Lëmbimi	Nuk I përket v. penale karakteristike	Pa vepër
AKK	383	67	283			16			1	1	12					1			1	1					
PK	668	1	480	101	6	7	16	11	5	23	2	1			3		1					7	1	1	2
IPK	46		33		1		3			5			4												
I dëmtuari	206		180			10	1		2	10		2													1
ATK	2		2																						
Autoriteti Pyjor	2		2																						
Doganat	20		7		2							4		5							2				
Prokurori Vet	56		52							4															
Qytetari	134		115		2	5				2		2		8											
Titullari pronës	52		46					2		4															
Pranuar në kom	54		41			1	8	1			1							1						1	
EULEX	25		13		3		3					6													
Adm. Komunale	3		2							1															
Paidentifikuar	1		1																						
<b>Totali</b>	<b>1,652</b>	<b>68</b>	<b>1,257</b>	<b>101</b>	<b>14</b>	<b>39</b>	<b>31</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>50</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>

Tabela 18 – Rastet e pazgjidhura sipas parashtruesve dhe veprave penale në fund më 31 mars 2015.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, njëjtë si në raportet e periudhave paraprake, PK vazhdon të jetë parashtruesi më i madh i rasteve. Nga gjithsej 1,652 personat ndaj të cilëve janë parashtruar kallëzimet penale, lëndët e të cilëve janë të pazgjidhura deri më 31 mars 2015, PK ka paraqitur kallëzime penale ndaj 668 personave. AKK është parashtruesi i dytë më i madh me 383 persona, i dëmtuari me 206 persona, qytetari me 134, etj.

Parashtruesit kanë paraqitur më së shumti kallëzime penale për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” me gjithsej 1,257 persona të dyshuar, më pas për veprën penale “Arkëtim i kundërligjshëm i pagesave” me gjithsej 101 persona të dyshuar, “Mos-raportim i pasurisë” me 68 persona, etj. Të gjitha rastet me personat e dyshuar sipas parashtruesve me vepra penale, janë paraqitur në tabelën e mësipërme.

Kryeprokurori i PTh në Prishtinë, prokuroria e të cilit edhe posedon numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura të korrupsionit, ka theksuar faktin se për tremujorin janar – mars 2015, prokuroria e tij nuk ka qenë e suksesshme në zgjidhjen e rasteve. Arsytet kryesore për mungesën e efikasitetit të PTh në Prishtinë për këtë periudhë raportuese ndër tjera ishin: bartja e prokurorëve dhe stafit në objektin e ri të prokurorisë (Pallatin e Drejtësisë), bartja e lëndëve, mos-vajtja e gjykatës po ashtu në objektin e ri, kushtet objektive dhe problemet teknike me ambientimin. Në intervistën për IKD-në, Kryeprokurori shprehet i vendosur në trajtimin me prioritet absolut të rasteve të korrupsionit.<sup>43</sup>

U.d Kryeprokurorja e PSRK-së ka shprehur përkushtimin e kësaj prokurorie për të arritur rezultate më të mëdha në kryerjen e lëndëve të korrupsionit.<sup>44</sup> Kryeprokurorët në PTh në Prizren dhe PTh në Pejë përveç përkushtimit për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, kanë kërkuar rritjen e numrit të prokurorëve dhe profilizimin e tyre.<sup>45</sup> U.d. Kryeprokurori i PTh në Ferizaj poashtu ka vazhduar të kërkojë rritjen e numrit të prokurorëve për të shtuar efikasitetin e kësaj prokurorie në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.<sup>46</sup>

---

<sup>43</sup> IKD intervistë me Kryeprokurorin e PTh në Prishtinë z. Imer Beka, shkurt, mars 2015.

<sup>44</sup> “Do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim të madh në kryerjen e këtyre rasteve duke kërkuar rezultate edhe më të mëdha”, U.D Kryeprokurore në PSRK, znj. Sevdije Morina, intervistuar në muajt janar dhe mars 2015.

<sup>45</sup> “Takimet e kolegjiuemeve dhe dhënia me prioritet lëndëve të tilla të korrupsionit; takimet me të shpeshta me mekanizma tjerë të zbatimit të ligjit dhe Shtimi i vetiniciativës ndër tjera, janë disa nga hapat që do të ndërmar PTh në Prizren për të rritur efikasitetin e saj në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.”, z. Metush Biraj U.D Kryeprokuror në PTh Prizren, intervistuar në muajin mars 2015;

“Do të vazhdojnë me përkushtim më të madh, duke shpresuar edhe në emërimin e prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve të rinj profesional, komunikim më të rregullt më të gjitha institucionet, qoftë në nivelin lokal dhe në atë qendror, rritja e koordinimit të punëve, krijimi i opinionit të qytetarëve se korrupsioni po luftohet dhe më këtë forcimi i besimit të qytetarëve se lirisht mund të paraqiten veprat penale të korrupsionit”, z. Agron Galani, Kryeprokuror në PTh Pejë, intervistuar në muajin mars 2015.

<sup>46</sup> “Ka nevojë për rritje të numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës.. PTh në Ferizaj do të vazhdojë të zbatojë ligjin dhe të gjitha veprimet do t’i ndërmarrin sipas nevojave që paraqet realiteti shoqëror”, z. Rasim Maloku, U.D së Kryeprokurorit në PTh Ferizaj, intervistuar në muajin mars 2015.

Përkundër kushteve të vështira të punës, Kryeprokurori i PTh në Mitrovicë shprehet se do të vazhdojnë të trajtojnë me prioritet rastet e natyrës korruptive dhe do të insistojë gjithashtu në sigurimin e hapësirave të nevojshme për punë.<sup>47</sup> Kryeprokurorët e PTh në Gjilan dhe Gjakovë, gjithashtu kanë shprehur përkushtimin e tyre për trajtimin e rasteve të korrupsionit, sipas obligimeve të Planit të Veprimit.<sup>48</sup>

## V. RASTET E KORRUPSIONIT NË FAZËN E GRUMBULLIMIT TË INFORMATAVE - PPN

### a) RASTET E PAZGJIDHURA NË FILLIM MË 4 NËNTOR 2013 PPN

Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga prokuroritë themelore dhe PSRK, përveç për lëndët e kategorizuara si PP, gjithashtu ka vazhduar edhe për rastet e korrupsionit të cilat gjenden e grumbullimit të informatave, të njohura dhe kategorizuara si PPN.

Edhe pse në numër më të vogël sesa kategoria PP, rastet e kategorisë PPN janë raste të cilat vazhdojnë të ngarkojnë tutje prokuroritë e Republikës së Kosovës.

Krahasuar me fillimin e tremujorit paraprak të raportimit (tetor, nëntor, dhjetor 2014), rastet e kategorizuara si PPN vetëm sa janë rritur në fillim të tremujorit pasues (janar, shkurt, mars 2015), përkundër strategjive të KPK-së për zgjidhjen e rasteve të natyrës korruptive. Derisa në fillim të tremujorit paraprak (1 tetor 2014) prokuroritë ishin të ngarkuara me në 288 raste të cilat përfshinin 681 persona, në fillim të tremujorit pasues (1 janar 2015), numri i tyre është rritur në 302 raste me 685 persona.

Tabela në vijim, ka pasqyruar rastet e pazgjidhura në fillim të kësaj periudhe raportuese (1 janar 2015), për secilën prokurori ndër vite:

<sup>47</sup> "Do të insistohet në sigurimin e hapësirave të nevojshme, i cili edhe është çelësi i suksesit për PTh në Mitrovicë.. edhe pse së paku dy herë i jam drejtuar KPK-së më kërkesën e një zgjidhjeje për hapësirat për prokurorinë, ndërsa disa herë edhe verbalisht është kërkuar nga KPK, mirëpo një gjë e tillë nuk është marr asnjëherë në konsideratë", z. Shyqyri Sylja, Kryeprokuror në PTh Mitrovicë, intervistuar në muajin mars 2015.

<sup>48</sup> "Kjo prokurori do të zbatojë të gjitha kërkesat që dalin nga plani i veprimit duke ju përkushtuar sidomos të ardhmes kërkesave për konfiskim dhe sekuestrim përkatësisht ngrirjes së pasurisë të gjithë kryerësve të këtyre veprave penale që kanë përfituar pikërisht nga veprimet e tyre të kundërligjshme; z. Jetish Maloku, Kryeprokuror në PTh në Gjilan, intervistuar në muajt janar dhe mars 2015.

""Do të kemi pak vështirësi në vitin 2015 pasi Drejtoria e re Rajonale e Policisë së Kosovës në Gjakovë, ende nuk është e kompletuar me stafin dhe përvojën e mjaftueshme e cila gjë, krijon vështirësi në luftimin e korrupsionit dhe veprave tjera penale.. Mirëpo përkundër kësaj, PTh në Gjakovë do të vazhdojë me përkushtim në kryerjen e detyrave dhe obligimeve ligjore.", znj. Shpresa Bakija, Kryeprokurore në PTh në Gjakovë, intervistuar në muajin mars 2015.

PPN - Rastet e pazgjidhura ndër vite në fillim të kësaj periudhe raportuese	2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK									1	1	1	2	2	8	4	8	27	93	35	112
Prishtinë	3	3	4	13	5	12	3	3	5	11	12	60	33	60	42	118	19	49	126	329
Prizren									1	3			1	1	1	5	27	55	30	64
Pejë															13	32	11	14	24	46
Gjilan																	6	9	6	9
Mitrovicë											2	4	5	9	7	12	14	15	28	40
Ferizaj	1	1	2	2	1	4	1	1	1	3	2	2	3	3	14	20	18	33	43	69
Gjakovë													1	2	7	12	2	2	10	16
<b>Total:</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>15</b>	<b>6</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>8</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>68</b>	<b>45</b>	<b>83</b>	<b>88</b>	<b>207</b>	<b>124</b>	<b>270</b>	<b>302</b>	<b>685</b>

Tabela 19 - Rastet e pazgjidhura ndër vite për secilën prokurori në fillim të kësaj periudhe raportuese më 1 janar 2015

Sikurse për rastet PP, PTh në Prishtinë vazhdon të jetë prokuroria me numrin më të madh të rasteve të kategorisë PPN. Nga gjithsej 302 raste me 685 persona, PTh në Prishtinë në fillim të periudhës raportuese, kishte pasur në punë gjithsej 126 raste me 329 persona, apo 41.7 % të rasteve nga të gjitha prokuroritë. PTh në Ferizaj dhe PSRK vijojnë me 43 raste me 69 persona, përkatësisht 35 raste me 112 persona, të pasuara nga PTh në Prizren me 30 raste dhe 64 persona, PTh në Mitrovicë 28 raste me 40 persona, PTh në Pejë 24 raste me 46 persona etj. Të gjitha janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Ndryshe nga rastet PP rastet e së cilës kategori datojnë nga viti 2001, rastet e kategorisë PPN datojnë nga viti 2006. PTh në Prishtinë dhe PTh në Ferizaj janë prokuroritë me rastet më të vjetra në punë të kategorisë PPN.

Kategorizimi i rasteve PPN është bërë edhe sipas parashtruesve nëpër vite. Tabela në vijim, ka paraqitur rastet e tilla PPN sipas parashtruesve nëpër vite, për të cilat dyshoheshin 685 persona në fillim të periudhës raportuese:

PPN - Rastet e pazgjidhura në fillim të kësaj periudhe raportuese sipas parashtruesve (1 janar 2015)	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	Total
AKK		4	11	2	8	13	10	12	5	65
ATK						4		2		6
Doganat								2		2
EULEX								4	1	5
IPK							1	3	17	21
PK		3	1	1	5	22	40	81	117	270
Qytetari			4		1	2	10	8	74	99
I dëmtuari	4	4		1	4	14	15	71	38	151
Adm. Komunale									4	4
AKP								4		4
Pranuar në kompet.									9	9
Titullari i pronës						1	5	18	2	26
Autoriteti Pyjor		4				5				9
Prokurori vetiniciat.							2	4	1	7
I paidentifikuar						7				7
<b>Totali</b>	<b>4</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>18</b>	<b>68</b>	<b>83</b>	<b>207</b>	<b>270</b>	<b>685</b>

Tabela 20 – Raste të ndër vite me parashtrues në fillim më 1 janar 2015

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelë, sikurse në rastet e kategorisë PP, PK vazhdon të jetë parashtruesi më i madh i rasteve PPN në prokuroritë përkatëse. Nga gjithsej 685 personat e përfshirë në rastet e paraqitura me informata, të kategorizuara si PPN, PK kishte iniciuar raste për 270 persona. Pas PK-së, është i dëmtuari parashtruesi i dytë më i madh me gjithsej 151 persona, i cili pasohet nga qytetari me 99 persona, nga AKK me 65 persona, Titullari i Pronës me 26 persona dhe parashtruesit tjerë. Të gjitha janë paraqitur në tabelën e mësipërme.

Gjatë monitorimit të Planit të Veprimit dhe analizës së statistikave të siguruara nga KPK, IKD ka identifikuar gjithashtu rastet e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese (1 janar 2015) sipas parashtruesve dhe veprave penale. Tabela në vijim, ka paraqitur rastet PPN të pazgjidhura në fillim sipas parashtruesve dhe veprave penale:

TOTAL PP - Rastet e PAZGJIDHURA në FILLIM sipas parashtruesve dhe veprave penale (janar 2015)	Persona total	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Arkëtimi i kundërligjshëm i pagesave	Dhënia e ryshfetit	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	Marrja e ryshfetit	Mashtrimi në detyrë	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore	Përvetësimi në detyrë	Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike	Lidhja e kontratës së dëmshme	Keqpërdorim i Informatës zyrtare	Përdorim i paautorizuar i pasurisë	Konflikt Interesi	Nuk I përket v. penale karakteristike
AKK	65	64							1						
PK	270	247		2	9	11	1								
IPK	21	18				1						1		1	
I dëmtuari	151	141	1		1	1		5				1	1		
ATK	6	6													
Autoriteti Pyjor	9	9													
Doganat	2	2													
Prokurori vetiniciat.	7	7													
Qytetari	99	92				1	1				2				3
Titullari i pronës-OP	26	24								2					
E pranuar në kompet.	9	9													
EULEX	5	1								4					
Administrata Komunale	4	4													
AKP	4	4													
Pa identifikuar	7	7													
<b>Totali</b>	<b>685</b>	<b>635</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>10</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>3</b>

Tabela 21 - Rastet e pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese sipas parashtruesve dhe veprave penale

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, nga gjithsej 685 personat e përfshirë në rastet PPN të pazgjidhura në fillim të periudhës, 635 prej tyre apo 92.70% e personave, dyshohen për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 14 persona për veprën penale “Marrja e ryshfetit”, 10 persona për veprën penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” etj. Për më shumë, të gjitha rastet sipas parashtruesve me vepra penale, janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

#### **b) RASTET E PRANUARA GJATË PLANIT TË VEPRIMIT PPN**

Në periudhën raportuese janar – mars 2015, PSRK dhe Prokuroritë Themelore, krahas rasteve ekzistuese të kategorizuara si PPN, kanë pranuar gjithashtu raste të reja, raste këto të cilat gjenden në fazën e grumbullimit të informatave. Edhe pse numër i madh i rasteve të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, gjithsej 302 raste me 685 persona, për periudhën raportuese (janar – mars 2015), prokuroritë janë ngarkuar me 68 raste të reja dhe 111 persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale të korrupsionit. Krahasuar me periudhën paraprake raportuese (tetor, nëntor, dhjetor 2014), në këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), prokuroritë kanë pranuar numër më të madh të rasteve të reja të kategorisë PPN.<sup>49</sup>

IKD ka identifikuar dhe kategorizuar rastet e pranuar të kategorisë PPN sipas prokurorive për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015). Tabela në vijim, ka pasqyruar rastet e tilla të njohura si raste në fazën e grumbullimit të informatave.

---

<sup>49</sup> Në periudhën tetor – dhjetor 2014, prokuroritë kishin pranuar në punë gjithsej 52 raste me 105 persona, rastet e kategorizuara si PPN.

TOTAL PPN - Raste dhe persona të pranuar sipas parashtruesve ( janar - mars 2015)	Raste në janar2015	Persona në janar 2015	Raste në shkurt 2015	Persona në shkurt 2015	Raste në mars 2015	Persona në mars 2015	Raste total	Persona total
<b>PSRK</b>	2	7	1	1	4	12	7	<b>20</b>
<b>Prishtinë</b>	2	2	6	16	3	4	11	<b>22</b>
<b>Prizren</b>	1	3	8	12	4	4	13	<b>19</b>
<b>Pejë</b>	4	5	7	9	5	5	16	<b>19</b>
<b>Gjilan</b>	4	4	3	5			7	<b>9</b>
<b>Mitrovicë</b>	2	2	3	6	3	3	8	<b>11</b>
<b>Ferizaj</b>	2	5			2	4	4	<b>9</b>
<b>Gjakovë</b>			1	1	1	1	2	<b>2</b>
<b>Total</b>	<b>17</b>	<b>28</b>	<b>29</b>	<b>50</b>	<b>22</b>	<b>33</b>	<b>68</b>	<b>111</b>

**Tabela 22 - Trendi i rasteve të pranuar në secilën prokurori për periudhën tre mujore (janar, shkurt, mars 2015)**

Gjatë kësaj periudhe raportuese (janar, shkurt, mars 2015), PTh në Pejë është prokuroria që ka pranuar numrin më të madh të rasteve PPN. Nga gjithsej 68 rastet me 111 personat e pranuar për periudhën raportuese, PTh në Pejë ka pranuar 16 raste me 19 persona, e cila pasohet nga PTh në Prizren, PTh në Prishtinë, PSRK dhe PTh në Mitrovicë, PTh në Gjilan dhe PTh në Ferizaj, dhe e fundit PTh në Gjakovë si prokuroria me numrin më të vogël të rasteve të pranuar, gjithsej 2 raste me 2 persona.<sup>50</sup> Të gjitha janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

IKD gjithashtu ka kategorizuar rastet e pranuar nëpër muaj për periudhën raportuese, sipas parashtruesve. Tabela në vazhdim, ka paraqitur rastet e tilla si në vijim:

<sup>50</sup>Për periudhën janar – mars 2015, PTh në Prizren kishte pranuar 13 raste me 19 persona, PTh në Prishtinë 11 raste me 22 persona, PSRK 7 raste me 20 persona, PTh në Mitrovicë 8 raste me 11 persona, PTh në Gjilan 7 raste me 9 persona, PTh në Ferizaj 4 raste me 9 persona dhe e fundit PTh në Gjakovë 2 raste me 2 persona.

TOTAL PPN - Raste dhe persona të pranuar sipas parashtruesve ( janar - mars 2015)	Raste në janar 2015	Persona në janar 2015	Raste në shkurt 2015	Persona në shkurt 2015	Raste në mars 2015	Persona në mars 2015	Raste total	Persona total
PK	7	10	11	13	8	10	26	33
IPK	2	3	2	5	1	2	5	10
I dëmtuari	4	6	12	28	6	6	22	40
Qytetari	2	2	3	3	3	7	8	12
Administrata Komunale			1	1			1	1
E pranuar në kompet.	2	7			4	8	6	15
<b>Total</b>	<b>17</b>	<b>28</b>	<b>29</b>	<b>50</b>	<b>22</b>	<b>33</b>	<b>68</b>	<b>111</b>

Tabela 23 - Trendi i rasteve të pranuar sipas parashtruesve në secilën prokurori për periudhën tre mujore (janar, shkurt, mars 2015)

I Dëmtuari është parashtruesi më i madh i personave të përfshirë në rastet e njohura si PPN. Nga gjithsej 68 rastet me 111 personat e pranuar për periudhën raportuese (janar – mars 2015), i dëmtuari ka iniciuar rastet me informata për 22 raste me 40 persona. Në anën tjetër, PK vazhdon të prijë me numrin më të madh të rasteve të iniciuara, gjithsej 26 raste me 33 persona nga gjithsej 68 rastet me 111 personat e parashtruar për këtë periudhë raportuese. Pas PK-së është qytetari me 8 raste dhe 12 persona, duke vijuar me rastet e pranuar në kompetencë, 6 raste me 15 persona, IPK 5 raste me 10 persona dhe parashtruesit tjerë. Për më shumë, të gjitha janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Të dhënat e pranuar për këtë periudhë raportuese, gjithashtu janë kategorizuar sipas veprave penale. Tabela në vijim, ka paraqitur personat e pranuar për periudhën raportuese, sipas parashtruesve dhe veprave penale.

TOTAL - PPN - Persona të pranuar sipas parashtruesve dhe veprave penale ( janar - mars 2015)	Persona total	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	Marrja e rryshfetit	Keqpërdorim i informatës zyrtare	Pa veper
PK	33	28		4		1
IPK	10	10				
I dëmtuari	40	38	1		1	
Qytetari	12	12				
Administrata Komunale	1	1				
E pranuar në kompet.	15	15				
<b>Totali</b>	<b>111</b>	<b>104</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>1</b>

Tabela 24 - Trendi i rasteve të pranuar sipas parashtruesve dhe veprave penale për periudhën tre mujore (janar, shkurt, mars 2015)

Nga 111 personat e pranuar për periudhën raportuese (janar - mars 2015), 104 persona apo 93.69% dyshohen për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 9 persona dyshohen për veprën penale “Marrje e rryshfetit” nga 1 person për veprat penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar”, “Keqpërdorim i informatës zyrtare” dhe për një person, nuk figuron fare vepra penale në rubrikat e veprave penale në mekanizmin përcjellës. Të gjitha janë të pasqyruara në tabelën e mësipërme.

**c) RASTET E ZGJIDHURA DHE MËNYRA E ZGJIDHJES PPN**

Krahas rasteve PP, PSRK dhe prokuroritë themelore kanë zgjidhur raste të kategorizuara si PPN. Gjatë kësaj periudhe raportuese, prokuroritë kanë zgjidhur 27 raste me 52 persona. Krahasuar me periudhën paraprake raportuese (tetor, nëntor, dhjetor 2014),<sup>51</sup> prokuroritë gjatë kësaj periudhe raportuese kanë zgjidhur pothuajse përgjysmë më pak raste me persona.

Për periudhën raportuese (janar, shkurt, mars 2015) IKD vlerëson si fakt shqetësues numrin e vogël të rasteve të zgjidhura, gjithashtu mënyrën e zgjidhjes së rasteve nga kjo kategori. Nga të dhënat e siguruar në KPK, IKD fillimisht ka identifikuar se 49.52%, prokurorët kanë zgjidhur raste ndaj personave me pak krahasuar me periudhën paraprake raportuese. Derisa në periudhën paraprake kishin zgjidhur 47 raste ndaj 105 personave, në periudhën e tanishme raportuese (janar, shkurt, mars 2015), kanë zgjidhur 27 raste me 52 persona, siç është potencuar edhe në paragrafin e mësipërm.

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së rasteve nga prokurorët, njëjtë sikurse në periudhën paraprake, të gjitha rastet janë hudhur poshtë. Për të gjithë 52 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura PPN, janë hudhur poshtë kallëzimet penale, ndërsa në asnjë rast të vetëm, nuk janë avancuar hetimet në procedurat e mëtutjeshme penale. Prej këtyre 52 personave, 51 të tillë dyshoheshin për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ndërsa vetëm 1 person dyshohej për veprën penale “Marrje e ryshfetit”.

Në tabelën në vazhdim, janë paraqitur rastet e tilla, mënyra e zgjidhjes së tyre sipas prokurorive:

---

<sup>51</sup> Për periudhën tetor - dhjetor 2014, prokuroritë kishin zgjidhur gjithsej 47 raste ndaj 105 personave, kundrejt 27 rasteve ndaj 52 personave që janë zgjidhur në periudhën raportuese janar-mars 2015.

PPN - Mënyra e zgjidhjes sipas parashtruesve për periudhën raportuese (1 janar - 31 mars 2015)	Hudhje	Total
PSRK	6	6
Prishtinë	9	9
Prizren	25	25
Pejë	5	5
Gjilan	3	3
Mitrovicë	2	2
Ferizaj	1	1
Gjakovë	1	1
<b>Total</b>	<b>52</b>	<b>52</b>

Tabela 25 - Mënyra e zgjidhjes së rasteve PPN për secilën prokurori.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, PTh në Prizren është prokuroria me numrin më të madh të rasteve të zgjidhura, me gjithsej 25 persona nga gjithsej 52 sa ishin të përfshirë në rastet e zgjidhura për këtë periudhë raportuese. PTh në Prishtinë pason me 9 persona, PSRK me 6 persona dhe prokuroritë tjera, të paraqitura në tabelën e mësipërme.<sup>52</sup>

<sup>52</sup> Shënim: PTh në Pejë ka zgjidhur raste ndaj 5 personave, PTh në Gjilan ka zgjidhur raste ndaj 3 personave, PTh në Mitrovicë raste ndaj 2 personave dhe PTh në Ferizaj dhe PTH në Gjakovë me nga një person të përfshirë në rastin e zgjidhur të natyrës së tillë të kategorisë PPN.

**d) RASTET E PAZGJIDHURA NË FUND TË PLANIT TË VEPRIMIT PNN**

Derisa në fillim të periudhës raportuese (1 janar 2015) PSRK dhe prokuroritë themelore kishin gjithsej 302 raste të pazgjidhura me 685 persona, në fund të periudhës raportuese (31 mars 2015), prokuroritë kanë në punë 330 raste të pazgjidhura me 720 persona. Krahasuar me periudhën paraprake, tani në periudhën raportuese (janar - mars 2015), prokuroritë kanë në punë 28 raste me 35 persona më shumë, duke ngarkuar prokuroritë edhe më tej me numrin e madh të lëndëve në punë.

Sikurse në raportin paraprak, IKD vazhdon të konsiderojë shqetësuese situatën me numrin e madh të rasteve të pazgjidhura të njohura si PPN në të gjitha prokuroritë. Njëjtë si në kategorinë të pazgjidhura në fillim (1 janar 2015), edhe për kategorinë të pazgjidhura në fund (31 mars 2015), IKD ka identifikuar raste të vjetra që datojnë nga viti 2006. Tabela në vijim, ka paraqitur rastet PPN sipas viteve në të gjitha prokuroritë:

PPN - Rastet e pazgjidhura ndër vite në fund të kësaj periudhe raportuese (31 mars 2015)	2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK									1	1	1	2	2	8	4	8	27	89	7	20	42	128
Prishtinë	3	3	4	13	5	12	3	3	5	11	11	53	33	60	41	117	19	49	11	22	135	343
Prizren															1	5	19	32	8	13	28	50
Pejë															6	23	9	12	12	15	27	50
Gjilan																	4	6	5	7	9	13
Mitrovicë											1	3	5	9	7	12	14	15	7	10	34	49
Ferizaj	1	1	2	2	1	4	1	1	1	3	2	2	3	3	14	20	18	33	4	9	47	78
Gjakovë																	3	3	2	2	8	9
<b>Total:</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>6</b>	<b>15</b>	<b>6</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>60</b>	<b>43</b>	<b>80</b>	<b>76</b>	<b>189</b>	<b>113</b>	<b>239</b>	<b>56</b>	<b>98</b>	<b>330</b>	<b>720</b>

Tabela 26 - PPN rastet e pazgjidhura në fund të periudhës raportuese më 31 mars 2015 për secilën prokurori

PTh në Prishtinë, e cila përveç se ka numrin më të madh të rasteve (gjithsej 135 raste me 343 persona), gjithashtu ka rastet më të vjetra të pazgjidhura qysh prej vitit 2006. Pas Prishtinës, PSRK vazhdon të jetë prokuroria me numrin më të madh të personave të përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën raportuese, me gjithsej 42 raste të pazgjidhura me 128 persona. PTh në Ferizaj ka gjithsej 47 raste me 78 persona të pazgjidhura, ku ka raste të pazgjidhura të vitit 2006. Pas PSRK-së dhe PTh në Ferizaj, prokuroritë me numrin më të madh të rasteve janë PTh në Mitrovicë me 34 raste dhe 49 persona PTh në Prizren, e cila ka 28 raste me 50 persona, PTh në Pejë 27 raste me 50 persona, PTh në Gjilan 9 raste me 13 persona dhe PTh në Gjakovë 8 raste me 9 persona. IKD ka bërë kategorizimin e këtyre rasteve sipas parashtruesve, me ç’rast parashtruesi më i madh i rasteve të kategorisë PPN, mbetet PK. Tabela tjetër në vijim ka paraqitur rastet me persona ndër vite, sipas parashtruesve:

PPN - Rastet e pazgjidhura në fund të kësaj periudhe raportuese sipas parashtruesve (31 mars 2015)	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Total
AKK		4	11	2	8	13	10	10	5		63
ATK						4			2		6
Doganat								2			2
EULEX								4	1		5
IPK							1	3	17	10	31
PK		3	1	1	5	14	38	66	107	26	261
Qytetari			4		1	2	10	8	66	11	102
I dëmtuari	4	4		1	1	14	14	70	26	35	169
Adm. Komunale									4	1	5
AKP								4			4
Pranuar në kompet.									8	15	23
Titullari i pronës						1	5	18	2		26
Autoriteti Pyjor		4				5					9
Prokurori vetiniciat.							2	4	1		7
I paidentifikuar						7					7
<b>Totali</b>	<b>4</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>15</b>	<b>60</b>	<b>80</b>	<b>189</b>	<b>239</b>	<b>98</b>	<b>720</b>

Tabela 26 - PPN rastet e pazgjidhura në fund të periudhës raportuese më 31 mars 2015 sipas parashtruesve

Nga gjithsej 720 personat e përfshirë në rastet e pazgjidhura në fund, PK ka iniciuar rastet për 261 persona, e pasuar nga i dëmtuari me 169 persona, rastet e të cilëve parashtrues, gjithashtu datojnë nga viti 2006 si raste me të vjetra. Parashtruesit tjerë janë qytetari me 102 persona, AKK me 63 persona, IPK me 31 persona, Titullari i Pronës me 26, dhe parashtruesit tjerë, të cilat janë pasqyruar si në tabelën e mësipërme.

## VI. PROFILI I PERSONAVE NDAJ TË CILËVE JANË ZGJIDHUR RASTET

IKD në këtë raport ka trajtuar më gjerësisht çështjen e profilit të personave të përfshirë në rastet e dyshuara të korrupsionit ndaj të cilëve prokuroritë kanë zgjidhur rastet e tyre për periudhën prej 4 nëntor 2013 deri më 31 dhjetor 2014. Fillimisht IKD sqaron faktin se të dhënat me pozitat e personave të trajtuara në raport, janë siguruar nga PTh-të, PSRK dhe KPK dhe si të tilla këto të dhëna nuk përputhën me të dhënat e gjeneruara nga Mekanizmi Përcjellës për periudhën e njëjtë kohore. Nga të dhënat e pranuar për profilet e personave nga secila prokurori, figurojnë gjithsej 1,164 persona të përfshirë në rastet e zgjidhura. Ndërsa në Mekanizmin Përcjellës, për periudhën e njëjtë (4 nëntor 2013 – 31 dhjetor 2014) figurojnë se janë zgjidhur rastet ndaj 1,301 personave. Vërehet që mungojnë 137 profile të personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet.<sup>53</sup>

<sup>53</sup> Shënim: IKD identifikon se PTh në Prishtinë kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 238 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 324 personave. IKD kishte pranuar 86 persona më pak të përfshirë në rastet e zgjidhura; PTh në Gjilan kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 86 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 149 personave. Pra, IKD kishte pranuar 63 persona më pak të përfshirë në rastet e zgjidhura se sa ato që figurojnë në Mekanizmin Përcjellës; PTh në Mitrovicë kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 73 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 88 personave. Pra, IKD kishte pranuar 15 persona më pak të përfshirë në rastet e zgjidhura të cilat figurojnë në Mekanizmin Përcjellës;

PTh në Ferizaj kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 123 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 125 personave. Pra, IKD kishte pranuar 2 persona më pak të përfshirë në rastet e zgjidhura të cilat figurojnë në Mekanizmin Përcjellës. Ndërsa, situatë tjetër për të cilën IKD nuk ka gjetur shpjegim është me prokuroritë si: PSRK-në, PTh në Gjakovë, PTh në Pejë dhe PTh në Prizren. Për prokuroritë e tilla, IKD kishte pranuar më shumë persona të përfshirë në rastet e zgjidhura sesa personat që figurojnë të zgjidhura në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014). Derisa PSRK i kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 171 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 161 personave. Pra IKD kishte pranuar të dhënat për pozitat për 10 persona më shumë të përfshirë në rastet e zgjidhura që figurojnë në Mekanizmin Përcjellës;

PTh në Gjakovë kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 92 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 80 personave. Pra IKD kishte pranuar pozitat për 12 persona më shumë të përfshirë në rastet e zgjidhura;

PTh në Pejë kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 137 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndërsa në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 132 personave, pra pozitat për 5 persona më shumë të përfshirë në rastet e zgjidhura të cilat figurojnë në Mekanizmin Përcjellës;

PTh në Prizren kishte ofruar të dhënat për pozitat ndaj 245 personave të përfshirë në rastet e zgjidhura, në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), figurojnë të zgjidhura rastet ndaj 242 personave, pra pozitat për 3 persona më shumë të përfshirë në rastet e zgjidhura që figurojnë në Mekanizmin Përcjellës.

IKD nga të dhënat e pranuar për pozitat e personave të përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, ka kategorizuar të dhënat e tilla sipas institucioneve dhe profileve si: Kuvendi i i Republikës së Kosovës, Qeveria, kryetarë të komunave, këshilltar komunal dhe zyrtarë të tjerë komunal, drejtor/ menaxher dhe zyrtarë tjerë të ndërmarrjeve publike, agjencive të pavarura dhe agjencive tjera në kuadër të institucioneve, bankave dhe bizneseve/kompanive private, qytetarë dhe zyrtarë tjerë nga institucioneve të ndryshme.

Përveç mos-përputhjes së të dhënave të pranuar nga prokuroritë dhe atyre në Mekanizmin Përcjellës për periudhën e njëjtë, IKD ka identifikuar gjithashtu profilizimet e mangëta apo të dhënat e pakompletuara për pozitat e të dyshuarve të përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014.<sup>54</sup> Në këtë rast, nga gjithsej 1,164 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, 368 persona janë përfshirë në kategorinë e “zyrtarëve tjerë nga institucionet e ndryshme”, për shumicën prej të cilëve, nuk ekzistonin të dhënat e kompletuara. Bazuar në të dhënat e siguruar nga prokuroritë përkatëse për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, IKD ka identifikuar se janë zyrtarët komunal të përfshirë me numrin më të madh të personave në rastet e zgjidhura. Nga gjithsej 1,164 personat të përfshirë në rastet e tilla, 240 persona janë zyrtar komunal, përfshirë kryetarë të komunave, këshilltarë komunal (asamblistë/e) si dhe zyrtarë tjerë. Nga gjithsej 240 personat e tillë, 59<sup>55</sup> persona janë të profilit më të lartë komunal si kryetarë të komunave dhe këshilltarë komunal, ndërsa 181<sup>56</sup> persona, janë zyrtarë tjerë komunal. Profilet më të larta si deputet, ministra dhe zyrtar tjerë të qeverisë, janë në numër më të vogël, gjithsej 58. Prej tyre, vetëm 9<sup>57</sup> janë deputet dhe ish-deputet, 4<sup>58</sup> persona janë ministra dhe ish ministra, ndërsa 45<sup>59</sup> persona janë zyrtarë tjerë qeveritarë.

<sup>54</sup> Shënim: Nga të dhënat e pranuar për pozitat e personave ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, IKD ka identifikuar se në të dhënat e tilla, për shumë zyrtarë/persona, nuk janë përfshirë fare institucionet në të cilat kishin punuar të dyshuarit ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet.

<sup>55</sup> Shënim: Në kuadër të kategorisë zyrtarë komunal, IKD ka grupuar në një rubrike kryetarët e komunave, këshilltarët komunal (asambleistët) si profili më i lartë i zyrtarëve të tillë dhe kategorinë tjetër zyrtarë tjerë komunal. Në kuadër të kategorisë së parë, “Kryetarë/Asambleistë”, IKD ka identifikuar gjithsej 59 persona me ç’rast 13 të tillë janë kryetarë të komunave, 5 persona ish kryetarë dhe 41 persona tjerë në kuadër të kategorisë së njëjtë janë Asambleistë Komunal apo këshilltar komunal.

<sup>56</sup> Shënim: Kategoria me numrin më të madh të zyrtarëve ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet përfshinë zyrtarët e ndryshëm komunal me gjithsej 181 persona. Nga gjithsej 181 zyrtarët komunal, 11 të tillë janë drejtor komunal ndërsa 170 persona të tjerë janë nga pozita të ndryshme komunale si: menaxher prokurimi në kuadër të komunës, anëtar të komisioneve të ndryshme komunale, zyrtar të ndryshëm nga drejtoratet komunale si: urbanizmi, kadastri, prokurimi, ndërtimi, inxhinier dhe ekspertë në kuadër të komunës, gjendjes civile e të tjera.

<sup>57</sup> Shënim: Në kategorinë e personave nga pozita Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë identifikuar gjithsej 9 persona, prej të cilëve 8 janë deputet ndërsa 1 person ish deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

<sup>58</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 4 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura në kategorinë e zyrtarëve të lartë të qeverisë, përkatësisht në ministri, 2 të tillë janë ministra ndërsa 2 tjerë ish ministra.

<sup>59</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 45 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura në kategorinë e zyrtarëve të tjerë të qeverisë, 4 persona janë nga pozita e sekretarit të ministrisë, 1 person ushtrues detyre i sekretarit të ministrisë, 5 persona drejtor në departamentet përkatëse nëpër ministri, 5 persona nga pozita e inspektorit në ATK në kuadër të Ministrisë së Financave, si dhe 30 persona tjerë nga pozitat e ndryshme ministrore si zyrtar të prokurimit, zyrtar të shëndetësisë, anëtar në komisionet përkatëse brenda ministrive e të tjerë.

Pas zyrtarëve komunal, janë ndërmarrjet publike me numrin më të madh të personave/zyrtarëve ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014. Për pozitat drejtor, menaxher dhe zyrtarë të tjerë të ndërmarrjeve publike, ishin gjithsej 127 persona të dyshuar ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën përkatëse (8<sup>60</sup> persona për pozitat drejtor/menaxherë, ndërsa 119<sup>61</sup> persona zyrtarë tjerë në ndërmarrjet publike).

Gjyqësori, Prokuroria dhe Policia, organe këto të thirrura për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e rasteve korruptive, janë institucione këto vet të përfshira në rastet korruptive. Sipas të dhënave të siguruara nga prokuroritë, nga gjithsej 1,164 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura të natyrës korruptive, 46<sup>62</sup> të tillë janë gjykatës, kryetarë të gjykatave dhe ish-gjykatës, 15<sup>63</sup> persona ishin zyrtarë tjerë gjyqësorë, 14<sup>64</sup> persona janë kryeprokuror, prokuror dhe ish prokuror si dhe 47<sup>65</sup> persona janë zyrtarë policor në pozitat e ndryshme në institucionin policor.

Agjencitë e pavarura dhe agjencitë në kuadër të institucioneve, bizneset/kompanitë private dhe bankat, janë institucionet tjera të cilat kishin një numër të konsideruar të zyrtarëve të tyre të përfshirë në rastet e natyrës korruptive. Nga gjithsej 1,164 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet (nëntor 2013 – dhjetor 2014), 56 të tillë ishin zyrtarë nga agjencionet e pavarura dhe agjencionet tjera në kuadër të institucioneve, prej të cilëve 5<sup>66</sup> drejtorë/menaxherë dhe 51<sup>67</sup> zyrtarë të tjerë. Në anën tjetër,

<sup>60</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 127 zyrtarët e ndërmarrjeve/ kompanive publike, 8 prej tyre janë profilizuar si drejtorë të ndërmarrjeve, ndërsa 119 persona nga pozitat tjera brenda ndërmarrjeve/ kompanive publike. Në mesin e 8 drejtorëve të ndërmarrjeve publike rastet e të cilëve janë zgjidhur për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, IKD ka identifikuar ndër tjerë Drejtorin e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, 2 drejtor të kompanive publike rajonale “Ujësllësi”, Kryeshef Ekzekutiv po në “Ujësllës”, Kryeshef Ekzekutiv në ndërmarrje tjetër publike, UD Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrje Publike ish Drejtor Kombinati dhe drejtorë nga ndërmarrje/kompani tjera publike.

<sup>61</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 119 zyrtarët tjerë të ndërmarrjeve/ kompanive publike, 60 zyrtarë janë nga KEK (Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës), 49 të tillë janë menaxherë dhe zyrtarë në KEDS (Kompania për Shpërndarje dhe Furnizim më Energji Elektrike), 6 zyrtarë/punëtorë në PTK (Postë Telekom i Kosovës), 1 sekretar në kompaninë publike, 2 zyrtarë në kompani ujësllësi (inkasant dhe teknik), 1 mbikëqyrës në kompani publike.

<sup>62</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 46 personat të profilit kryetarë të gjykatave, gjykatës dhe ish gjykatës, 4 prej tyre janë kryetar të gjykatave, 39 prej tyre janë gjykatës ndërsa 3 persona janë ish gjykatës.

<sup>63</sup> Shënim: 15 personat e kategorizuar si “zyrtarë të tjerë” në kuadër të gjyqësorit ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, janë nga profilet e ndryshme si zyrtarë gjyqësor, referent gjyqësor dhe përfaqësues tjerë gjyqësor.

<sup>64</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 14 personat të profilit prokuror dhe ish prokuror, IKD ka identifikuar se 13 prej tyre janë prokuror ndërsa 1 person nga kategoria e tillë është ish prokuror.

<sup>65</sup> Shënim: IKD ka identifikuar se 47 persona nga gjithsej 1,164 ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën e njëjtë (nëntor 2013 – dhjetor 2014), i përkasin institucionit të Policisë së Kosovës në të cilën kategori përfshihen zyrtarët e tillë si Polic, drejtorë të departamenteve brenda PK-së, hetues, toger dhe zyrtar tjerë në kuadër PK-së.

<sup>66</sup> Shënim: Në kuadër të agjencive dhe autoriteteve të pavarura dhe të tjera, IKD ka kategorizuar zyrtarët e agjencive në dy kategori: drejtorë/ menaxherë dhe zyrtarë tjerë. Në kuadër të kategorisë “drejtorë/menaxherë” janë identifikuar gjithsej 5 persona nga të cilët dy persona janë drejtor dhe kryeshef ekzekutiv në AKPM (Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore), 1 person nga pozita e drejtorit të AKP-së (Agjencia Kosovare e Privatizimit) si dhe 2 persona nga AK (Agjencia Kadastrale e Kosovës), njëri Kryeshef ndërsa tjetri menaxher në këtë agjenci.

<sup>67</sup> Shënim: Në kuadër të zyrtarëve tjerë të agjencive dhe autoriteteve të pavarura dhe agjencive në kuadër të institucioneve tjera, IKD ka identifikuar gjithsej 51 persona të përfshirë në kuadër të ‘zyrtarëve tjerë’ nga po këto institucione. Nga gjithsej 51 personat e përfshirë, 41 prej tyre janë zyrtarë nga Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe 10 persona tjerë janë zyrtarë nga AKP (Agjencia Kosovare e Pronës) dhe agjencitë tjera.

52 persona të tillë i përkasin zyrtarëve nga bizneset dhe kompanitë private, prej të cilëve 27<sup>68</sup> ishin në pozitë drejtorë dhe menaxherë, ndërsa 25<sup>69</sup> persona të tjerë në cilësinë e zyrtarëve të tjerë në bizneset dhe kompanitë private. Krahasuar me dy institucionet paraprake, numër më i vogël i zyrtarëve ishin përfshirë në rastet e dyshuara për korrupsion në institucionin e bankave në Kosovë. Nga gjithsej 1,164 persona, 26<sup>70</sup> zyrtarë i përkasin institucionit të bankave, prej të cilëve 27<sup>71</sup> persona ishin në pozitën menaxherit dhe drejtorit të bankave. IKD ka identifikuar se në fushën e arsimit, gjithsej 27<sup>72</sup> persona, në cilësinë e profesorëve dhe zyrtarëve të tjerë në universitete dhe shkolla. Ndërsa në fushën e shëndetësisë, janë identifikuar gjithsej 58 persona, prej të cilëve 53<sup>73</sup> të tillë janë në cilësinë e mjekut, ndërsa 5<sup>74</sup> të tjerë në cilësinë e infermierëve, ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014. Në një rubrikë të veçantë janë kategorizuar rastet e zgjidhura për qytetarët, ndaj të cilëve prokurorët kanë zgjidhur raste ndaj 30<sup>75</sup> qytetarëve. Në rubrikën e fundit të tabelës, IKD ka kategorizuar të gjithë personat të cilët në mungesë të informacioneve të sakta, ka qenë e pamundur të kategorizohen në rubrikat e mësipërme, sipas institucioneve dhe agjencioneve. Rubrika “zyrtarë të tjerë nga institucionet e ndryshme”, përfshin 368<sup>76</sup> persona nga totali i rasteve të zgjidhura për periudhën nëntor 2013 - dhjetor 2014. Të gjitha këto dhe personat të tjerë të përfshirë, janë pasqyruar në tabelën numër 32 si më poshtë:

<sup>68</sup> Shënim: Në kuadër të zyrtarëve nga kompanitë/ bizneset private, IKD ka kategorizuar në “drejtorë/pronar” të kompanive/bizneseve private dhe “zyrtarë të tjerë” të kompanive/bizneseve private me ç’rast janë identifikuar gjithsejtë 52 persona nga kjo kategori. Në kategorinë Drejtorë/Pronar, gjenden 27 zyrtarë të tillë, ndërsa nga kategoria “Zyrtarë të tjerë”, janë gjithsejtë 25 persona si zyrtar dhe përfaqësues të kompanive/bizneseve private.

<sup>69</sup> Ibid.

<sup>70</sup> Ibid.

<sup>71</sup> Shënim: Në kuadër të zyrtarëve të bankave, IKD ka bërë kategorizimin e tyre në “drejtorë/menaxherë” të bankave dhe “zyrtarë të tjerë” të bankave me ç’rast janë identifikuar gjithsejtë 26 persona nga kjo kategori. Në kategorinë Drejtorë/Menaxherë, gjenden vetëm 2 zyrtarë, ndërsa nga kategoria “Zyrtarë të tjerë”, janë gjithsejtë 24 persona. Ndër të tjerë, zyrtarët bankarë janë nga pozitë e agjentëve kreditor, analistëve kreditor, punonjës në recepcionin bankar dhe të tjerë.

<sup>72</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 27 zyrtarët e arsimit në universitete dhe shkolla, 1 person është nga pozita e Rektorit të Universitetit të Prishtinës (UP), 2 persona janë në kuadër të pozitës Sekretar i Përgjithshëm i UP-së, 3 asistentë në Fakultetin e Mjekësisë në kuadër të UP-së, 12 persona në kuadër të profileve profesor, arsimtar dhe mësues (universitete dhe shkolla) dhe 9 zyrtarë të tjerë arsimor, përfshirë edhe drejtor shkollash.

<sup>73</sup> Shënim: Në fushën e shëndetësisë, IKD ka bërë kategorizimin e zyrtarëve shëndetësor nga profesioni i mjekut dhe infermier/e apo teknik medicinal. Nga gjithsejtë 1,164 personat ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet, IKD ka identifikuar 58 prej tyre të jenë mjek dhe teknik medicinal, nga të cilët 53 mjek nga departamentet e ndryshme, dhe 5 persona të tjerë si teknik medicinal.

<sup>74</sup> Ibid.

<sup>75</sup> Shënim: Në kuadër të kategorisë “Qytetarë”, janë futur të gjithë personat të cilët në regjistrat e prokurorive, figurojnë si qytetarë dhe të papunë.

<sup>76</sup> Sqarim: Në kuadër të kategorisë “Zyrtarë të tjerë”, janë përfshirë të gjithë zyrtarët nga institucionet e ndryshme të dhënat e të cilëve janë të kompletuara mirëpo që nuk u përkasin profileve të kategorizuar si më lartë. Gjithashtu janë përfshirë zyrtarët për të cilat IKD nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme edhe për institucionin, të dhëna këto të siguruar nga prokuroritë themelore dhe PSRK.

Në kategorinë “Zyrtarë të tjerë në institucione të ndryshme”, IKD ka identifikuar të jenë gjithsejtë 368 persona nga gjithsejtë 1,164 personat ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014. Nga gjithsejtë 368 personat, zyrtarët për të cilët janë të dhënat e kompletuara janë, 11 zyrtar nga Doganat e Kosovës, 11 punëtor/zyrtar në OJQ, 19 persona nga pozitë Kryeprokuror, prokuror, gjykatës, avokat, polic, togerë e të tjerë, 13 avokat, 5 oficer në Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK), 14 punëtor privat, 7 zyrtar nga Qendra për Punë Sociale dhe zyrtarë të tjerë.

Institucionet	Pozitat	Kategoritë					Total:
		Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Pezullim	Cedim	
Qeveri	Ministër/Ish-ministër	1	2	1			4
	Zyrtarë tjerë	8	15	22			45
Kuvend	Deputetë	2		6		1	9
Gjyqësori	Kryetar/Gjykatës	27	12	3		4	46
	Zyrtarë tjerë	6	1	7		1	15
Prokuroria	Kryeprokuror/prokuror	7	2	2		3	14
Policia	Policë/ Zyrtarë tjerë policor	18	12	15		2	47
Komunat	Kryetar/ Asamblistë	6	17	33		3	59
	Zyrtarë tjerë	41	51	85	1	3	181
Agjencionet e pavarura dhe Agjencionet tjera	Drejtor/menaxherë	1	2	2			5
	Zyrtarë tjerë	9	19	23			51
Ndërmarrjet publike	Drejtor/menaxherë	4		4			8
	Zyrtarë tjerë	14	40	65			119
Bizneset/kompanitë/firmat	Drejtor/Pronar	3	7	17			27
	Zyrtarë tjerë	5	7	13			25
Bankat	Drejtor/menaxherë			2			2
	Zyrtarë tjerë	7	4	13			24
Arsimi	Universitete dhe shkolla	7	3	17			27
Shëndetësi	Mjek	1	2	50			53
	Infermier/e	3		2			5
Qytetarë	Qytetarë	12	3	15			30
Tjera	Zyrtarë tjerë nga Instituc. të ndryshme	83	112	171		2	368
<b>Total</b>	<b>Total</b>	<b>265</b>	<b>311</b>	<b>568</b>	<b>1</b>	<b>19</b>	<b>1,164</b>

**Tabela 32 - Numri i përgjithshëm personave të kategorizuar sipas pozitave dhe institucioneve ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet për periudhën nëntor 2013 - dhjetor 2014**

Ndërsa personat për të cilët nuk ekzistojnë të dhënat e plota bazuar në të dhënat e siguruar në prokuroritë themelore dhe në PSRK, janë identifikuar të jenë 64 drejtor për të cilët nuk dihet institucioni, 23 punëtor, 12 persona përgjegjës, 11 studentë, 13 fermerë, 10 juristë, 7 ekonomistë, 10 vozitës, 6 menaxherë, 8 ekspert të gjeodezisë, 4 inspektor, 10 persona zyrtar, pastaj 10 persona të shënuara si “funksioni i të dyshuarit” dhe zyrtar tjerë si: Drejtor i Departamentit të Licencimit, Anëtar i Komisionit, Shef i Sallës, Pastruese, Pensionist, Kontabilist dhe shef i kontabilitetit, zjarrfikës, depoist, inspektor të vozitjes, gazetar, menaxher prokurimi, moler, arkatere, referente dhe të tjerë për të cilët nuk ka të dhëna për institucionin që i përkisnin.

Tabela e mësipërme, ndër tjera përmban gjithashtu të dhënat e kategorizuara sipas mënyrës së zgjidhjes. Bazuar në të dhënat në tabelë, pothuajse për gjysmën e rasteve të zgjidhura, janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet. Nga gjithsej 1,164 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura, për 576 persona apo 49.48% e numrit të përgjithshëm, janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet,<sup>77</sup> ndërsa ndaj 568 personave apo 48.79%, janë ngritur aktakuza. Po ashtu në bazë të këtyre të dhënave, IKD gjen raste ndaj 20 personave të ceduara (bartura) dhe pezulluara për periudhën e njëjtë raportuese (nëntor 2013 – dhjetor 2014), apo 1.71% e personave të përfshirë në rastet e zgjidhura.

Kategoria e zyrtarëve komunal e cila përfshinë numrin më të madh të rasteve të zgjidhura ndër profilet tjera, gjithsejtë 240 persona nga 1,164 sa janë zgjidhur gjithsejtë për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, prokurorët kishin nxjerrë vendime për ngritjen e aktakuzës për 118 persona, kishin hudhur kallëzimet penale dhe kishin pushuar hetimet për 115 persona,<sup>78</sup> për 1 person kishin pezulluar rastin ndërsa për 6 persona kishin ceduar rastet. Pra, prokuroritë kishin arritur të ngritin aktakuzë për më shumë se gjysmën e zyrtarëve të dyshuar për veprat penale të korrupsionit, mirëpo shqetësues mbetet numri i madh i rasteve të hudhura poshtë dhe të pushuara. E njëjta problematikë është trajtuar në raportet paraprake të IKD-së.

Pas zyrtarëve komunalë, janë zyrtaret e ndërmarrjeve dhe kompanive publike me numrin më të madh të personave të përfshirë në dyshimet për veprat penale të natyrës korruptive me gjithsej 127 persona/zyrtarë. Prokurorët kishin hudhur poshtë kallëzimet penale për 18 persona, kishin pushuar hetimet për 40 të tillë, ndërsa kishin ngritur aktakuza për 69 të tjerë. Pra, pothuajse gjysma e personave të përfshirë në rastet e zgjidhura (68 persona nga gjithsejtë 127 të tillë), janë hudhur poshtë dhe janë pushuar, ndërsa për gjysmën tjetër (69 persona) janë ngritur aktakuza.

Sa i përket profilit të zyrtarëve të kategorizuar në kuadër të Qeverisë së Kosovës, nga gjithsejtë 49 persona (ministra, ish ministra dhe zyrtarë tjerë), për 9 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale, për 17 persona janë pushuar hetimet ndërsa për 23 persona, janë ngritur aktakuza. Në këtë rast, nga gjithsej 49 persona, 4 të tillë janë ministra dhe ish ministra dhe në këtë rast vetëm ndaj një ish ministri është ngritur aktakuzë, ndërsa për 3 të dyshuarit tjerë ministra, janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet.<sup>79</sup>

---

<sup>77</sup> Shënim: Ndaj 265 personave janë hudhur poshtë kallëzimet penale ndërsa për rastet me 311 persona, janë pushuar hetimet.

<sup>78</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 115 personat ndaj të cilëve janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet, për 47 të tillë janë hudhur poshtë kallëzimet penale, për 68 persona kanë pushuar hetimet.

<sup>79</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 49 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura në kuadër të profilit “Qeveria” (3 ministra, 1 ish ministër dhe 45 zyrtarë të tjerë qeveritar), për 26 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet (për 9 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale, për 17 persona janë pushuar hetimet), ndërsa për 23 persona janë ngritur aktakuza.

Prokurorët e prokurorive themelore dhe asaj Speciale, kishin hudhur poshtë dhe kishin pushuar hetimet edhe për një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve gjyqësor dhe prokurorial (kryetarë të gjykatave, gjykatës, ish gjykatës dhe zyrtarë të tjerë gjyqësor, si dhe prokuror dhe ish prokuror). Nga gjithsej 46 gjykatësit, ish gjykatësit dhe kryetarët e gjykatave të përfshirë në rastet e zgjidhura, vetëm për 3 të tillë është ngritur aktakuzë<sup>80</sup>, për 39 të tjerë janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet, ndërsa për 4 të tillë janë ceduar rastet (bartur në kompetencë). Nga gjithsej 15 zyrtarët tjerë gjyqësor, për 7 të tillë janë hudhur poshtë dhe pushuar hetimet, për 7 janë ngritur aktakuza ndërsa për 1 person është ceduar rasti. Sa u përket prokurorëve dhe ish prokurorëve të dyshuar për kryerjen e veprave penale të natyrës korruptive, nga gjithsejtë 14 të tillë, vetëm për 2 është ngritur aktakuzë, ndërsa për 8 tjerë janë pushuar hetimet dhe hudhur poshtë kallëzimet penale, kurse ndaj 3 tjerëve janë ceduar rastet, bazuar në të dhënat e siguruara nga prokuroritë përkatëse.

Më shumë se gjysma e rasteve janë hudhur poshtë dhe janë pushuar edhe për zyrtarët policor. Nga gjithsejtë 47 zyrtarët policor të përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, për 30 të tillë janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet<sup>81</sup>, ndaj 15 zyrtarëve janë ngritur aktakuza ndërsa për 2 të tillë janë ceduar rastet.

Ndryshe është përqindja e zgjidhjes së rasteve sa i përket agjencive të pavarura dhe agjencive tjera në kuadër të institucioneve, me ç'rast për më shumë se gjysmën e personave/zyrtarëve nga agjencitë e tilla, janë ngritur aktakuza. Bazuar në statistikat e siguruara nga prokuroritë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, IKD ka identifikuar se nga gjithsejtë 52 zyrtarët përkatës të përfshirë në rastet e zgjidhura, ndaj 30 të tillëve janë ngritur aktakuza. Për 8 persona/zyrtarë janë hudhur poshtë kallëzimet penale ndërsa për 14 të tillë janë pushuar hetimet.

Përqindje e njëjtë e dominimit të aktakuzave ndaj rasteve të hudhura poshtë dhe të pushuara, ekziston edhe për kategorinë e mjekëve dhe infermierëve apo teknikëve medicinal. Nga gjithsejtë 58 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura ndaj kategorisë së njëjtë, për 52 persona/zyrtarë janë ngritur aktakuza (50 të tillë janë mjek), ndaj 2 të tillëve kanë pushuar hetimet ndërsa ndaj 4 personave/zyrtarëve, janë hudhur poshtë kallëzimet penale.

---

<sup>80</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 46 personat në pozitat e kryetarëve të gjykatave, gjykatësve dhe ish gjykatësve, vetëm ndaj 3 gjykatësve janë ngritur aktet akuzuese, ndërsa për të gjithë kryetarët e gjykatave, gjykatësit tjerë dhe ish gjykatësit, janë hudhur poshtë kallëzimet penale, janë pushuar hetimet dhe u janë ceduar lëndët.

<sup>81</sup> Shënim: Nga gjithsejtë 47 personat/zyrtarët policor ndaj të cilëve janë hudhur poshtë kallëzimet penale dhe janë pushuar hetimet, për 18 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale, për 12 të tillë janë pushuar hetimet.

Kategoria e profesorëve në universitete dhe shkolla, drejtorëve të shkollave, arsimtarëve, mësuesve dhe të tjerë, nga gjithsejtë 27 të tillë të përfshirë në rastet e zgjidhura për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, për 17 të tillë janë ngritur aktakuza, për 3 janë pushuar hetimet ndërsa për 7 të tjerë janë hudhur poshtë kallëzimet penale.

Bazuar në statistikat e tilla, përveç zyrtarëve nga institucionet e ndryshme, edhe qytetarët kanë qenë të përfshirë në veprat penale të natyrës korruptive. Nga gjithsejtë 30 qytetarë, për 15 të tillë janë ngritur aktakuzat, për 3 persona kanë pushuar hetimet ndërsa për 12 të tillë janë hudhur poshtë kallëzimet penale.

Dhe në fund, më kategorinë “zyrtarë tjerë nga institucionet e ndryshme”, e cila gjithashtu përfshinë numrin më të madh të personave , gjithsejtë 368 persona të përfshirë në rastet e zgjidhura nga 1,164 të tillë për periudhën nëntor 2013 - dhjetor 2014, për 171 persona janë ngritur aktakuza, për 112 të tillë janë pushuar hetimet, për 83 persona janë hudhur poshtë kallëzimet penale ndërsa për 2 të tillë janë ceduar rastet. Të gjitha janë pasqyruar në tabelën e mësipërme.

Bazuar në të dhënat e tilla, IKD ka identifikuar raste të pakta të profileve të larta si ministër, deputet, kryetar të komunave dhe zyrtarë të tjerë të profileve të larta. Sipas Udhëzimi Administrativ për caktimin e korrupsionit të nivelit të lartë, PSRK ka në kompetencë ndjekjen e zyrtarëve të nivelit të lartë për të cilët dyshohet të janë të përfshirë në veprat penale të natyrës korruptive.<sup>82</sup> Bazuar në të dhënat e siguruara nga prokuroritë përkatëse dhe KPK për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, IKD ka identifikuar rastet e zgjidhura për tre ministra, një ish ministër, nëntë deputetë dhe ish deputetë, 13 kryetar të komunave dhe 5 ish kryetar dhe zyrtarë të tjerë nga institucionet e ndryshme.

Edhe pse IKD kishte kërkuar nga PSRK të kuptojë arsyet e vërteta për sfidat dhe vështirësitë në ndjekjen e zyrtarëve të nivelit të lartë, IKD nuk kishte marr përgjigjet për çështjet e tilla nga PSRK.<sup>83</sup> Në anën tjetër, kryeprokurorët e PTh-ve mungesën e personave të profileve të larta të përfshirë në rastet e tyre kishin arsytuar me mungesën e kompetencës e cila gjë sipas tyre, i takon PSRK-së.

---

<sup>82</sup> Udhëzim Administrativ - kur një vepër e korrupsionit, do të konsiderohet si e nivelit të lartë; miratuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës më 13 nëntor 2013 në Prishtinë; [http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezim\\_kur\\_nje\\_veper\\_e\\_korrupsionit\\_do\\_te\\_konsiderohet\\_si\\_e\\_nivelit\\_te\\_larte.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/Udhezim_kur_nje_veper_e_korrupsionit_do_te_konsiderohet_si_e_nivelit_te_larte.pdf).

<sup>83</sup> Shënim: Në muajin mars 2015, IKD fillimisht kishte kërkuar intervistë me UD Kryeprokurores së PSRK znj. Sevdije Morina, mirëpo e cila gjë nuk ishte realizuar e cila më pas, kishte sugjeruar IKD-në të dërgojë pyetjet më shkrim. Përkundër pranimit të pyetjeve nga PSRK dhe UD e Kryeprokurores më çështjet e tilla (profili i personave të dyshuar, sfidat dhe vështirësitë në ndjekjen e korrupsionit të nivelit të lartë), IKD kishte pranuar përgjigjet vetëm për një pjesë të pyetjeve, në të cilat nuk përfshiheshin edhe çështjet rreth profilit, pozitave të personave të përfshirë në rastet e hetuara nga PSRK.

Përkundër kësaj, në intervistat e kryeprokurorëve të PTh-ve për IKD-në, realizuar në muajin mars 2015, kryeprokurorët ishin shprehur të përkushtuar në punën e tyre duke u deklaruar gjithashtu për ndjekjen e të gjithë të dyshuarve nga profilet më të larta, pa dallim bazuar në kompetencat ligjore të tyre.<sup>84</sup>

## VII. DËNIMET E GJYKATAVE PËR RASTET E KORRUPSIONIT

Krahas prokurorive, IKD ka vazhduar të përcjellë zgjidhjen e rasteve të korrupsionit edhe në gjykata. Bazuar në të dhënat e siguruar nga Mekanizmi Përcjellës për rastet e zgjidhura nga gjykatat për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), janë identifikuar vetëm rastet e zgjidhura të korrupsionit ndaj 31 personave. Tabela 27, pasqyron rastet e zgjidhura të natyrës korruptive nga gjykatat për këtë periudhë raportuese dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre:

<sup>84</sup> IKD intervista me kryeprokurorët e prokurorive themelore në Kosovës:

“Prokurorët e PTh në Prishtinë ndjekin të gjitha rastet dhe të gjitha profilet që i parasheh ligji brenda kompetencës së tyre.. Asnjë rast/lëndë nuk ka dështuar për shkak të mungesës së guximit, dhe nëse ka pasur hezitim, vet Kryeprokurori është marrur me rastet e tilla”, z. Imer Beka – Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mars 2015 në Prishtinë;

“Në Pejë ndjekën profilet më të larta si: profesorët, drejtoret e drejtorateve, mjekët, zyrtar policor, etj..për cka nuk mungon vullneti as guximi të ndjekim të gjitha profilet dhe pa dallim natyrat e veprave, brenda kompetencës së prokurorisë”, z. Agron Galani – Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Pejë, mars 2015 në Pejë;

“Nga nivelet si Kryetar Komune, drejtor të drejtoratëve komunale, drejtor të KEDS, zyrtar policor, mjek, zyrtar të ATK-së, zyrtar të Autoritetit Pyjor etj, kishin qenë të përfshirë në rastet e zgjidhura dhe nën hetim të PTh në Prizren. Përkundër percpcionit të qytetarëve për mungesë të efikasitetit të Prokurorisë në ndjekjen e zyrtarëve të profileve të larta dhe veprave penale të peshave të rënda, PTh në Prizren ka ndjekur dhe hetuar të gjithë dhe për të gjitha veprat pa dallim, bazuar në kompetencën dhe suazat ligjore për cka, ekziston edhe vullneti, gatishmëria dhe guximi i prokurorisë dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve pa dallim të profileve apo veprave”, z. Metush Biraj – Ud. Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren, mars 2015 në Prizren;

“Konsideroj se jemi tu e kry punën në bazë të kompetencës dhe ligjit.. ka guxim dhe vullnet të prokurorisë dhe prokurorëve më i ndjekë të gjitha rastet e korrupsionit, pa dallim. Niveletë janë nga me të ndryshmet si: zyrtar komunal, zyrtar policor, zyrtar nga ndërmarrjet publike, drejtor të shkollave, zyrtar të prokurorimit dhe të tjerë”, z. Rasim Maloku – Ud. Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, mars 2015 në Ferizaj;

“PTh në Gjakovë ka zgjidhur raste dhe ka në procedim persona me profilet si kryetar komune, zyrtar komunal, zyrtar policor, drejtor shkolle dhe të tjera.. Konsideroj se jemi duke ndjekur të gjitha nivelet në rastet kur jemi në dijeni se po kryhet vepra apo është kryer.. Për luftimin e korrupsionit, ekziston vullneti, gatishmëria dhe guximi për çka Prokuroria dhe prokurorët jemi të gatshëm me reagu në çdo moment kur dyshohet për diçka të tillë”, znj. Shpresa Bakija – Kryeprokurorë e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, mars 2015;

“Profilet kryesore të zyrtarëve të dyshuar ndaj të cilëve janë zgjidhur rastet dhe të tjerëve që janë nën hetim, janë zyrtarë komunal, zyrtar policor, zyrtar në ekonomi dhe të tjerë.. Ekziston vullneti dhe guximi me i ndjekë të gjitha rastet dhe ndaj të gjithë zyrtarëve/ personave pa dallim pozite, nacionaliteti etj., kushdo qoftë ai”, z. Shyqeri Sylja – Kryeprokuror në PTh në Mitrovicë, mars 2015.

Numri i personave për të cilët kanë vendosur gjykatat gjatë kësaj periudhe raportuese (janar - mars 2015)	Numri i personave ndaj të cilëve gjykatat kanë shpallur vendime/aktgjykime	Personat e shpallur fajtor	Personat e liruar	Aktakuzat e refuzuara
PSRK				
PTH në Prishtinë				
PTH në Prizren	13	7	2	4
PTH në Pejë	3	3		
PTH në Gjilan	2	2		
PTH në Mitrovicë	2	2		
PTH në Ferizaj	5	5		
PTH në Gjakovë	6	3	2	1
<b>Total:</b>	31	22	4	5

Tabela 27 - Numri i personave për të cilët kanë vendosur gjykatat gjatë kësaj periudhe raportuese (janar - mars 2015)

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, nga gjithsej 31 personat e përfshirë në rastet e zgjidhura nga gjykatat për këtë periudhë raportuese (janar-mars 2015), 22 persona janë shpallur fajtor, 4 persona janë liruar nga akuza ndërsa për 4 persona, është refuzuar aktakuza.

PTh në Prizren ka më shumë se prokuroritë tjera persona të përfshirë në rastet e zgjidhura nga gjykatat për këtë periudhë raportuese. Nga gjithsej 31 persona, 13 të tillë i takojnë rasteve të përfaqësuar nga PTh në Prizren, me ç'rast 7 persona janë shpallur fajtor, 2 janë liruar ndërsa për 4 persona, është refuzuar aktakuza. PTh në Gjakovë vijon me gjithsej 6 persona ndaj të cilëve gjykata ka zgjidhur rastet (3 të tillë janë shpallur fajtor, 2 janë liruar nga aktakuza ndërsa ndaj njërit është refuzuar aktakuza). PTh në Ferizaj ka përfaqësuar rastet ndaj 5 personave, me ç'rast të gjithë personat janë shpallur fajtor nga gjykata. PTh në Pejë kishte përfaqësuar rastet për 3 persona, me ç'rast të gjithë janë shpallur fajtor nga gjykata. Dy prokuroritë tjera themelore, PTh në Gjilan dhe PTh në Mitrovicë kishin nga 2 persona të përfshirë në rastet e zgjidhura dhe të gjithë ishin shpallë fajtor. Bazuar në të dhënat e mekanizmit përcjellës, të siguruar në KPK, IKD ka identifikuar se për periudhën raportuese janar – mars 2015, asnjë rast i përfaqësuar nga PSRK dhe PTh në Prishtinë, nuk ishte zgjidhur.

Rastet e paketa të zgjidhura nga gjykatat dhe të tilla të pazgjidhura fare siç është rasti me PSRK-në dhe PTh në Prishtinë, vazhdojnë të pasqyrojnë edhe njëherë efikasitetin e dobët të këtyre institucioneve, të cilat rezultate do të duhej të alarmonin institucionet përgjegjëse për ndërmarrjen e masave konform përgjegjësive dhe dispozitave ligjore për zgjidhjen e rasteve të shumta të mbetura në punë. IKD vazhdon të rekomandojë prokuroritë dhe gjykatat në përfaqësimin më efikas të rasteve dhe në efikasitetin më të madh për zgjidhjen e rasteve të tilla.

## **VIII. DËSHTIMI NË RESPEKTIMIN E MEKANIZMIT PËRCJELLËS PËR RASTET E KORRUPSIONIT**

IKD ka vazhduar të përcjellë trendin e statistikave në mekanizmin përcjellës, respektimi i të cilit është paraparë edhe me Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial për Luftimin e Korrupsionit. Bazuar në monitorimin e IKD-së, prokuroritë kanë vazhduar të dështojnë në respektimin me përpikëri të rregullave të Mekanizmit Përcjellës.

Sikurse në raportet paraprake, edhe për periudhën janar, shkurt dhe mars 2015, IKD ka identifikuar raste të regjistruara me vonesë në mekanizmin përcjellës dhe raste të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, edhe pse të njëjtat raste ekzistonin në regjistrat paraprak. Rastet e tilla janë identifikuar në të dyja kategoritë e të dhënave, për të dhënat e shënuara si PP dhe të tjerat si PPN.

Derisa në kategorinë PP janë identifikuar gjithsej 15 raste me 35 persona të regjistruara me vonesë dhe raste të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, në kategorinë PPN janë identifikuar 11 raste të tilla me 13 persona.

Tabela në vijim, ka paraqitur rastet me persona PP të regjistruara me vonesë si dhe rastet të cilat nuk ekzistojnë në mekanizmin përcjellës për këtë periudhë raportuese të cilat ekzistojnë në regjistrat muajve paraprak:

PP-Rastet dhe personat e regjistruara me vonesë dhe ato të cilat nuk ekzistojnë në regjistra, sipas prokurorive (janar - mars 2015)	Të regjistruara me vonesë		Nuk ekzistojnë në regjistra		TOTAL	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
<b>PTh Prishtinë</b>	<b>6</b>	<b>22</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>23</b>
<b>PTh Gjilan</b>	1	4			1	4
<b>PTh Prizren</b>			5	7	5	7
<b>PTh Pejë</b>			2	2	2	2
<b>Total</b>	7	26	8	10	15	36

**Tabela 28 - Rastet dhe personat e regjistruar me vonesë dhe rastet dhe personat të cilët nuk ekzistojnë në Mekanizmin Përcjellës në fund të kësaj periudhe raportuese**

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në tabelën e mësipërme, IKD ka identifikuar gjithsej 15 raste me 36 persona të cilat janë regjistruar me vonesë nga prokuroritë përkatëse dhe rastet të cilat nuk figurojnë fare në regjistrin e kallëzimeve penale, as në rubrikën e rasteve të zgjidhura për periudhën janar, shkurt mars 2015. Rastet e tilla të cilat tani nuk ekzistojnë në mekanizmin përcjellës, kishin ekzistuar në regjistrat e muajve paraprak. Nga gjithsej 15 rastet me 36 persona, 7 të tilla me 26 persona janë regjistruar me vonesë nga prokuroritë, ndërsa 8 raste me 10 persona nuk ekzistojnë fare në mekanizmin përcjellës. PTh në Prishtinë vazhdon të prijë me numrin me të madh të rasteve të tilla e cila nga gjithsej 7 rastet me 23 persona, 6 të tilla me 22 persona figurojnë të regjistruara me vonesë ndërsa 1 rast me 1 person nuk ekziston fare në mekanizmin përcjellës.<sup>85</sup> PTh në Prizren vijon me 5 raste dhe 7 persona,<sup>86</sup> PTh në Pejë 2 raste me 2 persona<sup>87</sup> dhe PTh në Gjilan 1 rast me 4 persona.<sup>88</sup>

<sup>85</sup> *Shënim:* PTh në Prishtinë ka gjithsej 7 raste me 23 persona, të cilat janë regjistruar me vonesë dhe nuk figurojnë në Mekanizmin Përcjellës. Në lidhje me këto raste, IKD jep shpjegim për secilin rast konkret. Në vazhdim janë rastet e PTh në Prishtinë, të cilat janë regjistruar me vonesë në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 8909/14-IIPR, rast më një (1) person, pranuar më 24 dhjetor 2014;
2. Lënda numër 1248/14-IPR, rast më tetë (8) persona, pranuar më 25 nëntor 2014;
3. Lënda numër 1356/14-IPR, rast më tre (3) persona, pranuar më 30 dhjetor 2014;
4. Lënda numër 1355/15-IPR, rast më një (2) persona, pranuar më 30 dhjetor 2014;
5. Lënda numër 460/14-IPR, rast më tre (3) persona, pranuar më 16 maj 2014;

PTh në Gjilan dhe PTh në Pejë, raste të tilla të cilat nuk ekzistojnë fare në mekanizmin përcjellës, kishin gjithashtu për kategorinë PPN, ndryshe të njohura si raporte në fazën fillestare, të cilat, pasoheshin edhe nga PTh në Mitrovicë me raste të regjistruara me vonesë dhe të tilla të cilat nuk ekzistojnë fare në mekanizmin përcjellës. Tabela në vijim, ka paraqitur rastet me persona PPN të regjistruara me vonesë si dhe rastet të cilat nuk ekzistojnë në regjistrin e të dhënave për këtë periudhë raportuese:

PPN-Rastet dhe personat e regjistruara me vonesë dhe ato të cilat nuk ekzistojnë në regjistra, sipas prokurorive (janar - mars 2015)	Të regjistruara me vonesë		Nuk ekzistojnë në regjistra		TOTAL	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PTh Gjilan			1	1	1	1
PTh Mitrovicë	1	1	1	1	2	2
PTh Pejë			8	10	8	10
<b>TOTAL</b>	1	1	10	12	11	13

**Tabela 29 – PPN Rastet dhe personat e regjistruar me vonesë dhe rastet dhe personat të cilët nuk ekzistojnë në Mekanizmin Përcjellës në fund të kësaj periudhe raportuese**

6. Lënda numër 1354/2014-IPR, rast më pesë (5) persona, pranuar më 29 dhjetor 2014;

Ndërsa, rasti në PTh në Prishtinë, i cili nuk figuron në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 829/12-IPR, rast më një (1) person, pranuar më 31 tetor 2012.

<sup>86</sup> *Shënim:* PTh në Prizren ka gjithsej 5 raste me 7 persona, të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës. Në vazhdim janë rastet të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 302/14-IPZ, rast më një (1) person, pranuar më 11 nëntor 2014;

2. Lënda numër 337/14-IPZ, rast më një (1) person, pranuar më 18 dhjetor 2014;

3. Lënda numër 1455/12-IIPZ, rast më një (1) person, pranuar më 22 maj 2012;

4. Lënda numër 336/14-IPZ, rast më tre (3) persona, pranuar më 18 dhjetor 2014;

5. Lënda numër 309/14-IPZ, rast më një (1) person, pranuar më 17 nëntor 2014.

<sup>87</sup> *Shënim:* PTh në Pejë ka gjithsej 2 raste me 2 persona të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës. Në vazhdim janë rastet të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër PP 23/2013-I PE, rast më një (1) person, pranuar më 28 janar 2013;

2. Lënda numër 373/13-I PE, rast më një (1) person, pranuar më 22 nëntor 2013.

<sup>88</sup> *Shënim:* PTh në Gjilan ka gjithsej 1 rast me 4 persona i cili është regjistruar me vonesë në Mekanizmin Përcjellës. Në vazhdim është pasqyruar rasti i cili është regjistruar me vonesë në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 4/2015-I-Gji, rast më katër (4) persona, pranuar më 23 dhjetor 2014.

Tabela ka pasqyruar gjithsej 11 raste me 13 persona, nga të cilat PTh në Pejë është prokuroria me numrin me të madh të rasteve të tilla me gjithsej 8 raste me 10 persona,<sup>89</sup> PTh në Mitrovicë 2 raste me 2 persona<sup>90</sup> dhe PTh në Gjilan 1 rast me 1 person.<sup>91</sup>

Instituti i Kosovës për Drejtësi ka intervistuar kryeprokurorët e prokurorive përkatëse, me ç'rast kryeprokuroret e PTh në Prishtinë, sikurse PTh në Mitrovicë, PTh në Prizren dhe PTh në Pejë, deklarohen të mos jenë në dijeni nëse në prokuroritë e tyre, kishte pasur raste të regjistruara me vonesë apo tjera të cilat fare nuk ekzistojnë në regjistrin e kallëzimeve penale, rrjedhimisht as në mekanizmin përcjellës.<sup>92</sup> Sipas tyre, do të ndërmerren të gjitha masat për diagnostifikimin e rasteve të tilla dhe evitimin e problemeve të cilat reflektojnë në të dhënat e mekanizmit përcjellës. Përkundër kësaj, përgjegjës në shkrimoren e PTh në Prizren deklarohen për arsyet e defekteve të tilla. Sipas zyrtarit përkatës, arsye kryesore e mos-ekzistimit të rasteve në regjistrin e kallëzimeve penale, përkundër faktit se të njëjtat kanë ekzistuar në regjistrat e muajve paraprak, është cedimi i atyre rasteve në prokuroritë tjera sipas kompetencës, ndërsa sa i përket rasteve të regjistruara me vonesë, sipas tyre mund të jetë përjashtimisht ndonjë lëndë e cila fillimisht është regjistruar nën shenjën PPN, më pas, pas hetimeve, është regjistruar si lëndë PP, duke ardhur kështu deri të vonesat në regjistrimin e lëndëve të tilla.

Përkundër faktit se Plani i Veprimit ka paraparë shqiptimin e masave për të gjithë zyrtarët që nuk zbatojnë atë, prej hyrjes në fuqi të Planit të Veprimit, IKD ende nuk ka identifikuar rast kur ndaj ndonjë përgjegjësi zyrtar në prokuroritë përkatëse, janë ndërmarr masa për defektet e tilla, e cila do të garantonte zbatimin e Planit të Veprimit dhe funksionimin normal të mekanizmit përcjellës. IKD në

<sup>89</sup> *Shënim:* PTh në Pejë ka gjithsej 8 raste PPN me 10 persona të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës. Në vazhdim janë rastet të cilat nuk figurojnë fare në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 292/14-I-PE-PPN, rast më një (1) person, pranuar më 19 dhjetor 2014;
2. Lënda numër 302/13-I PE -PPN, rast më një (1) person, pranuar më 5 nëntor 2013;
3. Lënda numër PPN 122/2013-I PE, rast më një (1) person, pranuar më 30 maj 2013;
4. Lënda numër PPN 139/2013-I PE, rast më dy (2) persona, pranuar më 2 prill 2013;
5. Lënda numër PPN 153/2013-I PE, rast më një (1) person, pranuar më 19 qershor 2013;
6. Lënda numër 213/13-I-PE-PPN, rast më dy (2) persona, pranuar më 18 korrik 2013;
7. Lënda numër 179/13-I PE -PPN, rast më një (1) person, pranuar më 9 korrik 2013;
8. Lënda numër 225/13-I PE -PPN, rast më një (1) person, pranuar më 29 gusht 2013.

<sup>90</sup> <sup>90</sup> *Shënim:* PTh në Mitrovicë ka gjithsej 2 raste me 2 persona, të cilat janë regjistruar me vonesë dhe nuk figurojnë në Mekanizmin Përcjellës. Sikurse për rastet paraprake, IKD jep shpjegim për secilin rast konkret. Në vazhdim është rasti i regjistruar me vonesë në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 03/15-IMI, rast më një (1) person, pranuar më 08 prill 2014.
- Ndërsa, rasti tjetër PPN në PTh në Mitrovicë, i cili nuk figuron në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 56/11-IMI, rast më një (1) person, pranuar më 11 maj 2011.

<sup>91</sup> *Shënim:* PTh në Gjilan ka gjithsej 1 rast me një person i cili nuk figuron fare në Mekanizmin Përcjellës:

1. Lënda numër 316/2014-PPNI-GjL, rast më një (1) person, pranuar më 25 nëntor 2014.

<sup>92</sup> IKD intervistë me z. Imer Beka, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, z. Shyqri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, z. Metush Biraj, U.d i Kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe z. Agron Galani, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë; mars 2015.

vazhdimësi ka shprehur kritika dhe shqetësimet e saja lidhur më këtë, duke rekomanduar mekanizmat përkatës në zbatimin dhe respektimin e Planit të Veprimit.

## IX. PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Sikurse është përfshirë në raportet paraprake, secila prokurori ka pasur një varg obligimesh, të cilat janë përcaktuar në Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokuroria në Luftimin e Korrupsionit.

Edhe për këtë periudhë raportuese (janar, shkurt, mars 2015), IKD ka vendosur indikatorët për të bërë matjen e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit për secilën prokurori. Përgatitja e raporteve të veçanta për secilën lëndë të parashkruar, caktimi i lëndëve me prioritet absolut dhe ndarja sipas cilësisë së kryerësve, zbatimi i dispozitave që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, caktimi i ekspertëve, takimet e rregullta me agjencitë që e zbatojnë ligjin e të tjera, kanë qenë disa prej obligimeve dhe përgjegjësi kryesore të secilës Prokurori Themelore dhe PSRK-së.

Neni 3.2 i Planit të Veprimit ka paraparë obligimin e secilës prokurori në përgatitjen e raporteve të veçanta për të gjitha lëndët që kanë arritur afatin e parashkrimit, për të cilat prokuroritë kishin nxjerrë vendime për parashkrim.

Në intervistat e realizuara me kryeprokurorët e prokurorive themelore dhe atë të PSRK-së gjatë muajit mars 2015, asnjë prokurori nuk kishte pasur raste të parashkruara deri në momentin e intervistimit sipas tyre. Në anën tjetër, Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit deklaroi të ketë pranuar raporte të veçanta për rastet e parashkrimit për periudhën raportuese janar – mars 2015, mirëpo duke mos specifikuar saktë nga cilat prokurori kishte pranuar raportet e tilla.<sup>93</sup>

Obligimi tjetër sipas nenit 5.1 për identifikimin e lëndëve dhe ndarjen e tyre sipas kompetencës, ishte përmbushur nga Prokuroritë Themelore dhe PSRK.

Obligimi i përcaktuar në nenin 5.2 të Planit të Veprimit kishte përcaktuar identifikimin e rasteve që mund të mos jenë të raportuara në regjistrin e kallëzimeve penale. Ky obligim nuk është përmbushur tërësisht nga disa prokurori. IKD gjatë monitorimit ka gjetur se një numër i rasteve dhe personave nuk janë raportuar me kohë në bazën e të dhënave në Mekanizmin Përcjellës, duke i raportuar me vonesë dhe raste të tjera që kanë ekzistuar në regjistra, ndërsa në fund të kësaj periudhe raportuese, nuk figurojnë. Pothuajse të gjithë kryeprokurorët dhe Koordinatorja Nacionale nuk janë në dijeni në lidhje me shkeljen e rregullave të Mekanizmit Përcjellës. Për këtë arsye nuk ka pasur as raportim për raste të tilla, siç përcaktohet në obligimet e Planit të Veprimit. Për këtë dështim të vazhdueshëm, ka

<sup>93</sup> IKD intervistë me kryeprokurorët e prokurorive themelore, PSRK-së dhe Koordinatorin Nacionale kundër Korrupsionit, mars 2015.

Instituti i Kosovës për Drejtësi reaguaz zyrtarisht në KPK dhe publikisht në media, IKD, siç është përfshirë edhe në raportin e kaluar, duke kërkuar zbatimin e vendimeve të KPK-së për të mbajtur përgjegjës prokurorët dhe zyrtarët që kanë dështuar në respektimin e Mekanizimit Përcjellës.<sup>94</sup> Caktimi i lëndëve me prioritet absolut dhe të ndara sipas cilësisë së kryerësve është obligimi tjetër i paraparë me nenin 6.3 të Planit të Veprimit, i cili edhe për këtë periudhë raportuese, rezulton rezulton të jetë përmbushur. Megjithatë, PTh në Pejë vazhdon të bëjë përjashtim të praktikës unike të ndarjes së rasteve në punë për prokurorët. Derisa tek të gjitha prokuroritë, janë të angazhuar një numër më i madh i prokurorëve, në PTh në Pejë edhe për periudhën janar – mars 2015, vazhdon të jetë e angazhuar vetëm një prokurore për zgjidhjen e rasteve të korrupsionit.

Obligim tjetër i përcaktuar me nenin 7.3 të Planit të Veprimit është zbatimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. IKD ka identifikuar se gjatë kësaj periudhe raportuese (janar, shkurt, mars 2015), përveç PSRK-së dhe PTh në Gjakovë të cilat kanë deklaruar për disa raste të sekuestrimit të parave, veturave dhe banesave dhe gjësendeve tjera me vlerë të ulët monetare, kryeprokurorët e prokurorive tjera themelore kanë deklaruar të mos ketë pasur raste të tilla të sekuestrimit dhe konfiskimit, disa të tjerë të mos jenë në dijeni nëse janë aplikuar dispozitat e tilla gjatë kësaj periudhe raportuese. Ndërsa Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit, deklarohet të mos jetë në dijeni dhe të mos ketë pranuar raporte me rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit për këtë periudhë raportuese.<sup>95</sup>

Obligimi i përcaktuar në nenin 7.1 për mbajtjen e takimeve të rregullta me Policinë e Kosovës, AKK-në, institucionet dhe agjencitë tjera për zbatimin e ligjit, është realizuar pjesërisht. Derisa shumica kryeprokurorëve deklarojnë të kenë mbajtur takime të rregullta sipas Planit të Veprimit, PTh në Mitrovicë, PTh në Ferizaj dhe PTh në Prizren deklarohen të mos kenë mbajtur takime edhe me AKK-në, derisa me institucionet tjera kishin mbajtur. Ndërsa Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit, deklarohet të mos ketë mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve të sajë, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet.<sup>96</sup> Sa i përket obligimit në nenin 8.2 për të raportuar për mbarëvajtjen e Planit të Veprimit nga Prokuroritë për Koordinatorin Nacionale, IKD gjen se është përmbushur. Ndërsa, PTh në Prishtinë dhe PTh në Mitrovicë, për dallim prej prokurorive tjera kanë vazhduar me praktiken e raportimit më të shpeshtë, duke raportuar në baza të rregullta javore dhe dy javore, përveç atyre të rregullta mujore.

Obligimi i përcaktuar në nenin 10.1 për angazhimin e ekspertëve të PSRK-së nga Prokuroritë Themelore nuk është përmbushur fare, pasi që të gjithë kryeprokurorët, deklarohen të mos kenë angazhuar ekspertë të tillë për periudhën raportuese, derisa edhe Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit deklarohet të mos jetë njoftuar për angazhimet e tilla.

<sup>94</sup> IKD ka reaguaz zyrtarisht tek anëtarët e KPK-së dhe publikisht në media për dështimin e Këshillit Prokurorial për të mbajtur përgjegjës prokurorët dhe zyrtarët e prokurorive që kanë dështuar të respektojnë rregullat e Mekanizimit Përcjellës për regjistrimin e rasteve të korrupsionit. “Reagim ndaj Këshillit Prokurorial të Kosovës për politika joadekuate kriminale në luftimin e korrupsionit”, reagim i IKD-së i publikuar më 3 nëntor 2014.

<sup>95</sup> IKD intervistë me kryeprokurorët dhe U.d-të e kryeprokurorëve në PSRK dhe prokuroritë themelore dhe Koordinatorin Nacionale kundër Korrupsionit, mars 2015.

<sup>96</sup> Ibid.

Komponenta e marrëdhënieve me publikun e përcaktuar në nenin 13.1 të Planit të Veprimit edhe për këtë periudhë raportuese është realizuar minimalisht nga Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit. IKD ka vlerësuar qasjen dhe informimin e publikut rreth zbatimit të këtij plani, por gjetjet dëshmojnë se ky obligim ka mbetur në masë të madhe i parealizuar. Për këtë periudhë raportuese (janar – mars 2015) Koordinatorja Nacionale është dashur t'i mbajë 6 konferenca të rregullta për media ose komunikata për media, ndërsa gjatë kësaj periudhe nuk është mbajtur asnjë konferencë për media, sikurse nuk është lëshuar asnjë komunikatë për publikun. Sipas Koordinatorës, arsyeja e mos-respektimit dhe mos-zbatimit të këtij obligimi, është mungesa e raportit me të dhëna në zyrën e statistikave.

OBLIGIMI	AFATI KOHOR	PËRGJEGJËS	KOMENT
Raport i veçantë i arsyetuar për çdo rast që ka arritur afatin e parashkrimit (neni 3.2 PV-së)	Në kohën sa më të shpejtë	<u>Prokuroria përkatëse</u> (Kryeprokurori) raporton tek <u>KPK</u>	
<b>PSRK</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nga disa prokuror kam pranuar <b>U.d. Kryeprokurorja:</b> - PSRK, gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur asnjë lëndë të parashkruar dhe asnjë vendim të kësaj prokurorie për parashkrim.		
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Kam pranuar raporte për dy lëndë. <b>Kryeprokurori:</b> Gjatë periudhës raportuese janar-mars 2015, PTh në Prishtinë nuk ka pasur asnjë lëndë të parashkruar dhe asnjë vendim të kësaj prokurorie për parashkrim. Si rrjedhojë, nuk ka pasur raport të veçantë të parashkruar.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nga disa prokuror kam pranuar <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka raste të parashkruara.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Kam pranuar një raport për një lëndë. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka raste të parashkruara.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Kam pranuar një raport për një lëndë. <b>Kryeprokurorja:</b> Nuk ka pasur raste të parashkrimit, rrjedhimisht as raporte të veçanta për lëndët e parashkruara.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nga disa prokuror kam pranuar <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Gjatë kësaj periudhe PTh në Ferizaj nuk ka pasur ndonjë rast të parashkruar.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nga disa prokuror kam pranuar <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka raste të parashkruara.		

<b>PTH Gjilan</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nga disa prokuror kam pranuar <b>Kryeprokurori:</b> Kjo prokurori nuk ka lëndë të parashkruara të kësaj natyre.		
Plani i identifikimit të lëndëve dhe ndarja e tyre sipas kompetencës (neni 5.1 PV-së)	<i>Në kohë sa më të shpejtë pas hyrjes në fuqi të PV-së</i>	<u>Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse dhe PRSK-së</u>	
<b>PSRK</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>U.d. Kryeprokurorja:</b> Pas shqyrtimit dhe analizimit të rastit është bërë identifikimi i lëndëve të korrupsionit dhe ndarja e tyre, sipas kompetencës, është bërë nga U.d. Kryeprokurorja.		
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>Kryeprokurori:</b> Është bërë.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Është bërë.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>Kryeprokurori:</b> Identifikimin e lëndëve në PTh në Pejë vazhdon të bëhet sipas praktikës së deritanishme, e cila bëhet nga vet kryeprokurori, me ç'rast lëndët e natyrës korruptive i caktohen prokurores së vetme për lëndët e korrupsionit.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>Kryeprokurorja:</b> Ndarja e lëndëve dhe caktimi i tyre me prioritet siç parasheh Plani i Veprimit vazhdon të jetë i njëjtë me praktiken e deritanishme.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Është bërë.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>Kryeprokurori:</b> Është bërë.		
<b>PTH Gjilan</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Sipas statistikave të pranuar, është përmbushur. <b>Kryeprokurori:</b> Sikurse muajt paraprak, identifikimin e lëndëve nga lëmi i korrupsionit ka bërë mbikëqyrësi i prokurorisë i cili ka bërë ndarjen e tyre sipas kompetencës.		
Identifikimi i rasteve që mund të mos jenë të raportuara në regjistër të kallëzimeve penale (neni 5.2 i PV-së)	<i>Në kohë sa më të shpejtë</i>	<u>Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse dhe PRSK-së</u>	
<b>PSRK</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>U.d. Kryeprokurorja:</b> Gjatë periudhës raportuese, PSRK ka bërë raportime të rregullta në KPK dhe nuk ka pas ndonjë mospërputhje të të dhënave statistikore me lëndët të cilat janë të regjistruara në data bazën e PSRK-së.		
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të tilla të identifikuar.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të tilla të identifikuar.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka		

	informacione për raste të tilla. <b>Kryeprokurori:</b> PTh në Pejë nuk ka pasur probleme të natyrës së tillë për periudhën janar – mars 2015.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>Kryeprokurorja:</b> Nuk ka pasur raste të tilla të identifikuar.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të tilla të identifikuar.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të tilla të identifikuar.		
<b>PTH Gjilan</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka informacione për raste të tilla. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk kemi vërejtur çfarëdo mospërputhje të statistikave në regjistrin e kallëzimeve penale.		
Caktimi i lëndëve me prioritet absolut dhe të ndara sipas cilësisë së kryesve (neni 6. 3 i PV-së) (sa prokurorë janë angazhuar para dhe pas PV-së)	<i>Në kohë sa më të shpejtë</i>	<u>Kryeprokurorët dhe prokurorët e prokurorive përkatëse</u>	
<b>PSRK</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet. <b>U.d. Kryeprokurorja:</b> Lëndët e korrupsionit trajtohen me prioritet në PSRK, ndërsa brenda lëndëve korruptive të ndara sipas cilësisë së kryerësve dhe peshës së veprës, varet nga prokurorët e rasteve, të cilët organizojnë dhe menaxhojnë rastet e tyre.		
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet. <b>Kryeprokurori:</b> Është bërë, sipas praktikës së mëhershme.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Në parim, të gjitha lëndët e korrupsionit trajtohen me prioritet, gjithashtu sipas cilësisë së kryerësve brenda lëndëve të korrupsionit.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet. <b>Kryeprokurori:</b> Lëndët e korrupsionit vazhdojnë të trajtohen me prioritet, gjithashtu me prioritet lëndët ndaj zyrtarëve të profilit të lartë.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet. <b>Kryeprokurorja:</b> Caktimi i lëndëve me prioritet siç parasheh Plani i Veprimit vazhdon të jetë i tillë.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet.		

	<b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Janë lëndë që trajtohen me prioritet.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Sikurse praktikat e deritanishme, lëndët e natyrës korruptive vazhdojnë të trajtohen me prioritet absolut, të cilat për nga natyra, nuk janë edhe të peshave shumë të rënda.</p>		
<b>PTH Gjilan</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk kam informacione, porse mbetet prioritet i prokurorive caktimi i lëndëve me prioritet.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Eprori i të njëjtës prokurori i ka dhënë prioritet absolut caktimit dhe ndarjes së këtyre lëndëve bazuar edhe në natyrën e kryerjes së këtyre veprave penale duke marrë parasysh edhe numrin e akterëve të dyshuar në çdo rast.</p>		
Zbatimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale ( <i>neni 7.3 i PV-së</i> )	<i>Gjatë tërë kohës</i>	<u>Kryeprokurorët dhe prokurorët e prokurorive përkatëse</u>	
<b>PSRK</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>U.d. Kryeprokurorja:</b> - Ka pasur raste të sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve monetare, veturave, pajisjeve elektronike, patundshmërive etj.</p>		
<b>PTH Prishtinë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të sekuestrimit apo konfiskimit.</p>		
<b>PTH Prizren</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të sekuestrimit apo konfiskimit.</p>		
<b>PTH Pejë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Nuk është në dijeni të kishte raste të tilla dhe në bazë të informacionit që kishte, nuk kishte dëgjuar të ketë pasur raste.</p>		
<b>PTH Gjakovë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>Kryeprokurorja:</b> Janë zbatuar dispozitat në rastet tilla, mirëpo ka pasur raste të shumave të vogla.</p>		
<b>PTH Ferizaj</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.</p> <p><b>U. d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të sekuestrimit apo konfiskimit.</p>		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër		

	Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të sekuestrimit apo konfiskimit.		
<b>PTH Gjilan</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Në Zyrën e Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit, nuk janë raportuar rastet e sekuestrimit apo konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk është përgjigjur.		
Takime të rregullta me PK-në, AKK-në dhe institucionet tjera (neni 7.1)	<i>Përgjatë tërë kohës</i>	<u>Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse</u>	Koordinatorja nacionale: kam pasur takime me Kryeprokurorët, por jo me AKK-në
<b>PSRK</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>U.d. Kryeprokurorja:</b> Mbahen takime të rregullta me të gjitha institucionet relevante si në vijim: Policia, Dogana dhe ATK.		
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>Kryeprokurori:</b> Janë mbajtur takime të rregullta me të gjitha institucionet, me disa prej tyre, në baza ditore.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Takime të rregullta janë mbajtur me të gjitha institucionet, ndërsa me rrallë apo fare AKK-në dhe ATK-në.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>Kryeprokurori:</b> Takime të rregullta janë mbajtur me të gjitha institucionet.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>Kryeprokurorja:</b> Takimet e rregullta sipas Planit të Veprimit, janë bërë me të gjitha Institucionet.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Takime të rregullta janë mbajtur me të gjitha institucionet, ndërsa jo edhe me AKK-në.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet. <b>Kryeprokurori:</b> Takime të rregullta janë mbajtur me Policinë e Kosovës, nivelin komunal dhe		

	regjional, dhe të gjithë mekanizmat tjerë për zbatimin e ligjit sipas Planit të Veprimit, ndërsa jo edhe me AKK-në, më të cilën kemi pikën kontaktuese.		
<b>PTH Gjilan</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka mbajtur takime personalisht, mirëpo në bazë të informacioneve, takime të rregullta kanë pasur prokuroret kontaktues me institucionet.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Rregullisht, kjo prokurori mban takime mujore e javore me institucionet e zbatimit të ligjit.</p>		
Raportim i obligueshëm për mbarvashmërinë e planit (neni 8. 2 i PV-së )	<i>Çdo fund muaji</i>	<u>Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse</u> tek Komisioni i KPK-se për Koordinim e rasteve të korrupsionit ( <u>Koordinatorja Nacionale</u> )	
<b>PSRK</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>U.d. Kryeprokurorja:</b> Po, është bërë. Mënyra e raportimit në KPK bëhet në çdo fillim muaji, çdo 3 muaj dhe sipas kërkesës së KPK-së.</p>		
<b>PTH Prishtinë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Prizren</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Pejë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Gjakovë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>Kryeprokurorja:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Ferizaj</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Po, është bërë.</p>		
<b>PTH Gjilan</b>	<p><b>Koordinatorja Nacionale:</b> Po, është raportuar.</p> <p><b>Kryeprokurori:</b> Po, është bërë.</p>		
Dy vlerësimet paraprake të PV (neni 8. 3 dhe 8.4 i PV-së)	<p>1. Në javën e parë të janarit 2014</p> <p>2. Në javën e parë të prillit 2014</p>	<u>Këshilli Prokurorial i Kosovës</u>	Koordinatorja nacionale:
Vlerësimi i gjithëmbarshtëm i PV (neni 8.5 i PV-së )	30 qershor 2014	<u>Këshilli Prokurorial i Kosovës</u>	
Pesë ekspertët kundër korrupsion të PSRK-së do të ndihmojnë PTH lidhur	<i>Gjatë tërë kohës së zbatimit të PV-së</i>	<u>Ekspertët e PSRK-së do të ndihmojnë Kryeprokurorët dhe</u>	

me lëndët e parapara në PV (neni 10. 1 i PV-së)		<u>prokurorët e PTH-ve</u>	
<b>PTH Prishtinë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së.		
<b>PTH Prizren</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së.		
<b>PTH Pejë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së.		
<b>PTH Gjakovë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>Kryeprokurorja:</b> Për këtë periudhë, nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së. Kjo për faktin se lëndët e tilla nuk janë të natyrës së rëndë dhe me pesha të mëdha.		
<b>PTH Ferizaj</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>U.d. Kryeprokurorit:</b> Nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së.		
<b>PTH Mitrovicë</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk ka pasur raste të angazhimit të ekspertëve të PSRK-së.		
<b>PTH Gjilan</b>	<b>Koordinatorja Nacionale:</b> Nuk është njoftuar për angazhimin e ekspertëve, porse konsideron se është dashur të ftohen ekspertët sa herë që ka kërkuar nevoja për këtë. <b>Kryeprokurori:</b> Nuk është përgjigjur.		
Obligohet mbështetja administrative për PTH dhe PSRK (neni 12 i PV-së)	<i>Gjatë tërë kohës së zbatimit të PV-së</i>	<u>Sekretariati i KPK-së</u>	Koordinatorja nacionale:
Obligohet mbështetja administrative për PTH dhe PSRK (neni 12 i PV-së)	<i>Gjatë tërë kohës së zbatimit të PV-së</i>	<u>Njësi për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorive</u>	Koordinatorja nacionale:
Komunikimi me publikun (neni 13. 1 i PV-së)	<i>Çdo dy javë</i>	<u>Këshilli Prokurorial i Kosovës</u>	Koordinatorja nacionale: Për tremujorin janar, shkurt mars 2015, nuk është mbajtur asnjë konferencë apo nuk është lëshuar ndonjë komunikatë. Arsyeja është mungesa e të raportit me të dhëna në zyrën e statistikave.

Nënshkrim i Memorandumeve të Bashkëpunimit ( <i>neni 13.2 i PV-së</i> )	<i>Në fillim të zbatimit të Planit të Veprimit</i>	<u>KPK me OJQ të interesuara</u>	
Masa disiplinore për moszbatim të PV-së	<i>Gjatë tërë kohës</i>	<u>KPK</u>	Koordinatorja nacionale: Në Zyrën e Koordinatores Nacionale kundër Korrupsionit nuk ka asnjë raport apo informatë se dikush prej Kryeprokurorëve apo KPK ka shqiptuar ndonjë masë disiplinore ndaj prokurorëve apo stafit, i cili ka penguar zbatimin e Planit të Veprimit.

## X. PARASHKRIMI I RASTEVE TË KORRUPSIONIT

### a. Parashkrimi i rasteve sipas prokurorive

Parashkrimi i njohur ndryshe si vjetërsimi, është institut i së drejtës penale, përmes së cilit me kalimin e afateve kohore të parapara me ligj, pushon ndjekja penale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale. Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, ka paraparë afatet e sakta kohore për arritjen e afatit të parashkrimit dhe veprimet procedurale.<sup>97</sup> E Drejta Penale dhe dispozitat penale dhe procedurale penale, gjithashtu kanë njohur dy lloje të parashkrimit, atë absolut dhe relativ, varësisht nga veprimet procedurale rreth ndjekjes dhe ekzekutimit të sanksioneve penale.<sup>98</sup>

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e pavarur të zbatimit të Planit të Veprimit<sup>99</sup>, të lidhur IKD dhe KPK, IKD ka bërë analizimin e aktvendimeve për lëndët e zgjidhura të korrupsionit (aktvendimet për hushje poshtë të kallëzimeve penale, për pushimin e hetimeve dhe aktakuzave). Ndër tjera, gjatë monitorimit dhe analizimit të akteve të PSRK-së dhe prokurorive themelore në Kosovë, IKD kishte identifikuar arritjen e afatit të parashkrimit për shumë lëndë.

Nga analizimi i akteve juridike të prokurorive përkatëse për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 dhjetor 2014, IKD ka identifikuar gjithsej 54 lëndë në të cilat PSRK dhe PTh-të kishin hushur poshtë kallëzimet penale dhe kishin pushuar hetimet për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

Tabela më poshtë, ka paraqitur rastet e tilla sipas prokurorive:

<sup>97</sup> Kodi Penal I Republikës së Kosovës, neni 106- Parashkrimi i ndjekjes penale dhe neni 108 - Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve.

<sup>98</sup> Salihu I. E Drejta Penale...

<sup>99</sup> Shënim: Bazuar në Planin Strategjik për Bashkëpunim ndër-institucional në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, më 4 nëntor 2013, ka nxjerr Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit.

<b>Prokuroritë që kanë pasur raste të parashkruara</b>	<b>Rastet e parashkruara për periudhën 4 nëntor 2013 - 31 dhjetor 2014</b>
<i>PSRK</i>	1
<b>PTh Prishtinë</b>	15
<b>PTh Prizren</b>	4
<b>PTh Pejë</b>	2
<b>PTh Gjilan</b>	7
<b>PTh Mitrovicë</b>	21
<b>PTh Ferizaj</b>	2
<b>PTh Gjakovë</b>	2
<b>Totali</b>	54

**Tabela 30 – Numri i përgjithshëm i lëndëve të parashkruara për periudhën 4 nëntor 2013 - 31 dhjetor 2014**

Bazuar në të dhënat e pasqyruara në tabelë, në të gjitha PTh-të dhe në PSRK, janë identifikuar raste të parashkrimit të natyrës korruptive. Nga gjithsej 54 rastet e parashkruara, PTh në Mitrovicë kishte pasur numrin me të madh të lëndëve të parashkruara, gjithsej 21 lëndë të tilla. PTh në Prishtinë, e cila edhe ka numrin me të madh të lëndëve të korrupsionit në procedim, për periudhën e njëjtë (4 nëntor 2013 - 31 dhjetor 2014), gjithsej kishte 15 raste të parashkruara. PTh në Gjilan dhe PTh në Prizren pasojnë me nga 7 raste të

Instituti i Kosovës për Drejtësi Qershor 2015  
parashkruara, përkatësisht 4 raste, duke vijuar me nga 2 raste të parashkruara në PTh në Pejë dhe PTh në Ferizaj, dhe e fundit PSRK me 1 rast të parashkruar.

*b. Raportet e veçanta për rastet e parashkruara*

Planit i Veprimit në nenin 3.2 kishte përcaktuar përpilimin e raporteve të veçanta për secilin rast që kishte arritur afatin e parashkrimit. Përmes kësaj Kryeprokurorët obligoheshin të përpilonin raporte të veçanta për secilin rast që ka arritur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale për t'ia dorëzuar Koordinatorës Nacionale kundër Korrupsionit për t'i raportuar më pas në KPK.

Në raportin e parë të publikuar nga IKD - "Korrupsioni në Kosovë: Raport vlerësues mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit", janë identifikuar gjithsej 23 raste të parashkrimit për periudhën 4 nëntor 2013 – 19 shkurt 2014.<sup>100</sup> Në asnjërin prej 23 rasteve të parashkruara, nuk ishte përpiluar raport i veçantë për arsyet e parashkrimit, me ç'rast, nuk ishte përmbushur obligimi nga neni 3.2 i Planit të Veprimit.<sup>101</sup>

Përkundër rekomandimeve të IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit dhe përmbushjen e obligimeve nga neni 3.2 i Planit të Veprimit, as për periudhën mars – qershor 2014, prokuroritë nuk kishin përmbushur obligimet sipas Planit të Veprimit, për përpilimin e raporteve të veçanta mbi arsyet e parashkrimit të lëndëve. Për këtë periudhë IKD kishte identifikuar gjithsej 13 raste të parashkrimit në të gjitha prokuroritë (në përjashtim të PSRK-së dhe PTh në Ferizaj), ndërsa në asnjë rast nuk ishte përgatitur raporti i veçantë për arsyet e parashkrimit të rasteve.<sup>102</sup> Njëjtë ishte situata me raportin pasues të IKD-së të publikuar në dhjetor 2014, "Korrupsioni në Kosovë 3", me ç'rast për periudhën korrik – shtator 2014 janë identifikuar gjithsej 5 raste të parashkrimit, mirëpo në asnjërin rast, kryeprokurorët e prokurorive përkatëse, nuk kishin përpiluar raport të veçantë për arsyet e parashkrimit.<sup>103</sup>

Marrë parasysh rekomandimet e vazhdueshme të IKD-së, prokuroritë vonë kanë filluar përmbushjen e obligimit nga neni 3.2 i Planit të Veprimit. Në raportin e fundit për vitin 2014, i cili përfshinte periudhën tetor, nëntor, dhjetor 2014, janë identifikuar gjithsej 13 raste të parashkrimit. Nga gjithsej 13 raste, të cilat ishin hudhur poshtë kallëzimet penale dhe ishin pushuar hetimet për shkak të arritjes së

---

<sup>100</sup> Musliu B. Gashi A. Korrupsioni në Kosovë, raport vlerësues mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, faqe 36-41, publikuar me 31 mars 2014, Prishtinë.

<sup>101</sup> Musliu B. Gashi A. Korrupsioni në Kosovë, raport vlerësues mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, faqe 25-27, publikuar me 31 mars 2014, Prishtinë.

<sup>102</sup> Musliu B. Korrupsioni në Kosovë 2, raport vlerësues gjithëpërfshirës mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, faqe 54-57, publikuar me 5 shtator 2014, Prishtinë.

<sup>103</sup> Musliu B. Nimoni G. Korrupsioni në Kosovë 3, raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, faqe 69, publikuar me 26 dhjetor 2014, Prishtinë.

Instituti i Kosovës për Drejtësi Qershor 2015  
afatit të parashkrimit, për 11 raste ishin përgatitur raportet e veçanta mbi arsyet e parashkrimit, ndërsa për dy të tjera nuk ishte përgatitur raport i veçantë mbi arsyet e parashkrimit (PSRK dhe PTh në Prizren nga një rast).<sup>104</sup>

Nga gjithsej 54 rastet e natyrës korruptive të parashkruara, bazuar në intervistat me kryeprokurorët e PTh-të dhe atë të PSRK-së, gjithashtu intervistën me Koordinatorin Nacionale Kundër Korrupsionit, IKD ka identifikuar vetëm 11 raste për të cilat është përgatitur raporti i veçantë për rastet e parashkruara, sipas Planit të Veprimit.

IKD vlerëson se mos-përmbushja e këtij obligimi të Planit të Veprimit dëshmon seriozitetin e Kryeprokurorëve dhe sistemit prokurorial në trajtimin e luftimit të korrupsionit.

### *c. Arsyet e parashkrimit dhe masat e prokurorisë në parandalimin e parashkrimit*

IKD ka bërë analizimin e rasteve të parashkrimit për veprat penale të korrupsionit dhe arsyet për të cilat ato janë parashkruar. Nga aktvendimet e prokurorive për hudhje poshtë të kallëzimeve penale dhe aktvendimet për pushim të hetimeve, rezulton se arsyet e parashkrimit ndërlidhen me mungesën e ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme ligjore për ndjekjen penale qoftë nga Policia e Kosovës, po ashtu nga prokuroritë përkatëse. Megjithatë, në disa raste është vërejtur se ato janë denoncuar me vonesë nga parashtruesit dhe në këto raste për shkak dispozitave ligjore për kohën e ndjekjes penale dhe skadimit të kësaj kohe, rastet kanë mbetur të paprekura për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

Arsyet e arritjes së afatit të parashkrimit të rasteve të korrupsionit sipas drejtuesve të Prokurorive janë të shumta. Kryeprokurori i PTh në Prishtinë thekson se kjo prokurori ka pasur një numër të madh të lëndëve, të cilat është dashur të trajtohen me urgjencë dhe ka ndikuar që në rastet e tjera të mos ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore ndër vite dhe në disa raste të arrihet parashkrimi.<sup>105</sup> Arsyet tjetër ishte edhe mungesa e ndërmarrjes së veprimeve në kohën kur lëndët e korrupsionit kanë qenë në kompetencë të ish-Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës, të cilat më pas, kanë kaluar në kompetencë të PTh në Prishtinë. Këto raste të patrajuara nga ish-Prokuroria e Qarkut të Prishtinës e cila ka pasur mungesë të theksuar të prokurorëve kanë bërë që në disa prej tyre të arrihet afati i parashkrimit të ndjekjes penale.<sup>106</sup>

---

<sup>104</sup> Musliu B. Nimoni G. Korrupsioni në Kosovë 4, raport vlerësues periodik mbi efikasitetin e sistemit prokurorial në zbatimin e planit të veprimit për rastet e korrupsionit, faqe 65, publikuar me 8 prill 2015, Prishtinë.

<sup>105</sup> IKD intervistë me z. Imer Beka, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Mars 2015.

<sup>106</sup> Ibid.

Arsye të ngjashme për parashkrimin e lëndëve të korrupsionit qëndrojnë edhe në PTh në Mitrovicë. Numri i vogël i prokurorëve në kohën kur PTh e Mitrovicës ka qenë e organizuar si Prokurori Komunale dhe e Qarkut, ka bërë që shumë lëndë, të qëndrojnë në sirtarë pa u ndërmarr ndonjë veprim ligjor në drejtim të zgjidhjes së tyre.<sup>107</sup> Njëjtë sikurse në PTh në Prishtinë, gjithashtu PTh në Mitrovicë, trajtimi i lëndëve tjera të natyrës me urgjencë siç janë lëndët me paraburgim, ka pamundësuar trajtimin e rasteve që kanë rrezikuar parashkrimin, me ç'rast ka ardhur deri të parashkrimi i tyre.<sup>108</sup> Mirëpo në PTh në Mitrovicë gjithashtu janë edhe arsye tjera që kontribuojnë në parashkrimin e lëndëve siç janë kushtet e vështira të punës për shkak të mungesës së hapësirave të nevojshme të punës dhe numri i pamjaftueshëm me prokurorë.<sup>109</sup>

PTh në Pejë, PTh në Gjakovë dhe PTh në Ferizaj të cilat për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2014, numërojnë nga dy raste të parashkruara. Sipas Kryeprokurorëve arsyet e parashkrimit të këtyre rasteve mbështeten në faktin se në këto prokurori rastet veçse kishin arritur në kohën kur ishin parashkruar.<sup>110</sup> Njëjtë pohon edhe Kryeprokurori i PTh në Prizren, e cila prokurori për periudhën e njëjtë, numëron 4 raste të parashkruara.

Pas publikimit të secilit raport periodik të IKD-së, Zyra e Prokurorit Disiplinor, sipas detyrës zyrtare, ka hapur një numër të madh të hetimeve preliminare dhe hetimeve disiplinore ndaj prokurorëve të caktuar, për parashkrimin e rasteve të korrupsionit dhe për mos respektim të afateve ligjore.<sup>111</sup> Ndaj disa prokurorëve tashmë janë shqiptuar masa disiplinore të heqjes së një pjese të pagës për shkak të shkeljeve të konstatuara të cilat janë prezantuar në raportet e IKD-së.<sup>112</sup>

<sup>107</sup> IKD intervistë me z. Shyqyri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë; mars 2015.

<sup>108</sup> Ibid.

<sup>109</sup> IKD intervistë me z. Shyqyri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë; mars 2015.

<sup>110</sup> IKD intervistë me z. Agron Galani, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë; znj. Shpresa Bakija, Kryeprokurore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe z. Rasim Maloku, U. d i Kryeprokurorit në PTh në Ferizaj; mars 2015.

<sup>111</sup> *Shënim:* Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, z. Zef Prendrecaj, në një njoftim zyrtar për IKD, ka njoftuar se ZPD ka zhvilluar hetime preliminare dhe në disa prej tyre ende është në proces në 98 rastet e paraqitura në 4 raportet periodike të IKD-së. Shih përgjigjen e z. Prendrecaj: "Ju njoftojmë se Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD), ka shqyrtuar raportit të parë të IKD-së: "Korrupsioni në Kosovë 1" të publikuar më 28 mars 2014, për të cilën ka vendosur: Nga 26 lëndë prokuroriale të prezantuara në këtë raport, për të gjitha lëndët janë zhvilluar hetimet preliminare disiplinore ku 5 lëndë janë refuzuar nga raporti i IKD-së (ZPD ka vlerësuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për të hapur hetim disiplinor andaj ka refuzuar pohimet e prezantuara ne raport) dhe ndaj 21 lëndëve, ZPD ka hapur hetim disiplinor. Po ashtu, ZPD ka shqyrtuar raportin e dytë "Korrupsioni në Kosovë 2", të publikuar më 15 shtator 2014, për të cilën ka vendosur: Nga 16 lëndë të prezantuara në raport janë zhvilluar hetime preliminare duke rezultuar me; hapje të hetimit disiplinor për 1 lëndë (ZPD gjatë hetimit preliminar ka vlerësuar se ka neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorimi i funksioneve prokuroriale dhe shkelje të Kodit të Etikës); dhe refuzim të pohimeve nga raporti për 15 lëndë, (ZPD ka vlerësuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për të hapur hetim disiplinor andaj ka refuzuar pohimet e prezantuara ne raport). ZPD është në shqyrtim të raportit të tretë të IKD-së "Korrupsioni në Kosovë 3", të publikuar më 26 dhjetor 2014, i cili përfshin 29 lëndë prokuroriale dhe për të gjitha këto raste ZPD ka siguruar shkresat relevante të lëndëve dhe informacionet tjera të rëndësishme. Tani për tani, ZPD është në fazën e vendosjes për të gjitha këto lëndë. ZPD gjithashtu është duke e shqyrtuar raportin e katër të IKD-së "Korrupsioni në Kosovë 4", të publikuar më 8 prill 2015, i cili përfshin 25 lëndë prokuroriale dhe për të gjitha lëndët poashtu kemi filluar

IKD konsideron mjaftë shqetësues faktin e parashkrimit të rasteve për shkak të mungesës së veprimeve procedurale nga ana e institucionit të prokurorisë. Parashkrimi i 54 rasteve vetëm brenda një viti dhe atë vetëm për lëndët e natyrës së korrupsionit, mbetet është alarm për gjithë sistemin prokurorial, i cili duhet të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të parandalimit dhe evitimit të dukurisë së parashkrimit.

## SHKELJA E AFATEVE LIGJORE MË RASTIN E VENDOSJES

### *a. Shkelja e afateve ligjore sipas prokurorive*

Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe analizimit të akteve juridike prokuroriale të prokurorive, IKD ka identifikuar një numër të rasteve të mos-respektimit të afateve ligjore të përcaktuara me dispozita ligjore, përkatësisht me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Në nenin 82 të Kodit të Procedurës Penale, shprehimisht përcaktohet afati 30 ditor me rastin e hudhjes poshtë të kallëzimeve penale.<sup>113</sup> Për periudhën 4 nëntor 2013 – 31 dhjetor 2014, IKD ka identifikuar gjithsej 41 raste të tilla të shkeljes së këtij afati ligjor në të gjitha PTh-të dhe në PSRK. Tabela në vijim, ka pasqyruar rastet e shkeljes së afatit ligjor për vendosje prej 30 ditësh nga koha e pranimit të kallëzimit penal:

---

kompletimin e shkresave të lëndëve. Tani për tani, jemi në këtë fazë dhe në momentin e kompletimit të të gjitha shkresave të lëndëve, ZPD do t'i shqyrtoje dhe vendosë të gjitha". IKD komunikim me z. Prendrecaj përmes postës elektronike. 28 prill 2015.

<sup>112</sup> *Shënim:* Drejtori i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, z. Zef Prendrecaj, në një njoftim zyrtar për IKD, ka njoftuar se deri më tani prej raporteve të IKD-së, ZPD në tri raste ka gjetur sjellje të pahijshme, ka përgatitur raport përfundimtar ku ka rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore në KPK ndaj tre prokurorëve. Ka raste ku Komisioni disiplinor i KPK-së ka vendosur dhe ka gjetur përgjegjës për sjellje të pahijshme prokurorin për neglizhencë nga të gjeturat e Raportit të IKD-së. Në disa rastet hetimet disiplinore në ZPD janë në fazën përfundimtar. IKD komunikim me z. Prendrecaj përmes postës elektronike. 28 prill 2015.

<sup>113</sup>Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 82: Prokurori i Shtetit me aktvendim e hudh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se: 1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer veprë penale; 1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; 1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje; 1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen.

<b>Shkelja e afateve ligjore 4 nëntor 2013 - 31 dhjetor 2014</b>	<b>Rastet</b>
<i>PSRK</i>	2
<i>PTh Prishtinë</i>	13
<i>PTh Prizren</i>	14
<i>PTh Pejë</i>	1
<i>PTh Gjilan</i>	5
<i>PTh Mitrovicë</i>	4
<i>PTh Ferizaj</i>	0
<i>PTh Gjakovë</i>	2
<b>TOTAL</b>	<b>41</b>

Tabela 31 - Numri i përgjithshëm i lëndëve në të cilat janë shkelur afatet ligjore për periudhën 4 nëntor 2013 - 31 dhjetor 2014

PTh në Prizren është prokuroria me numrin më të madh të rasteve të shkeljeve, gjithsej 14 raste, e pasuar nga PTh në Prishtinë me 13 raste, PTh në Gjilan me 5 raste të kallëzimeve penale dhe PTh në Mitrovicë me 4 të tilla. PSRK dhe PTh në Gjakovë kishin nga 2 raste të shkeljes së afateve ligjore me rastin e vendosjes, PTh në Pejë një rast të tillë dhe PTh në Ferizaj si e vetmja prokurori pa asnjë rast të shkeljes së afateve ligjore sipas KPPK-së.

Mos-respektimi i afateve ligjore nga PSRK dhe PTh-të, ndër tjera ka efektin e saj në çështjet kryesore, duke nxjerrë në pah neglizhencën e prokurorëve, mungesën e vigjilencës dhe profesionalizmin e tyre rreth obligimeve të tyre ligjore, dhe krejt kjo rezulton në mungesën e efikasitetit të prokurorive në trajtimin e rasteve të korrupsionit.

***b. Arsyet e shkeljes së afateve ligjore dhe evitimi i shkeljeve***

Shkelja e afateve ligjore me rastin e vendosjes për kallëzimet penale, ishte trajtuar gjithashtu në raportet paraprake të IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit. IKD ka pasqyruar nëpër periudha të ndryshme rastet e shkeljes së afateve ligjore me rastin e vendosjes nga prokurorët.

Arsyet e shkeljes së afateve ligjore janë nga më të ndryshmet. Në intervistat e realizuara me kryeprokurorët e PTh-ve dhe PSRK-së, shkelja e afateve ligjore është arsyetuar në të shumtën e rasteve me ngarkesën e prokurorive me lëndë dhe pamundësinë e prokurorive për të respektuar këto afate ligjore për shkaqe, sipas tyre, objektive.

PTh në Prizren, si prokuroria me numrin me të madh të rasteve të shkeljeve të afateve ligjore, ka arsyetuar mos-respektimin e afateve ligjore me ngarkesën e prokurorisë me lëndë të shumta. Gjithashtu arsye tjetër sipas tyre ishin edhe përfaqësimet e shumta në gjykata dhe koha e limituar për trajtimin e kallëzimeve penale sipas afateve ligjore, numri i vogël i prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional. Mirëpo, kryeprokurorët gjithashtu theksuan mungesën e vigjilencës së prokurorëve për respektimin e afateve ligjore.<sup>114</sup> Ngarkesën me lëndë të shumta e thekson edhe Kryeprokurori i PTh në Prishtinë, i cili konsideron se kjo është arsyeja që pamundëson respektimin e afateve ligjore.<sup>115</sup> Arsye tjera në PTh në Prishtinë janë kohëzgjatja e grumbullimit të provave, të cilat shkaktojnë vonesa për shkak të kohës së limituar dhe veprimet e ngadalësuara të Policisë së Kosovës.<sup>116</sup>

Arsye e njëjtë të shkeljes së afateve për shkak të ngarkesës me lëndë, theksohet edhe nga PTh në Gjakovë. Ngarkesa e tepërt me lëndët, kishte qenë arsyeja kryesore pse nuk është arritur t'i kushtohet rëndësi afatit me rastin e hudhjes poshtë të kallëzimeve penale.<sup>117</sup> Përveç ngarkesës me lëndët në PTh në Mitrovicë, kishte edhe arsye krejt tjera kishin shkaktuar pamundësinë e respektimit të afateve ligjore me rastin e vendosjes për kallëzimet penale. Kushtet e vështira të punës për shkak të mungesës së hapësirave të nevojshme për punën, kishte qenë arsyeja kryesore e pamundësisë së efikasitetit të PTh në Mitrovicë të cilat ishin reflektuar në mos-respektimin e afateve ligjore me rastin e vendosjes për kallëzimet penale.<sup>118</sup> Mungesa e hapësirave të nevojshme në PTh në Mitrovicë, është trajtuar edhe në raportet paraprake të IKD-së për zbatimin e Planit të Veprimit. Për shkak të situatës politike në Mitrovicë, nga viti 2008 PTh në Mitrovicë është lokalizuar në objektin e ish-Gjykatës Komunale në Vushtrri, ku së bashku me Gjykatën Themelore të Mitrovicës, vazhdojnë të ndajnë hapësirat e njëjta të punës.<sup>119</sup>

Dy prokuroritë me numrin me të madh të rasteve të shkeljeve të tilla, PTh në Prizren dhe PTh në Prishtinë, evitimin e kësaj problematike fillimisht e shohin në adresimin e çështjes në mbledhjet e kolegjiemeve me prokurorët, më pas edhe në shtimin e numrit të prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional.<sup>120</sup> Shtimi i numrit të prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, theksohet si

<sup>114</sup> IKD intervistë me z. Metush Biraj, U. d. Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren; Mars 2015.

<sup>115</sup> IKD intervistë me z. Imer Beka, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Mars 2015.

<sup>116</sup> Ibid.

<sup>117</sup> IKD intervistë me znj. Shpresa Bakija, Kryeprokurore në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Mars 2015.

<sup>118</sup> IKD intervistë me z. Shyqyri Sylja, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë; mars 2015.

<sup>119</sup> Ibid.

<sup>120</sup> IKD intervistë me Kryeprokuror të prokurorive themelore në Prishtinë dhe Prizren, z. Imer Beka, përkatësisht z. Metush Biraj; mars 2015.

nevoje edhe e PTh në Pejë në evitimin e mos-respektimit të afateve ligjore. Sipas Kryeprokurorit të PTh në Pejë, kjo do të kishte efektin në trajtimin e lëndëve të korrupsionit brenda afateve të lëndëve në prokurori, duke shtuar se deri të shkeljet e afateve, kishte ardhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm me prokurorët e angazhuar në rastet e korrupsionit.<sup>121</sup>

Në intervistat e realizuara me kryeprokurorët e PTh-ve, IKD ka vërejtur edhe raste kur prokuroritë nuk ishin në dijeni për ekzistimin e afatit 30 ditor me rastin e hudhjes së kallëzimit penal, të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Pas adresimit të kësaj çështje nga IKD, Kryeprokurorët kanë diskutuar këtë problematikë në kolegjiomet e tyre me të gjithë prokurorët. IKD vlerëson si shqetësuese mos-respektimin e afateve ligjore, duke dëshmuar në praktikë gjetjet e publikuara në Anketën e Prokurorëve të Kosovës të zhvilluar nga Ambasada Amerikane, në të cilën, gjetjet tregonin se prokurorët kanë probleme serioze në të kuptuarit e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.<sup>122</sup> IKD vlerëson se është nevojë urgjente e adresimit të problematikës së ngritjes së kapaciteteve, njohurive dhe profesionalizimin e prokurorëve.

---

<sup>121</sup> IKD intervistë me z. Agron Galani, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë; mars 2015.

<sup>122</sup> "Anketa e Prokurorëve të Kosovës". Zhvilluar dhe mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës. 2013.

Instituti i Kosovës për Drejtësi në bazë të të gjeturave gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit të Veprimit, sikurse në raportet paraprake nxjerr këto rekomandime për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve janë përsëritur për shkak të moszbatimit të tyre nga raportet paraprake.

**I - Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të zbatojë obligimet, të cilat vetë i ka miratuar në Planin e Veprimit, duke përfshirë:**

1. Vlerësimin e performancës së Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore dhe PSRK-së si dhe prokurorëve të këtyre prokurorive për zbatimin e Planit të Veprimit deri në këtë periudhë raportuese.
2. Përgjegjësinë e Kryeprokurorëve që nuk kanë shqiptuar asnjë masë disiplinore ndaj punonjësve, për të cilët janë konstatuar shkelje të detyrave të punës nga ana e Komisionit për Mbikëqyrjen dhe Verifikimin e të Dhënave për rastet e korrupsionit.
3. Përgjegjësinë e Kryeprokurorëve që nuk kanë përpiluar raporte të veçanta me arsyetim për secilin rast që ka arritur afatin e parashkrimit. Të njëjtat raporte duhet të vazhdojnë të përgatiten veç e veç për secilin rast për KPK.
4. KPK duhet të kërkojë llogari më të madhe prej Kryeprokurorëve për moszbatimin e dispozitave ligjore për Sekuestrim dhe Konfiskim të dobisë pasurore.
5. KPK duhet të krijojë një mekanizëm të brendshëm për të analizuar zgjidhjen e rasteve të korrupsionit, me fokus në analizimin e rasteve të hudhjes së kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve nga ana e parashtruesve të këtyre akteve. Në këtë drejtim duhet analizuar, sidomos rastet e parashtruara të Policisë së Kosovës dhe AKK-së për shkak të numrit të madh të hudhjes dhe pushimit të tyre. IKD insiston se kjo është e vetmja rrugë për të mundësuar krijimin e politikave adekuate kriminale për luftimin e korrupsionit.
6. Prokuroritë Themelore gjatë trajtimit të rasteve të kallëzimeve penale nga AKK lidhur me rastet e deklarimit të prejardhjes së pasurisë të trajtojnë këto raste me prioritet gjatë vitit 2015 dhe të zbatojnë praktika uniforme.
7. Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë të identifikohen në PSRK dhe Prokurori Themelore dhe të njëjtat të trajtohen me prioritet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt nga Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse dhe Kryeprokurori i Shtetit.
8. Përkundër angazhimit në ri-organizimin e punës në PTh në Prishtinë, KPK duhet të vazhdojë të ofrojë mbështetje në zgjidhjen e problemeve në PTh Prishtinë për shkak të ngarkesës dhe cilësisë së kryerësve të veprave penale të korrupsionit, me të cilat merret kjo prokurori.
9. KPK duhet të ndërmerri hapa urgjent dhe shumë konkret për përmirësimin e kushteve të punës për PTh në Mitrovicë.

10. KPK duhet të obligojë prokuroritë që të dhënat për rastet e korrupsionit të futen në bazë për çdo ditë, duke përditësuar të dhënat në Mekanizmin Përcjellës për të qenë të qasshme të dhënat në çdo kohë.
11. KPK duhet të kategorizoj në bazën e të dhënave statistikore rastet e parashkrimit të korrupsionit. Duhet të ekzistojë një kategori e veçantë që mundëson identifikimin e rasteve të parashkruara.
12. KPK të kategorizoj në bazën e të dhënave statistikore profilet e personave ndaj të cilëve zgjidhen rastet e korrupsionit.
13. KPK duhet të investojë në profilizimin dhe specializimin e prokurorëve që merren me rastet e korrupsionit.
14. Prokurorët të dëshmojnë vetiniciativë në inicimin e rasteve të korrupsionit.

## **II - Koordinatorja Nacionale kundër Korrupsionit duhet të:**

1. Raportoje në baza të rregullta në KPK për të gjitha pengesat që hasë në moszbatimin e Planit të Veprimit.
2. Respektoj mekanizmin e brendshëm të mbledhjes së informatave nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, përkatësisht nga baza e të dhënave nga Mekanizmi Përcjellës.
3. Respektoj afatet e parapara në Planin e Veprimit për komunikim me publikun në baza të rregullta dy javore, duke përmbushur një prej obligimeve të planit për të mbajtur të informuar publikun, duke rritur transparencën dhe duke qenë llogaridhënës para publikut për secilën prokurori.
4. Progresi i zbatimit të Planit të Veprimit ku përfshihen informata rreth gjendjes së rasteve të korrupsionit duhet të publikohen në baza të rregullta dy javore në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit në mënyrë që kenë qasje të lehtë publiku dhe mediat.

## **III - KPK dhe ZPD duhet të bashkëpunojnë ngushtë në ndërmarrjen e masave disiplinore sa i përket:**

1. Rasteve të korrupsionit të vendosura në kundërshtim me dispozitat ligjore (rastet e evidentuara nga IKD dhe të tjera).
2. Rasteve të prokurorëve të cilët me vite të tëra nuk i kanë trajtuar fare lëndët e korrupsionit të dërguara nga parashtruesit.